



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation



METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ)

(Doracak për trajner)



Fakulteti i Edukimit



HzhA
Institut për Humanitet dhe Zhvillim Shqiptar

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ)

(Doracak për trajner)

Falënderim

Ky material është zhvilluar dhe publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Qeverisë Gjermane.

Teksti origjinal në gjuhën Shqipe [2021]

E drejta për përdorim, riprodhim dhe redaktim i është bartur Universitetit të Prishtinës - Fakultetit të Edukimit dhe Institutit për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit [2023]

Përmbajtja e tekstit origjinal është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo të Qeverisë Gjermane.

Autorë të doracakut:

Martin Eckeberg

Eva Eckeberg

Rishikuar nga:

Shyhrete Alaj dhe Armen Mustafa

Koordinuar nga:

Alberta Alihajdari, GIZ

Dizajni dhe faqosja nga:

Envinion, Prishtinë



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përmbajtja:

1. Metodologjia me nxënësin në qendër (MNQ)	4
2. Moduli 1	10
2.1 Agjenda për trajnerët	10
2.2 Aktivitetet, dita 1 + dita 2	11
2.3 Udhëzime për trajnerin	35
2.4 Fletë pune, prezantimet, M1, d1 + d2	45
2.5 Material shtesë, prezantimet, M2, d1 + d2	57
3. Moduli 2	61
3.1 Agjenda për trajnerët	62
3.2 Aktivitetet, dita 1 + dita 2	64
3.3 Udhëzime për trajnerin, M2, d1 + d2	88
3.4 Fletë pune, prezantimet, M2, d1 + d2	100
4. Fletat e metodave	113
5. Aktivitete energjizuese	128
6. Vegëza/ referenca për materialin e përdorur	131

Metodologjia me nxënësin në qendër (MNQ)

Ky doracak është zhvilluar për trajnerët vendor në Kosovë në mënyrë që t'u mundësojë atyre të trajnojnë mësimdhënës, kryesisht në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët. Pas këtij trajnimi, të gjithë mësimdhënësit duhet të jenë në gjendje të përdorin idetë e paraqitura në këto punëtori për metodat e përqendruara tek nxënësit në klasat e tyre.

Bazuar në kërkimet aktuale teorike në didaktikë, metodologji dhe neuroshkencë, doracaku ka për qëllim fuqizimin e trajnerëve për të zhvilluar këto seminare. Qëllimi i përgjithshëm është të aftësojë mësimdhënësit për të zbatuar një stil mësimi që plotëson nevojat dhe aftësitë e ndryshme në grupe heterogjene të të mësuarit duke rritur kuriozitetin dhe interesin e nxënësve për të mësuar dhe rritur përfshirjen e tyre.

Ky manual jep shumë këshilla praktike bazuar në dy punëtori dy-ditore të mbajtura në 2019 dhe përvojat e bëra.

Trajnerët vendor mund ta përdorin këtë doracak për të udhëhequr pjesëmarrësit e tyre përmes punëtorive të ardhshme hap pas hapi.

Dy punëtoritë e përshkruara në këtë doracak u mbajtën kryesisht në Prishtinë dhe Gjakovë. Pesë arsimtarë dhe koordinatori i sigurimit të cilësisë nga secila prej 20 shkollave të zgjedhura, të ashtuquajturat Shkolla Kampione, morën pjesë në punëtoritë. Gjithashtu, trembëdhjetë trajnerë vendor ishin të pranishëm për të punuar si trajnerë të ardhshëm, për të mbështetur mësimdhënësit në baza lokale dhe për të dhënë këshilla gjatë procesit.

Këto dy punëtori (ishin planifikuar si një fillim për një sekuençë prej shtatë punëtorive). Ato kishin për qëllim të vendosnin një themel të lidhur me të mësuarit bashkëpunues (metodologjinë) dhe mësimdhënien në

qendër të nxënësit (didaktika, të mësuarit bazuar në detyra).

Midis dy punëtorive nga mësimdhënësit u kërkua që të zbatonin një ose dy metoda të mësuar në punëtorinë e parë në praktikë dhe të vëzhgonin dhe të pasqyronin përvojën e tyre.

Sugjerohet që në punëtoritë e ardhshme të futen metoda të mëtejshme bashkëpunimi. Gjithashtu, pjesëmarrësit kanë nevojë për shumë më shumë këshilla praktike dhe përvojë për të aplikuar t në klasat e tyre në mënyrë domethënëse dhe për të planifikuar mësimet e tyre në përputhje me rrethanat.

Është e vetëkuptueshme që një seminar i vetëm i bazuar në të mësuarit bazuar në detyra dhe planifikim të prapambetur mund të jetë vetëm një fillim dhe nuk është aspak i mjaftueshëm.

Sa i përket PPT-ve të ndryshme, varet nga trajnerët nëse duan t'i shtypin ato për pjesëmarrësit.

Rekomandohet të përdorni energjizues të shkurtër kur pjesëmarrësit janë të lodhur, veçanërisht pas pushimit të kafesë ose drekës. Këta energjikë kanë dalë shumë efektivë. Lëvizja pak dhe qeshja ndihmuan shumë për t'i bërë ata të përqendroheshin përsëri dhe për të krijuar një atmosferë të këndshme. Pjesëmarrësit në punëtorinë tonë i gëzuan shumë ata dhe gjithmonë dëshironin të përjetonin më shumë sepse ata gjithashtu mund t'i përdorin ato në mësimet e tyre.

Sidoqoftë, varet nga trajnerët vendorë nëse u pëlqen të punojnë në atë mënyrë. Në aneks ka tre shembuj të energjizuesve që mund të provohen.

Struktura e doracakut:

Për të lehtësuar leximin e shpejtë janë dhënë disa shenja, disa shkurtesa dhe ngjyra që përdoren në mënyrë të përsëritur.

Në fillim është paraqitur çdo herë një tabelë që e udhëzon trajnerin.

Është ndjekur çdoherë mënyra e njëjtë.



shenja drejton tek fokusi qendror.

Ngjyrat e përdorura:

- 1) **E gjelbër** Për aktivitete
- 2) **E kaltër** Për udhëzime
- 3) **E verdhë** Për fletë pune ose modele ose prezantime në PowerPoint
- 4) **E kuqe** Për dokumentet/materialet e trajnerëve

Sidoqoftë, është e rëndësishme të përmendet që përveç studimit të plotë të doracakut, trajnerëve vendor paraprakisht mund t'u duhet pak kohë për të parë kontekstin teorik dhe dokumentet që rregullojnë aspekte të zhvillimit të shkollës, si pakon e dokumenteve për sigurimin e cilësisë së shkollës, Udhëzimin administrativ për sigurimin e cilësisë, Udhëzimin administrativ për Planifikimin zhvillimor të shkollës, Udhëzimin administrativ për punën e Aktivave profesionale, Udhëzimin administrativ për vlerësimin e performancës së shkollës, Udhëzimin Administrativ për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë, etj. Të gjitha këto gjenden në faqen zyrtare të MASH: <https://masht.rks-gov.net/udhezimet-administrative>

Udhëzimet që i jep trajneri janë në shkronja italike.



drejton tek diçka që është veçanërisht e vlefshme.

Këto shkurtesa janë përdorur:

PI = punë individuale
PÇ = punë në çift
PG = punë grupore
FM = fletë metode
FP = fletë pune

Indeksi

- a) Idetë përgatitore për trajnerët
- b) Studimi i secilit modul për pjesëmarrësit
- c) Aktivitetet
- d) Dokumentet zyrtare
- e) Prezantime në PowerPoint
- f) Fletë pune apo modele
- g) Aktivitetet aktivizuese
- h) Vegzat/referencat për materialet e përdorura



Historiku profesional i autorëve

Eva Eckeberg (Hamburg, Gjermani), konsulente për arsim,

mësimdhënëse, ligjëruese dhe trajnere

- në pedagogji për trajnimin e të trajnuarve për mësimdhënës në vendin e punës dhe mësimin e mentorëve në Institutin e Sigurimit të Cilësisë në Kiel (IQSH)

- për zhvillimin e shkollës

- për komunikim (dhe gjuhën trupore), përshtatshmëri, metodat bashkëkohore të mësimdhënies në shkolla dhe institucione të pavarura

trajnere (Universiteti i Kiel), naturopath

- mësimnxënie dhe orientimi në karrierë (për nxënësit e shkollës së nivelit të mesëm dhe të lartë)

- institucionalizimi i orientimit profesional dhe orientimit në karrierë në nivel të shkollës

Martin Eckeberg (Hamburg, Gjermani), konsulent për arsim,

ligjërues dhe trajner

përvoja e punës

- shef i gjuhëve (Ministria e Arsimit e Hamburgut, BSB)

- shef i gjuhëve për mësimdhënësit në kuadër të shërbimit (Institut i Hamburgut (LI))

- trajnimi i mësimdhënësve në vendin e punës (Institut i Hamburgut (LI))

- kurse trajnimi për mësimdhënës dhe fakultete

mësimdhënia në shkollat gjithëpërfshirëse

temat prioritare

- konsulencë sistemore në proceset e ndryshimit

- zhvillimi i kurrikulës së re në nivel të ministrisë dhe shkollës

- zhvillimi i kompetencave dhe mësimnxënies së bazuar në detyrat

- mësimnxënia ndërkulturore në fushën e arsimit

- zbatimi i mësimdhënies dygjuhësore në nivel të shkollës

- konsulencë në gjuhët për të trajnuarit për t'u bërë mësimdhënës dhe mësimdhënës brenda shërbimit



Doktor Gjerdit

Një ditë në panair

Duke shfrytëzuar një panair, Ardit gjërat përballë të tjerëve. Nëse dëshiron të shfaqet si një panair, duhet të marrë një kësulë të bukur dhe një top të vogël dhe të shfaqet në një shtetë të panairit.



Fluturo

Gjendit

Shikoni pamjet e reja me tabelë të lirisë dhe elektronike

I humbur në shkretëtirë

Një ditë Ardit gjërat përballë të tjerëve. Nëse dëshiron të shfaqet si një panair, duhet të marrë një kësulë të bukur dhe një top të vogël dhe të shfaqet në një shtetë të panairit.



VESHTIMESHIA

Çelësi MATERIEJEN
nëse GRI!

Durrkuci i kursimeve

Ardit gjërat përballë të tjerëve. Nëse dëshiron të shfaqet si një panair, duhet të marrë një kësulë të bukur dhe një top të vogël dhe të shfaqet në një shtetë të panairit.



Tullumbacet

Ardit gjërat përballë të tjerëve. Nëse dëshiron të shfaqet si një panair, duhet të marrë një kësulë të bukur dhe një top të vogël dhe të shfaqet në një shtetë të panairit.





Përhëndetje...

Me këto fletë të përhëndetjeve...
 Lëvizja e fletëve të përhëndetjeve është një nga aspektet më të rëndësishme të komunikimit në mjetet e reja të komunikimit. Kjo lëvizje është e nevojshme për të bërë komunikimin më të lehtë dhe më të shpejtë.
 Për të bërë këtë, duhet të kuptojmë se si funksionojnë këto fletë të përhëndetjeve. Kjo është e rëndësishme për të bërë komunikimin më të lehtë dhe më të shpejtë.
 Në këtë fletë të përhëndetjeve, do të shprehim idetë tona dhe do të shprehim idetë tona. Kjo është e rëndësishme për të bërë komunikimin më të lehtë dhe më të shpejtë.
 Në këtë fletë të përhëndetjeve, do të shprehim idetë tona dhe do të shprehim idetë tona. Kjo është e rëndësishme për të bërë komunikimin më të lehtë dhe më të shpejtë.
 Në këtë fletë të përhëndetjeve, do të shprehim idetë tona dhe do të shprehim idetë tona. Kjo është e rëndësishme për të bërë komunikimin më të lehtë dhe më të shpejtë.



ME KËTO FLETË TË PËRHËNDJETJEVE
 NJË Ë NJËRË PËR NJËRË Ë NJËRË PËR NJËRË

Moduli 1 - Agjenda për trajnerët

Dita 1 - Metodologjia me nxënësin në qendër

Koha	Dita 1:
09:00 – 09:20	Mirëseardhje dhe hyrje
09:20 – 09:40	Prezantimi i pjesëmarrësve & shkollave
09:40 – 09:50	Grupi gumëzhitës
09:50 – 10:20	Prezantimi kryesor
10:20 – 11:05	Rrethi i dyfishtë
11:05 – 11:20	Pauzë e kafes
11:20 – 11:50	Reflektim i grupit gumëzhitës /rrethit të dyfishtë
11:50 – 12:05	Mendo – çiftëzo – ndajë
12:05 – 13:00	Reflektim i metodave sipas lëndëve - poster
13:00 – 14:00	Dreka
14:00 – 14:30	Tregu
14:30 – 15:30	Intervista me 3 hapa
15:30 – 15:50	Informacion kthyes
15:50 – 16:00	Parashikimi i ditës së nesërne

● Me trajnerin në qendër ● Pauzat ○ Me nxënësit në qendër në bashkëpunim me trajnerin

FAKTORËT DHE MATERIALET PËR T'U MARRË PARASYSH GJATË PËRGATITJES

- **Salla** - madhësia
Pjesëmarrësve do t'u duhen tavolina për grupe dhe hapësirë e mjaftueshme për të lëvizur përreth. Padyshim, madhësia e sallës varet kryesisht nga numri i pjesëmarrësve, por duhet të zgjidhet me kujdes. Salla duhet të jetë e rehatshme. Gjithashtu, një sallë e dytë do të mund të merrej parasysh nëse e ndani grupin.
- **Pajisjet:** projektori (me internet pa tela (wifi)), laptop, tabela të meta planeve, tabela me fleta të mëdha, altoparlanta
- **Materiale:** (mundësisht në kutia)– fleta pune, fleta të metodës, prezantime power point
 - Kartat e meta planeve në ngjyra të ndryshme në një sasi më të madhe (të kaltër dhe të kuqe për aktivitetin e 2-të)
 - Gjilpëra të mjaftueshme
 - Fllomastera të zi (nëse është e mundshme nga një për secilin) dhe disa me ngjyra të ndryshme
 - Shirit ngjitës
 - Ngjitës letre
 - Letra e formatit A4 në 5 ngjyra: e kaltër, e verdhë, e kuqe, e gjelbër, e bardhë (për aktivitetin numër 3)
 - Sinjali akustik

Moduli 1 - Agjenda për trajnerët

Dita 2 - Metodologjia me nxënësin në qendër

Koha	Dita 2:
09:00 – 09:15	Hapja e ditës 2
09:15 – 10:15	Roli i mësimit në qendër gjatë të nxënësve bashkëpunues - shtroja
10:15 – 10:45	Stacioni i autobusit
10:45 – 11:05	Pauzë e kafes
11:05 – 11:45	Vet-reflektimi dhe informacioni kthyes
11:45 – 12:30	Tabela e kompetencave
12:30 – 13:30	Dreka
13:30 – 14:30	Puna me plane javore/ ditore
14:30 – 15:30	Organizimi i rrjeteve në shkollë
15:30 – 15:50	Informacion kthyes
15:50 – 16:00	Parashikimi i modulit 2, dita 1 + 2

- Me trajnerin në qendër
 ● Paizat
 ○ Me nxënësit në qendër në bashkëpunim me trajnerin

FAKTORËT DHE MATERIALET PËR T'U MARRË PARASYSH GJATË PËRGATITJES

- **Salla** - madhësia
Pjesëmarrësve do t'u duhen tavolina për grupe dhe hapësirë e mjaftueshme për të lëvizur përreth. Padyshim, madhësia e sallës varet kryesisht nga numri i pjesëmarrësve, por duhet të zgjidhet me kujdes. Salla duhet të jetë e rehatshme. Gjithashtu, një sallë e dytë do të mund të merrej parasysh nëse e ndani grupin.
- **Pajisjet:** projektori (me internet pa tela (wifi)), laptop, tabela të meta planeve, tabela me fleta të mëdha, altoparlanta
- **Materiale:** (mundësisht në kutia)– fleta pune, fleta të metodës, prezantime në power point
 - Kartat e meta planeve në ngjyra të ndryshme në një sasi më të madhe (të kaltër dhe të kuqe për aktivitetin e 2-të)
 - Gjilpëra të mjaftueshme
 - Fllomastera të zi (nëse është e mundshme nga një për secilin) dhe disa me ngjyra të ndryshme
 - Shirit ngjites
 - Ngjites letre
 - Letra e formatit A4 në 5 ngjyra: e kaltër, e verdhë, e kuqe, e gjelbër, e bardhë (për aktivitetin numër 3)
 - Sinjali akustik

AKTIVITETI NR. 1

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Mirëseardhje pjesëmarrësve	Prezantimi i vetës tuaj si trajner – prezantimi i objektivave të punëtorisë dy-ditore	1a Sesioni plenar 1b Sesioni plenar	5' Markera, shirit ngjitës, 15' projektor, Sinjal akustik për të filluar	Sllajdi 1, 2	20'

Dokumenti nr. 1 për trajnerin – konteksti i objektivave

Gjërat e përgjithshme për t'u marr parasysh para aktivitetit të parë:

Shumë shpesh nënvlerësohet se sa i rëndësishëm është fillimi i një punëtorie. Të gjithëve u pëlqen të përhëndeten, veçanërisht

nëse janë pak të emocionuar ose të pasigurt pasi nuk e njohin askënd. Prandaj, është e rëndësishme të merrni parasysh

se si dëshironi të krijoni një atmosferë të këndshme – një tufë lulësh, një vizatim i bukur në tabelë, etj, mund të bëjnë mrekulli. Është e rëndësishme që të mund t'i drejtoheni secilit

person me emër. Prandaj, kërkojuni pjesëmarrësve të bartin kartelën e dukshme me emrin e tyre, të cilën (mund) ta përgatisin vetë gjatë ardhjes.



Një mënyrë e lirë dhe e shpejtë: pjesëmarrësit mund të përdorin marker për të shkruar emrin në shirit ngjitës kur të vijë

Gjithashtu kërkon nga ata që ta plotësojnë listën si kjo më poshtë:

Emri	Emri i Shkollës	Filllore/E mesme	Klasa	Lënda kryesore *

*Nëse nuk kanë lëndë kryesore si në shkollën fillore, pjesëmarrësit duhet të plotësojnë lëndën që u ka pëlqyer ose të cilën e kanë studiuar më së shumti.

Si alternativë: Pjesëmarrësit mund të përgatisin një listë të tillë në cloud (server nga distanca) në shkollat e tyre. (Do t'ju duhen lëndët dhe klasat e tyre nëse formoni grupe të lidhura me lëndët p.sh. në aktivitetin 8 para drekës.)



Ajo që thoni në masë të madhe varet nga ju dhe personaliteti juaj. Sidoqoftë, origjinaliteti është më i rëndësishëm.

Aktiviteti 1a: Prezantoni veten: (Sllajdi 1)

Këtu janë disa ide se çfarë mund të thoni në fillim kur e prezantoni veten si trajner.

- Flisni për historikun tuaj profesional, ekspertizën tuaj
- Flisni për gjendjen tuaj personale (familja, hobi etj)
- Flisni për motivimin tuaj për të mbajtur këtë punëtorie
- Flisni për atë që mendoni se është e rëndësishme në lidhje me punëtorinë
- ...

Aktiviteti 1b: Prezantoni objektivat e punëtorisë: (Sllajdi 2)

1. Rritja e nivelit të aktiviteteve të nxënësve/kohës së të mësuarit aktiv (qëllimi kryesor)
2. Sfondi dhe orientimit (prezantimi kryesor)
3. Njohja dhe praktikimi i metodave bashkëpunuese (bazuar në disa kontekste teorike)
4. Metodatat e pasqyrit - ndërlidhur me lëndët dhe klasat (rolet e mësimit dhe nxënësve)
5. Krijimi i rrjeteve dhe sigurimi i zbatimit të tyre

Veprimet pasuese:

Pyetni shkurtimisht pjesëmarrësit nëse kanë ndonjë pyetje në lidhje me të kuptuarit e objektivave.

AKTIVITETI NR.2

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës		Materialet	PPT	Koha
Prezantimi i pjesëmarrësve	Njoftimi me anëtarët e grupit tjetër	<p>2a Sesioni plenar</p> <p>2b Puna Individuale (PI)</p>	<p>5'</p> <p>15'</p>	Topi i vogël, Sinjali, Fleta e metodës 1: Shkrepje blici	Sllajdi 3	20'

Siç u tha tashmë në aktivitetin 1: Shumë shpesh nënvlerësohet se sa i rëndësishëm është fillimi i një punëtorie dhe sa i rëndësishëm është njoftimi me pjesëmarrësit e tjerë. Të gjithë duan të shihen, prandaj sigurohuni që të gjithë të thonë vetëm disa fjalë para grupit.

Aktiviteti 2a: Metoda: Shkrepje blici:



Me pak fjalë: Secili pjesëmarrës flet për 30 deri 60 sekonda, pastaj e hedh një top të vogël (ose diçka të ngjashme) te dikush tjetër, i cili bën të njëjtën gjë. Nëse dikush flet shumë gjatë, përdorni sinjalin tuaj!

Për informata më të hollësishme, shikoni në fletën e metodës 1.

Udhëzime (Sllajdi 3)

1. Prezantoni shkurtimisht veten: **emri dhe shkolla**
2. A janë **metodat e të mësuarit bashkëpunues** të reja për ju apo i keni provuar ato në një trajnim të mëparshëm ose gjatë punës në shkollë?
3. Opsionale: vetëm nëse dëshironi: dëshira ime për këto ditë (pritjet)

Keni 30 – 60 sekonda

Mundësisht merrni shënime për ato që pjesëmarrësit thonë nëse doni t'i trajtoni disa aspekte më pas.

Aktiviteti 2b: Struktura e fletave të metodave



Dorëzoni fletën e metodës 1 (Shkrepje blici). Shpjegoni strukturën e saj:

Udhëzime:

- Në këtë punëtori, fletat e metodës do të ofrohen për secilën metodë që keni përdorur. Këto fletë kanë gjithmonë të njëjtën strukturë. Në fund, gjithmonë ekziston një pjesë që thotë: **IDETË E MIA/SITUATAT KONKRETE**. Këtu, kërkohet nga ju të mendoni se ku dhe kur do të përdorni atë metodë të veçantë në klasë. Ajo që do të shkruani, do të bëhet e rëndësishme në një fazë të mëvonshme të kësaj punëtorie, kur të keni mundësinë për të shkëmbyer idetë tuaja dhe të shtoni idetë e kolegëve tuaj.
- Tani: lexoni letrën dhe plotësoni pjesën më poshtë



Më pastaj:

- a) Pyetni nëse kanë ndonjë pyetje pasi të kenë plotësuar fletën e punës. (Inkurajoni të bëjnë pyetje duke përmendur se pyetjet janë pjesë e çdo procesi mësimor.) Prisni disa sekonda.
- b) Nëse keni kohë: Kërkojuni atyre të ndajnë me të tjerët - Jepni kohë për të shkëmbyer idetë me dikë që është ulur pranë tyre ose/dhe pyesni në sesionin plenar nëse dikush është i gatshëm të ndajë idetë e tija/saja.



Kur e plotësojnë fletën e metodës, duhet të ecni përreth dhe të shihni se si po e menaxhojnë. Në veçanti përqendrohuni tek **IDETË E MIA/SITUATAT KONKRETE**



b) Në masë të madhe varet nga koha e mbetur. Nëse preferoni sesionin plenar dhe askush nuk dëshiron të fillojë, është ide e mirë që të ndani me ta një pyetje në pjesën **IDETË E MIA/SITUATAT KONKRETE** dhe t'i kërkonit një pjesëmarrësi të shpjegojë idenë e tij/saj. Kjo shpesh funksionon si mënyrë e thyerjes së akullit.

AKTIVITETI NR. 3

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Krijimi i fokusit për pjesëmarrësit	Të menduarit rreth "mësimdhënies së mirë"	3 Çifte 10'	Sinjali Fleta e metodës 2:	Sllajdi 4	10'

Aktiviteti 3: Metoda: Grupi i gumëzhitës:



Metoda: Pjesëmarrësit shkëmbejnë shpejt pikëpamjet e tyre lidhur me një aspekt specifik. (2-3 minuta)

Për informata të hollësishme, shikoni metodën 2.

Udhëzime:

- Shkëmbeni shkurtimisht dhe spontanisht mendimin tuaj me një partner lidhur me pyetjen e mëposhtme: (Sllajdi 4)
 - Çka është mësimdhënia e mirë sipas meje?
 - Cilat janë dy aspektet kryesore që mund t'i vërej në klasë.Çifti jo domosdoshmërisht duhet të pajtohet për aspektet.
- Ju lutemi merrni shënime të aspekteve tuaja.

Është e rëndësishme që pjesëmarrësit të vendosin **spontanisht**. Ata nuk duhet të kenë shumë kohë për të menduar për përgjigjet e tyre sepse bazohet në përvojat, një vendim instinktiv. Koha e nevojshme në masë të madhe varet nga koha e dhënies së udhëzimeve tuaja si trajner. Pjesëmarrësit duhet të kenë vetëm **dy ose tre minuta** kohë për të diskutuar çështjen.

Një aspekt tjetër i përgjithshëm dhe i rëndësishëm: Ndoshta është mirë të përmendni se në përgjithësi është një metodë e mirë për t'u dhënë së pari fjalën nxënësve të turpshëm ose të pasigurt gjatë mbledhjes së rezultateve. (Diferencimi) Nëse ky është qëllimi i juaj, filloni duke i pyetur ata së pari.



Pas prezantimit kryesor, pjesëmarrësit do të kenë kohë të punojnë me fletën e metodës përkatëse. Ata gjithashtu do të kenë kohë të kthehen në përgjigjet e tyre përkatëse për detyrën.



Pjesëmarrësit do të plotësojnë fletët e metodës në një fazë të mëvonshme, së bashku me rrethin e dyfishtë.

AKTIVITETI NR. 4

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Prezantimi kryesor	Paraqitja e kontekstit teorik	3 Sesioni plenar 30'	Projektor – Letër & Stilolapsa për pjesëmarrësit	Prezantim shtesë në Power Point	30'

Dokumenti nr. 2 për trajnerin Prezantimi kryesor

Aktiviteti 4: Prezantimi kryesor



Metoda: Pjesëmarrësit dëgjojnë një fjalim mjaft teorik dhe marrin shënime lidhur me aspektet qendrore dhe/ose shkruajnë pyetje për aspektet e përmendura.

(Informatat e kontekstit i bën pjesëmarrësit të kuptojnë pse një zhvendosje në mendësinë e mësimdhënies është domethënëse si për nxënësit ashtu edhe për mësimdhënësit.)



Gjatë prezantimit pjesëmarrësit duhet të lejohen të bëjnë pyetje në lidhje me të kuptuarit. Në këtë pikë nuk duhet të diskutohet për përmbajtjen.



Mbani mend: Në aktivitetin paraprak pjesëmarrësve ju kërkua që të mendojnë lidhur me Mësimdhënien e mirë! Ata duhet të përdorin idetë e tyre për diskutim në aktivitetin e pestë pas prezantimit kryesor.

Udhëzime (Para prezantimit):

Kërkojuni pjesëmarrësve të marrin një letër dhe një stilolaps për të shënuar aspektet kryesore dhe/ose të shkruajnë pyetjet që dalin gjatë prezantimit.

Tregojuni se shënimet dhe pyetjet e tyre do të jenë të nevojshme në aktivitetin vijues pas prezantimit.

Ideja prapa marrjes së shënimeve është t'i ndihmojë ata të përqendrohen dhe të mbajnë mend ato që janë thënë.

AKTIVITETI NR. 5

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Thellimi i të kuptuarit të përbashkët të aspekteve të caktuara të prezantimit kryesor	Sigurimi dhe reflektimi i të kuptuarit të aspekteve të prezantimit kryesor	5a Sesion plenar/ PI 15' 5b PI 25' 5c Sesion plenar 10'	Tabela me fleta të mëdha – Marker i përhershëm Mjet për sinjal (zile, ndonjë kafshë që lëshon tingull, gongu, etj.)	Sllajdet 5-8	50'

Aktiviteti 5: Sigurimi i të kuptuarit të përbashkët të prezantimit kryesor



Ky aktivitet përbëhet nga 4 hapa – hapat 3 dhe 4 ndahen në a dhe b – ato kërkojnë rreth 50 minuta gjithsej. Sasia e kohës që secili hap do të marrë përafërsisht është dhënë në fund të secilit hap në udhëzimet për një kuptim më të mirë.

Aktiviteti 5a: Sigurimi i të kuptuarit të përbashkët të prezantimit kryesor



Udhëzime:

Hapi 1: (Sllajdi 5) Përdorni shënimet tuaja nga prezantimi kryesor dhe shkruani të paktën një ose dy pyetje të hapura. 10 minuta.
Dhe shkruani një ose dy aspekte që u janë dukur interesante, që ishin të reja për juve (përdorni fjalë kyçe nëse është e mundur).

Hapi 2: (Sllajdi 6) Shpjegoni metodën. *
(Nëse ka ndonjë pyetje në lidhje me të kuptuarit e metodës, sqaroni ato.) 5 min.

Këshillohet që shpejt të skiconi rrethin e dyfishtë në tabelë dhe jo vetëm ta paraqisni atë në sllajd. Do t'ju kursej shumë kohë pasi që pjesëmarrësit mund të përcjellin hap pas hapi atë që po bëni. Për t'i lehtësuar gjërat dhe për të rritur nivelin argëtues, kërkoni që të dy rrathët të lëvizin, p.sh. rrethi i brendshëm lëviz në drejtim të akrepave të orës, rrethi i jashtëm kundër akrepave të orës – ata gjithashtu mund të lëvizin dy persona ose lëviz vetëm rrethi i brendshëm i rrethit të jashtëm. Ka mundësi të ndryshme.

Aktiviteti 5b: Rrethi i dyfishtë

- ✓ **Hapi 3a:** (Sllajdi 7) Partneri A parashtron një pyetje, B i përgjigjet. Pastaj i ndërroni rolet.** 6 min.
- Tani rrathët lëvizin për një person, rrethi i brendshëm në drejtim të akrepave të orës, rrethi i jashtëm kundër akrepave të orës.
- ✓ **Hapi 3b:** Parashtroni pyetjen e njëjtë tek partneri i juaj i ri – ndërroni me radhë 6 min.
- ✓ U thoni se nëse nuk kanë marrë një përgjigje të kënaqshme, pyetja do të trajtohet në sesionin plenar. (Aktiviteti 6a)
- Tani rrathët lëvizin në mënyrë që të gjithë të kenë përsëri një partner të ri.
- ✓ **Hapi 4a:** (Sllajdi 8) Çka kam parë interesante në prezantimin kryesor. 6 min.
- Shkëmbeni mendimet tuaja me partnerin tuaj të ri.
- ✓ Tani rrathët lëvizin në mënyrë që të gjithë të kenë përsëri një partner të ri.
- ✓ **Hapi 4b:** Bëni të njëjtën gjë me partnerin tuaj të ri. 6 min.

Aktiviteti 5c: Përmbledhja



Nëse çiftet përfundojnë më shpejt, ata duhet ta marrin pyetjen tjetër që kanë (ose më shumë se një pyetje).

AKTIVITETI. 6A

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha	
Prezantimi kryesor (a1) + Fletat e metodave për grupin e gumëzhimës dhe rrethit të dyfishtë	6a Qartësimi i pyetjeve të mbetura -	6a Sesioni plenar	10'	Mësimdhënia ballë për ballë	-----	25'
	6b Të mendohet kur të përdoren këto metoda	6b Puna individuale	15'	PI		

AKTIVITETI. 6C

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha	
Film (2.46)	Vëzhgimi i rrethit të dyfishtë në veprim (klasa 5)	6c: Sesion plenar	5'	Projektor, Altoparlant	Sllajdi 9	5'

Aktiviteti 6a:

Përmbledhja e pyetjeve të mbetura lidhur me prezantimin kryesor. (Koha e sugjeruar 10 minuta)

Udhëzime:

A ka ndonjë çështje të hapur lidhur me prezantimin kryesor?

Koha e nevojshme këtu është shumë e vështirë të parashikohet pasi që varet nga shumë faktorë, si mënyra e mbajtjes së prezantimit kryesor, kohëzgjatja e vëmendjes së pjesëmarrësve, njohuritë e tyre të mëparshme etj. - Koha e sugjeruar: 10 minuta.



Nëse ka shumë pyetje të hapura, kërkojuni që t'i shkruajnë ato në tabelë me fleta të mëdha ose letër në metaplan.

Nëse dëshironi mund t'i ndani në kategori (sugjerim: konstruktivizëm, neuroshkencë, Hattie, metoda bashkëpunuese dhe të ndryshme) për të strukturuar procesin.

Kërkojuni që t'i shkruajnë gjatë pushimit të drekës dhe u thoni që do t'i shqyrtoni sërish ato).

Aktiviteti 6b:

Leximi dhe aplikimi i fletëve të metodës

Është shumë e rëndësishme që pjesëmarrësit të mendojnë për aspektet ku, kur dhe si mund t'i përdorin metodat në lëndën e tyre. Përmendeni që së shpejti do të punojnë në grupe të ndërlidhura me lëndën.

Aktiviteti 6c:

Paraqisni një film - një shembull i rrethit të dyfishtë në klasën 5 - mësimi i gjuhës angleze -

Filmi u ndihmon pjesëmarrësve që ta fitojnë idenë e rrethit të dyfishtë.

Ajo tregon se sa shpejt mund të përdoret metoda nëse nxënësit kanë përvojë dhe metoda është e trajnuar.

Për më tepër, elementet e menaxhimit efektiv në klasë në mësimin e gjuhëve të huaja janë të dukshme dhe mund të paraqiten nëse lejon koha. (Paraqitja pamore e fazave të njësisë mësimore, zogu zhvendoset nga nxënësit, nxënësit saktësisht e dinë se çka pritret prej tyre, mësimdhënësi është në komandë të qartë,...)



Pauzë kafeje:

Pauzë kafeje: Gjatë pauzës së kafesë, kontrolloni nëse të gjithë pjesëmarrësit e kanë plotësuar lëndën e tyre në listën përkatëse. (Rendisni nga fillimi) Do t'ju duhen për **aktivitetin. 8**

AKTIVITETI NR. 7

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Prezantimi i metodës qendrore	Njoftimi me metodën	7a Sesioni plenar 5' 7b PI 10'	Fleta e metodës 4: Mendo, Krijo çift, Ndaj me të tjerët	Sllajdi 10	15'

Aktiviteti 7a: **Metoda: Mendo, Krijo çift, Ndaj me të tjerët (MKN) (Sllajdi 10):**



Për informata të hollësishme shikoni fletën e metodës 4.

Udhëzime: shkurtimisht:

- Hapi (Mendo): PI:** Të gjithë mendojnë individualisht. Qëllimi është t'i aktivizoni të gjithë, çdo ide është e mirëpritur. Në këtë mënyrë rritet motivimi dhe pjesëmarrësit bëhen kureshtar për mendimin e të tjerëve.
- Hapi (Krijo çift): PÇ:** Dy pjesëmarrës ndajnë rezultatet e tyre. Me marrjen e informatave kthyesë të partnerëve (nxënësve) pjesëmarrësit sigurohen dhe bëhen më të sigurt për të thënë diçka më pas në sesionin plenar/klasë.
- Hapi (Ndaj me të tjerët): PG/Plenare:** Shumë anëtarë të grupit/klasës bëjnë deklarata/flasin për idetë e tyre në sesionin plenar. Konceptet/idetë e gabuara mund të korrigjohen.

Si trajner ju jepni një sinjal akustik kur mbaron hapi.



Kur e shpjgoni këtë metodë, referojuni prezantimit kryesor dhe rëndësisë së ndërtimit të rrjeteve nervore.

Shpjegime të mundshme shtesë:

- A është e mundur të përdoret kjo metodë në cilëndo klasë - në klasa më të ulëta me gjuhë të thjeshtësuar.
- Ekzistojnë metoda të shumta që ndjekin këtë ide Mendo, Krijo çift, Ndaj me të tjerët (MKN) siç janë "intervista me 3 hapa", "shtroja", "analiza në grup".

Aktiviteti 7b: **Plotësimi i fletës së metodës:**

- Shpërndajeni fletën e metodës 4 (Mendo, Krijo Çift, Ndaj me të tjerët).

Udhëzime:

1. Lexoni fletën e metodës.
2. Plotësoni pjesën e mëposhtme.

AKTIVITETI NR. 8

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Zbatimi i MKN, Hyrje Skedat e rolit për punë grupore	Përdorimi i MKN-së, Njoftimi me çështjet e ndërlidhura me lëndën	8a Sesioni plenar 10' 8b Grupe → (4 – maks. 6) 5' 8c PG (sipas lëndëve) 40'	Fleta e metodës 4, Muret, gjilpërat e meta planit Për grup: 1 set të kartelave të plastifikuara për role, 1 letër e madhe për tabelë, flomastera, letrat ngjitëse, kartelat e moderimit – nëse është e mundur: 2 salla	Slide 11, 12	55'

Aktiviteti 8a: Hyrje në kartat e roleve



Ende në kuadër të sesionit plenar, shpjegoni punën grupore dhe kartat e roleve:

1. Përcjellësi i përmbajtjes: duhet të sigurojë që anëtarët e grupi i përmbahen temës.
2. Dërguesi i porosisë: duhet t'i sjell pyetjet e grupit tek mësimdhënësi.
3. Ligjëruesi: duhet t'i prezantojë rezultatet në sesionin plenar.
4. Përcjellësi i kohës: është përgjegjës për përcjelljen e kohës.
5. Procesmbajtësi: duhet t'i mbajë shënimet gjatë punës grupore.
6. Menaxheri i materialeve: është përgjegjës për sigurimin, mbajtjen dhe kthimin e materialit të nevojshëm.
7. Kujdestari i nivelit të zërit: është përgjegjës për mbajtjen e qetësisë së anëtarëve të grupit.

Madhësia e grupit do të ndryshojë, zakonisht janë ndërmjet 3 dhe 4 anëtarë. Sa më shumë njerëz që janë, aq më pak të përqendruar janë. Maksimumi absolut është 6 anëtarë. Nëse janë më shumë, anëtarët e grupit do të jenë më pak të vëmendshëm, p.sh. 2 – 3 persona punojnë, pjesa tjetër bisedon...).

Pra, shpesh çdo anëtar i grupit është përgjegjës për më shumë se një detyrë.

Shpjegime të mundshme shtesë:

Edhe **në klasat më të ulëta** mund të përdorni punën në grupe: rezultati do të jetë një produkt i përbashkët, që është pastaj faktor kombinues: lërinë të përgatisin alfabetin me brumë, bëni që t'i shkruajnë të gjitha numrat deri në 50, ndërtoni urën së bashku etj. Është e rëndësishme që detyra të krijojë varësi, në mënyrë që të punojnë në bashkëpunim.

Në klasat më të larta: puna në grup mund të zgjasë (shumë) më shumë se një orë mësimore: Le të lëvizin kartat e roleve, kështu që anëtarët e grupit do të njihen me detyra të ndryshme.

Aktiviteti 8b: Korniza organizative



Ndani sesionin plenar në grupe me nga katër – sipas lëndëve. Për më tepër, preferohet gjithashtu që grupet e klasave 1 – 5 dhe 6 – 9 të punojnë së bashku. (Përdorni listën nga fillimi dhe pushimi i kafesë.)



Shpesh keni njërin anëtar tek në mesin e pjesëmarrësve tuaj, të tillë si mësimdhënësi sporti ose arti ose duhet të vendosni lëndë të ngjashme së bashku, si biologjia dhe kimia. Sigurohuni që edhe në këtë grup me lëndë heterogjene ata bashkëpunojnë sa herë që është e arsyeshme.

Udhëzime (Sllajdi 11):

1. Mblidhuni së bashku sipas lëndëve (krijoni grupe në bazë të listës.)
2. Detyra juaj në grup duhet të krijojë një poster i cili do të prezantohet më vonë. Secili anëtar i grupit duhet të jetë në gjendje të paraqesë rezultatit në fund.
2. Shpërndani kartat e roleve në grupin tuaj.

Aktiviteti 8c: Korniza organizative

Udhëzime (Sllajdi 12):

- ✓ Bisedoni për metodat e prezantuara deri më tani.
 - ✓ Përdorni idetë tuaja të fletës së metodës dhe flisni rreth tyre - mundësisht shtoni ide nga partnerët tuaj në fletën tuaj të metodës.
 - ✓ Shkëmbeni idetë: aspekti - Kjo metodë mund të përdoret në lëndën time në këtë fazë.
 - ✓ Pajtohuni për 1 ose 2 prej metodave që dëshironi të provoni së shpejti në klasë.
 - ✓ Pajtohuni për një temë të përshtatshme dhe fazën ku mund të përdorni metodën.
- E rëndësishme: Nëse metoda nuk i përshtatet temës, ndryshoni temën ose aplikoni një metodë tjetër. Metoda gjithmonë e ndjek përmbajtjen.**
- ✓ Bëni një poster për tabelën me fleta të mëdha/meta planin për të publikuar rezultatin e grupit tuaj. Ju lejohet të jeni krijues ...
 - ✓ Shkruani fushën tuaj të temës në pjesën e epërme dhe të gjithë emrat tuaj në një skaj.
 - ✓ Vendosni posterin tuaj në tabelën me fleta të mëdha, mur, meta plan etj.



Si trajner shfrytëzojeni mundësinë për të biseduar me pjesëmarrësit. Pra, ecni përreth, vëzhgoni se çfarë po bëjnë, ndërhyri nëse është e nevojshme, jepni këshilla, përgjigjuni pyetjeve, bëni sugjerime, etj.

PAUZË DREKE

AKTIVITETI NR. 9

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha	
Prezantimi i rezultateve	Përdorimi i metodës: tregu	9a sesion plenar 9b Sesion plenar: PI	20' 10'	Fleta e metodës 5 Tabela e meta planit, sinjali akustik	Slide 13	30'

Aktiviteti 9a: Hyrje ne metoden tregu



Ende në sesionin plenar e shpjegoni metodën “tregu” (**Dorëzoni më vonë fletën e metodës!**)
Për informata të hollësishme, shikoni në fletën e metodës 5.

Udhëzime (Sllajdi 13):

1. Ndani grupet tuaja të punës në dy.
2. Gjysma e grupit do të mbetet te posterit dhe do t'ua shpjegojë vizitorëve. (Vizitorët mund të bëjnë pyetje, të shprehin idetë e tyre etj.)
3. Gjysma tjetër (vizitorët) lëviz përreth dhe shikon posterat e të tjerëve.
Dëgjoni dhe bëni pyetje – sipas mundësisë nxirrni idetë që mund t'i përdorni në mësimdhënien tuaj.
Këshillë: Nëse ekziston një grup tjetër i fushës tuaj lën dore, filloni me atë grup.
4. Pas sinjalit – gjysma e kohës – ndërroni rolet.

Grupet ndahen dhe ecin përreth.



Zakonisht edhe pjesëmarrësit e rritur janë shumë krenarë për posterat e tyre. Pra, sigurohuni që vizitorët të kenë një qëndrim pozitiv dhe ju veçanërisht, t'i vlerësoni rezultatet dhe të bëni fotografi.

Aktiviteti 9b: Plotësimi i fletës së metodës



Sërish në sesionin plenar:
Dorëzoni fletat e metodës 5. Pjesëmarrësit e lexojnë atë dhe e plotësojnë pjesën e poshtme të fletës së metodës së tyre.

Shpjegimet e mundshme shtesë:

Kjo metodë është gjithashtu e mundshme për fëmijët në klasa më të ulëta, por me udhëzime të shkurtra, të qarta dhe një sinjal kur gjysma e anëtarëve të çdo grupi shkojnë dhe vizitojnë posterin tjetër.



Në fund ju gjithashtu mund të ndani vëzhgimet tuaja si trajner, të komentoni në përgjithësi se çfarë ka shkuar mirë, ku rutinat do të duhej të zhvilloheshin, ndani përvojën tuaj kur përdorni këtë metodë etj.

AKTIVITETI NR. 10

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Aplikimi i metodës Intervista me tre hapa	Duke përdorur metodën, tregoni një tjetër MNQ që përdor konceptin MKN	10a Sesioni plenar +PI/ PÇ/ PG (4)/Sesioni plenar 50'	Fleta e metodës 6 Letra shtesë për shkrim, sinjali akustik	Sllajdi 14, 15, 16	60'
		10b PI 10'			

Aktiviteti 10a: Përmbledhja e tekstit Mattes



Në sesionin plenar, shpjegoni metodën "Intervista me tre hapa" (Dorëzoni më vonë fletën e metodës!). Për informata të hollësishme shikoni në fletën e metodës 6.

Dorëzoni tekstin Mattes – është bazë e punës së tyre në këtë fazë.

Udhëzime (Sllajdi 14):

- Lexoni tekstin individualisht dhe nxirrni në pah informata të rëndësishme.
- Shënoni tre pyetje që lidhen me përmbajtjen e tekstit (p.sh. Në cilat faza është domethënëse njësia mësimore "stili i mësimdhënies ballë për ballë".



Kërkoni që të punojnë në çifte.

Udhëzime (Sllajdi 15):

- ✓ Përgjigjuni pyetjeve të partnerit tuaj dhe bëni pyetjet tuaja.



Dy çifte dalin së bashku si grup i ri.

Udhëzime (Sllajdi 16):

- ✓ Shkëmbeni se çfarë do të thotë mesazhi i tekstit për ju si mësimdhënës. A ka kuptim të rishqyrtoni mënyrën tuaj si mësimdhënës? Nëse po, në cilën mënyrë? A ka ndonjë ide që mund të dëshironi të përdorni në planifikimin tuaj në të ardhmen?



Zakonisht, dy çifte mbledhen dhe flasin për pyetjet, përgjigjet e tyre ndaj tekstit. Sot faza përdoret ndryshe, pasi që mësimdhënësia është në fokus, kështu që pjesëmarrësit duhet të kenë mundësinë të reflektojnë nëse përmbajtja e tekstit ka ndonjë ndikim në mënyrën e tyre të mësimdhënies.

Shpjegimi i mundshëm shtesë:

Si mësimdhënës është e rëndësishme të shoqëroni procesin e të nxënësve (individual) të nxënësve tuaj, veçanërisht në fillim dhe në fazën shumë të rëndësishme të mbështetjes kur flisni për rezultatet së bashku.



Aktiviteti 10b: Plotësimi i fletës së metodës



Dorëzoni fletën e metodës 6. Pjesëmarrësit e lexojnë dhe plotësojnë pjesën e poshtme individualisht.

Vetëm nëse ekziston ende nevoja për të diskutuar këtë metodë, bëjeni këtë në sesionin plenar. Përvoja jonë është se pjesëmarrësi e kupton metodën me lehtësi dhe pas një dite të gjatë të ngjeshur, pjesëmarrësit janë të lodhur, por edhe shumë të emocionuar për të gjitha metodat e reja të mësuara.

AKTIVITETI NR. 11

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës		Materialet	PPT	Koha
Informatat kthyesë	Njohja me	11a Individuale	10'	Fletë pune 2,	Sllajdi 17	20'
Metoda me pesë gishta	perceptimin e pjesëmarrësve	11b PI	10'	Fletë metode 7, Informacioni kthyes me 5-gishta		

Informatat kthyesë janë një mjet i rëndësishëm në çdo proces mësimi dhe zhvillimi në grup. Ekzistojnë shumë metoda të ndryshme që mund të aplikohen në varësi të kohës në dispozicion ose përmbajtjes për të cilën dëshironi të merrni informata kthyesë.

Një nga aspektet më të rëndësishme në këtë fazë është që t'u tregoni pjesëmarrësve se informatat kthyesë jepen në mënyrë anonime. Nëse pjesëmarrësi dëshiron të thotë diçka publikisht, ai ka shansin ta bëjë këtë në sesionin plenar që mund të pasojë pas fazës individuale. (Opsionale)

Aktiviteti 11a: Dhënia e informatave kthyesë (Sllajdi 17)



Metoda me pesë gishta nuk merr shumë kohë dhe ka aspekte "argëtuese" në vete - nëse bëhet fjalë për gishtin e mesëm, atë mund ta keqpërdorni nëse dëshironi. Vetë metoda është e lehtë për tu kuptuar dhe e shpjeguar në detaje në fletën e metodës.

Për informata të hollësishme shikoni në fletën e metodës 7
Dora duhet të jetë e disponueshme në një format të rritur për çdo pjesëmarrës.

Activity 11b: Plotësimi i fletës së metodës

Udhëzime:

- Dorëzoni letrën e punës në formatin A4, kërkojuni që ta plotësojnë.
- Pjesëmarrësit duhet ta lënë kopjen e tyre të kthyer mbrapshtë në tavolinën e tyre.
(Alternativ: në një karrige që e vendosni afër hyrjes, ata mund ta lënë letrën gjatë daljes).
- *Ju lutemi shkruani në gishta çka do që dëshironi të thoni për aspektet.*
(Nëse nuk ka vend të mjaftueshëm, shkruani pikat tuaja diku afër gishtit përkatës).

AKTIVITETI NR. 12

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Përmbyllja dhe vështrimi përpara	Dhënia e orientimit	12 Sesioni plenar 10'	Letra e tabelës së madhe (materialet për nesër).	Sllajdi 18	10'

Kjo fazë shpesh nënvlerësohet por është e rëndësishme të garantohet një pjesëmarrje e mirë për të treguar vlerësimin dhe për t'u dhënë pjesëmarrësve një orientim të asaj që i pret nesër.

Aktiviteti 12 Përmbyllja dhe vështrimi përpara

Aspektet për këtë fazë:

Ndarja e perceptimit dhe tregimi i vlerësimit tuaj:

- Ndani vëzhgime pozitive me ta.
- I tregoni diçka që keni mësuar, vëzhguar etj.
- Shprehni një dëshirë për nesër.
- apo...
- Falënderojini për pjesëmarrjen e tyre aktive

Ajo që doni të thoni këtu varet nga ju! Aspekti më i rëndësishëm mbetet origjinaliteti dhe ato që thoni duhet të përshtaten me atë që keni përjetuar gjatë ditës së parë.

Jepni një vështrim për nesër: (Sllajdi 18):

- Nesër do të njiheni me më shumë metoda dhe
- Ne do të reflektojmë në pasojat që aplikimi i metodave të këtij lloji ka për rolet e nxënësve dhe mësuesve.
- Për më tepër, **rrjetëzimi** midis shkollave dhe nivelit shkollor është një problem
- Nesër do të punojmë përsëri në grupe të lidhura me temën.

Gjërat që ju kërkoj t'i sillni nesër

Ju lutem t'i sillni dy gjëra:

1. Planin tuaj të agjendës personale
2. Temat të cilat duhet/do t'i shtjelloni në një të ardhshme të afërt. (javën e ardhshme, muajin e ardhshëm)
3. Natyrisht, nëse dëshironi ose nese materialin e kerkuar e ruani ne laptop, ju mund të merrni me vete edhe laptopet.

Në fund, u thoni që mezi prisni t'i takoni nesër në orën 9.

AKTIVITETI NR. 1

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Hapja e ditës së 2-të	Hapësirë për pyetjet e mbetura, shqyrtimi i strukturës dhe objektivave të ditës	A1 Sesioni plenar	Projektor, sinjal akustik për të filluar	Sllajdi 1, 2	15'

Faktor të përgjithshëm për t'u marr parasysh para aktivitetit të parë: (Sllajdi 1)

Po ashtu edhe në ditën e dytë secilit i pëlqen të mirëpritet nga ju. Kështu që sigurohuni që t'i përhëndetni të gjithë, ndoshta thjesht vetëm me një buzëqeshje dhe me disa fjalë miqësore. Gjatë punëtorisë mbetet me rëndësi që t'i drejtoheni çdo personi me emrin e tij/saj. Prandaj, kërkoni nga pjesëmarrësit që t'i mbajnë kartelat me emrat e tyre nga dita paraprake.

Aktiviteti 1: Objektivat për ditën e sotme

Udhëzimet:

- A ka ndonjë pyetje e mbetur nga dje - çfarëdo mendime të reja që ju kanë ra ndër mend?

Shqyrtimi i objektivave të ditës së sotme: (Sllajdi 2)

- **Qëllimi kryesor përsëri:** rritja e aktiviteteve të nxënësve/mësimnxënësve aktive
- Fokusimi në rolin e mësimdhënësve dhe nxënësve
- Metodatat më të dobishme (komplekse), bazuar në disa kontekste teorike
- Grafiku i kompetencave dhe vet-vlerësimi i nxënësve
- Planifikimi konkret i metodave të zbatueshme në fushat lëndore
- Koha për shkëmbim dhe krijim të rrjetit

Veprimi pasues: Shkurtimisht pyetni pjesëmarrësit nëse kanë ndonjë pyetje në lidhje me objektivat.

AKTIVITETI NR. 2

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Shtroja	Aplikimi i ndonjë metode tjetër	2a Sesioni plenar 10' 2b PG (4/3) 20'	Projektor, sinjal akustik, tabela me letra të mëdha për secilin grup:	Sllajdi 3	60'
	Reflektimi për rolin ndryshe të mësimitdhënësit	2c Sesioni plenar 20' 2d PI 10'	Letra të formatit A3 për shtrojën 1 kartë e moderimit dhe marker, metaplan, gjilpëra		

Aktiviteti 2a

Prezantimi i metodës



Metoda shkurtimisht:

- Hapi (mendo): PI: Të gjithë shkruajnë mendimet e tyre në lidhje me një temë të caktuar në pjesën e tyre. Zakonisht 2 – 3 minuta janë të mjaftueshme.
- Hapi (ndaj me të tjerët): PI: Pastaj letra kthehet në drejtim të akrepave të orës, në mënyrë që të gjithë të lexojnë deklaratat e anëtarëve të tjerë të grupit.
- Hapi (ndaj me të tjerët): PG: Grupi diskuton deklaratat dhe pajtohet për 2 ose 3 ide kryesore të cilat duhet të shkruhen në pjesën e mesme.
- Hapi (ndaj me të tjerët): PG: Deklarata më e rëndësishme duhet të shkruhet në kartën e moderimit.
- Hapi (ndaj me të tjerët, sesioni plenar): Kartat e moderimit grumbullohen dhe vendosen me gjilpërë në një metaplan, ku përdoren për diskutim plenar në lidhje me temën e dhënë.


Si trajner jepni një sinjal akustik në fund të çdo hapi.

Për informata më të hollësishme, shikoni **Fletën e Metodës 8, Shtroja**.



Kur e shpjgoni metodën, është më lehtë ta kuptoni nëse e skiconi fletën e shtrojës (në rritje) njëkohësisht në një letër të madhe në tabelë.

Filloni me pjesën e mesme. Më vonë mund të shërbejë edhe si model për punimin e tyre.



Gjithashtu, kur e shpjgoni këtë metodë, referojuni prezantimit, rëndësisë së ndërtimit të rrjeteve nervore dhe konstruktivizmit.

Aktiviteti 2b

Puna me shtrojë



Ndajini pjesëmarrësit në grupe me jo më shumë se 4 persona! Është më mirë të keni më shumë grupe me nga tre veta se grupe më të mëdha, sepse atëherë ka më shumë kohë për diskutim në grup. Është e lehtë të skicosh vetëm tre pjesë në një letër: Filloni me pjesën e mesit, pastaj ndani pjesën tjetër të letrës në tre pjesë.

Sipas përvojës sonë, pjesëmarrësit përpiqen të flasin gjatë hapit 1 ose 2. Jini shumë të rreptë këtu! Duhet të jetë absolutisht qetësi në sallë!

Përmendni se do të ketë kohë të mjaftueshme për shkëmbim mendimesh më pas. Ndoshta duhet t'i referoheni përsëri konstruktivizmit (kontributi teorik i djeshëm, sllajdi që tregon se si të ndërlidhim rrjedhën e ujit me mundësitë e ndryshme).

- Dorëzoni një letër të formatit A3 për secilin grup.



Gjatë hapit 1 dhe 2, shpërndani kartën(at) e moderimit dhe markerin për secilin grup.

Udhëzimet: (Sllajdi 3)

- ✓ Hapi 0: Ju lutem, vizatoni shtrojën.
- ✓ Hapi 1: Shkruani mendimet tuaja në deklaratën më poshtë në pjesën tuaj:
Kjo është mënyra se si roli im si mësues/ndryshon nëse i bëj nxënësit e mi të punojnë më të pavarur!
- ✓ Hapi 2: Nëse të gjithë janë gati, lëvizni letrën në drejtim të akrepave të orës dhe lexoni shënimet e tjera.
- ✓ Hapi 3: Diskutoni dhe jepni prioritet ideve të grupeve tuaja. Pajtohuni për 2 ose 3 idetë kryesore dhe shkruajini ato në pjesën e mesme.
- ✓ Hapi 4: Shkruaj atë më të rëndësishmen në një kartë.
- ✓ Hapi 5: Më vonë, do t'ju kërkohet të vendosni kartën tuaj në një tabelë dhe të shpjegoni shkurtimisht pse e konsideroni si më të rëndësishmen.

Aktiviteti 2c

Diskutoni rezultatet.



Në sesionin plenar: Kërkojuni pjesëmarrësve të vendosin kartën e tyre me një shpjegim të shkurtër. Gruponi kartat – ose kërkoji një pjesëmarrësi ta bëjë këtë. Pastaj diskutoni çështjet.

Aktiviteti 2d

Puna me fletën e metodës



Dorëzoni **fletën e metodës 8** dhe kërkonin nga pjesëmarrësit që ta lexojnë dhe plotësojnë pjesën e poshtme individualisht.

Shpjegime të mundshme shtesë ndaj metodës - shtroja:

Aplikimi i shtrojës me fëmijë më të rinj:

- nuk përdoret në klasën 1 + 2, vetëm nga klasa 3 e tutje, atëherë kur dinë të lexojnë dhe të shkruajnë.
- Klasa 3: zvogëlo kompleksitetin

Me nxënësit më të vjetër, klasa 8 + 9 e tutje:

- rritni kompleksitetin
- insistoni mbi reflektimin
 - > sipas procesit individual të punës (mundësisht qëndrimin)
 - > sipas problemeve/sfidave në procesin e punës
 - > sipas pjesëve të realizuara mirë

Diskutimi i mundshëm i meta-nivelit në sesionin plenar:

A është metoda përgjithësisht e aplikueshme? Mundësitë/kufizimet. (Në lëndën e tyre?)

AKTIVITETI NR. 3

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Stacioni i autobusit	Zbatimi i një metode tjetër sidomos për grupin heterogjen në lidhje me shpejtësinë	3a Sesioni plenar 3b PÇ 3c PI	5' 1 shenjë stop (e plastifikuar) në gjuhën shqipe (apo angleze) 15' 1 fletë me mangësi në fotografi për person, fletë me zgjidhje 10' Fleta e Metodës 9, Stacioni i Autobusit	Sllajdet 4,5	30'

Aktiviteti 3a

Prezantimi i metodës



Shpjegoni metodën dhe qëllimin e saj.

Shkurtimisht: Të gjithë pjesëmarrësit punojnë individualisht deri të përfundojnë detyrën e tyre. Pastaj marrin fletën e tyre të punës dhe ecin deri te stacioni i autobusit. Këtu, ata presin që personi tjetër të vijë dhe të krahasojë përgjigjet e tyre. Nëse nuk mund të pajtohen për përgjigjen e duhur ose kanë nevojë për një konfirmim, ata shikojnë fletën e zgjidhjeve.

Për informata më të hollësishme shikoni [Fletën e Metodës 9](#).

Është vëzhguar gjithashtu në punëtoritë tona, kështu që tregoni para fillimit: "Gjithashtu, veçanërisht fëmijët më të vegjël kanë prirje të presin që shoku i tyre të bëhet gati. Nëse e vëreni këtë, flisni për të në klasë dhe sigurohuni që të mos ndodhë kur e përdorni përsëri metodën."

Gjithashtu, në aktivitetin vijues ne morëm "fleta të gabuara". Vetëm për argëtim të pjesëmarrësve. Ata e pëlqyen atë dhe u krijua një atmosferë e këndshme. Sidoqoftë, ju mund të dëshironi të zgjidhni një temë më serioze ose të rëndësishme.

Aktiviteti 3b

Puna me metodën

Udhëzimet (Sllajdi 4):

- ✓ Hapi 1: Realizoni aktivitetin – këtu: Gjeni gabimin duke i krahasuar fotografitë!
- ✓ Hapi 2: Nëse jeni gati, ecni deri te stacioni i autobusit dhe prisni aty derisa të bëhet gati tjetri me radhë.
 - Te stacioni i autobusit do ta gjeni fletën me zgjidhje – përshkruani me saktësi se ku i keni gjetur gabimet dhe krahasojeni atë me partnerin tuaj.
 - Përdorni fletën e zgjidhjeve, vetëm nëse është e nevojshme!
- ✓ Hapi 3: Tek stacioni i autobusit ju gjithashtu do të gjeni se çka duhet bërë tjetër. Kthehuni tek vendi i juaj dhe vazhdoni me aktivitetin pasues.

Detyrë për aktivitetin pasues:

Zgjedhja

- ✓ Merrni një fletë tjetër me gabime.
- ose
- ✓ Bisedoni me partnerin tuaj për atë se cili aktivitet vijues mund të bëhet me ata që janë të gatshëm, qoftë në lëndën tuaj, qoftë në përgjithësi.

Aktiviteti 3c

Puna me fletën e metodës



Dorëzoni [Fletën e Metodës 9](#) dhe kërkoni nga pjesëmarrësit që të lexojnë dhe plotësojnë pjesën e poshtme individualisht.

Shënim: Sllajdi 5 ju jep vetëm lidhje me fletët e gabuara, sepse mësimdhënësit e shkollës fillore dëshirojnë t'i përdorin ato në mësimet e tyre. Ka shumë të tilla në internet.

PAUZË PËR KAFE

AKTIVITETI NR. 4

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Dhënia dhe marrja e informatave kthyesë	Informatat kthyesë – si mund ta bëjnë me sukses këtë bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit	4 Sesioni plenar 40'	Tabela me letra të mëdha për shembujt e skicave për skemat/fletat, formatet e vlerësimit	Sllajdet 6, 7	40'

Aktiviteti 4 Informatat kthyesë (Sllajdi 6):



Informatat e përgjithshme të cilat duhet mbuluar:

1. Informatat kthyesë përmbledhëse kundrejt atyre formuese

Informatat kthyesë përmbledhëse: ju kryesisht jepni nota për testet në klasë etj. (p.sh. në fund të njësisë mësimore)

Informatat kthyesë formuese: ju jepni informatat kthyesë (individuale) gjatë procesit mësimor, në mënyrë që nxënësit të mund ta ndryshojnë mënyrën e tyre të të punuarit / menduarit / dhe sjelljeve.

2. Sandviçi i informatave kthyesë:

(apo fotografia më moderne e hamburgerit).

Koncepti: Kur jepni informata kthyesë, gjithmonë filloni me diçka pozitive/ju lumtë për punën e bërë (pjesa e epërme e bukës) → vendosni informata kritike në pjesën e mesme (të pjesës së mishit), gjithmonë e kombinuar me një sugjerim konstruktiv → gjithmonë përfundoni me diçka pozitive (pjesa e poshtme e bukës). Shakaja ime: nganjëherë nxënësit kanë nevojë për hamburger të dyfishtë!

3. Dhënia e informatave kthyesë

Idetë për mësimdhënësit

- Përdorni sandviçin e informatave kthyesë.
- Bëni sugjerime se çfarë mund të përmirësohet (dhe si)
- Përdorni një grafik të kompetencave (më shumë informata rreth kësaj në aktivitetin vijues), por një shembull: (Sllajdi nr. 7)
- Edhe deri në klasën 7/8 shkruaj diçka pozitive nën letrat ose projektet e nxënësit si: Më pëlqen më së shumti kjo ... (edhe nëse është thjesht një vizatim ose një figurë kopertine)

4. Promovoni vetë-përgjegjësinë/vetë-reflektimin:

Referojuni prezantimit kryesor dhe konstruktivizmit. Shpjegoni kuptimin e vetë-reflektimit dhe vetë-përgjegjësisë për procesin individual mësimor dhe më vonë për proceset e qëndrueshme të të mësuarit të pavarur. Flisni për vetë-efikasitetin dhe kuptimin e tij për motivimin e brendshëm.

Shpjegimet e mundshme shtesë:

Në klasat e ulëta (1/2):

- Hapi: le ta vizatojnë nxënësit një kurorë (ose çdo fëmijë ka një gur të vogël/një send tjetër të vogël të preferuar)
- Hapi: p.sh. të mësuarit se si të shkruaj: shkronja/fjala ime më e mirë, etj. sot, faqja ime më e mirë, vizatimi sot: kjo është ku e vendosi gurin tim, ku e vizatoj kurorën Koha-> e orientuar drejt produktit
- Hapi: nëse fëmija tashmë mund ta bëjë këtë: fëmija thotë se përse diçka ishte e bukur, një shembull i mirë, ndoshta se si ai/ajo e ka realizuar atë --> duke shikuar dhe fokusuar në fuqinë personale dhe në proces!

Në klasa më të larta (madje edhe në të mesme të ulët):

Kërkojuni atyre të plotësojnë fletët e vetëvlerësimit. Ndoshta e kombinoni atë me një perspektivë tjetër/të jashtme të një bashkëmoshatare ose të juaj si mësimdhënëse.



Ndoshta thjesht vizatoni një hamburger ose një hamburger të dyfishtë në një tabelë me fleta të mëdha ndërsa po e shpjgoni konceptin. Me nxënësit që janë mësuar me dhënien e informatave kthyesë, mund të dëshironi të krijoni sugjerime së bashku. Gjithash-tu, mund të mendoni për një afat kohor që është domethënës.



Formate dhe shembuj për grafikët e vlerësimit i gjeni në shtojcën (faqet), por ka edhe shembuj të panumërt në internet.

AKTIVITETI NR. 5

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha	
Tabelat e kompetencave	Zbatimi i metodës dhe zhvillimi i tabelës së kompetencës	5a Sesioni plenar 5b Pl/PG (e ndërlidhur me lëndën)	15' 30'	Shembujt e tabelave të kompetencave, formatet	Sllajdet 7, 8	45'

Aktiviteti 5a Tabelat e kompetencave (Sllajdi 7/ 8):



Informatat e përgjithshme që duhet mbuluar:

Tabelat e kompetencave janë një formë e vetë-vlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm.

Kjo është mënyra e leximit të tyre.

Nga e majta në të djathtë kolonat tregojnë zhvillimin ose rritjen e një kompetence në një lëndë (p.sh. në mësimin e gjuhës: është në gjendje të shkruajë në fjali të thjeshta kryesore --> në fjali të thjeshta kryesore dhe vartëse --> gjithashtu përdor një larmi mbiemrash dhe foljesh etj). Rreshtat tregojnë çështje të ndryshme për një kompetencë, në shembullin e dhënë për të shkruarit. Sa më shumë që shkoni në të djathtë, aq më e zhvilluar është kompetenca.

Ekzistojnë kryesisht dy lloje:

1. Pyetja dhe buzëqeshjet (sllajdi 7): këto nuk rekomandohen në klasa më të larta, sepse pyetjet duhet të shpjegohen: Nxënësit kanë prirje që thjeshtë t'i mbledhin dhe të gjejnë një notë pa marr parasysh rëndësinë e ndryshme të pyetjeve.
2. Çdo nivel i kompetencave duhet të përshkruhet saktësisht (sllajdi 8). Kjo mund të bëhet nga një mësimdhënës për lëndën/njësinë e tij/saj. Ose mësimdhënësit e një lënde në shkollë bashkohen dhe zhvillojnë grafika për njësi, të cilat mund të përdoren nga të gjithë. Kjo kursen shumë kohë! Ju gjithashtu mund të gjeni shembuj të shumtë në internet.

Një mundësi për të përfshirë vlerësimin formues në proces:

- Nxënësit e vlerësojnë veten e tyre në fillim të një njësie/teme (me një ngjyrë) dhe përsëri në fund (me një tjetër ngjyrë): Në atë mënyrë të mësuarit dhe zhvillimi i kompetencave shtesë ose një rritje në kompetenca bëhet e dukshme. Padyshim, edhe dobësitë...
- Mësimdhënësit mund të kombinojnë vetëvlerësimin e nxënësve me vlerësimin e tyre: Ata mund të bëjnë komente mbi grafikët me një tjetër ngjyrë dhe të flasin për dallimin me nxënësin.

Aktiviteti 5b Zhvillimi i Tabelës së Kompetencave



Pjesëmarrësit ndahen sipas lëndës dhe pastaj nëse është e mundur, madje edhe në grupe të ndërlidhura sipas klasave. Ata zhvillojnë një tabelë të kompetencave për një njësi, temë apo edhe vetëm një pjesë të saj.

Udhëzimet:

- ✓ Ndahuni në grupe të lidhura me lëndë ose klasë dhe vendosni për një temë ose njësi për të cilën dëshironi të krijoni grafik të kompetencave.
- ✓ Nëse nuk ka askush që jep mësim në të njëjtën klasë/temë si ju, krijoni një grafikë për veten tuaj dhe lëri dikë të së njëjtës lëndë të japë komente më pas.
- ✓ Përdorni materialin që keni sjellë me vete.
- ✓ Sigurohuni që nuk punoni për asgjë: Përdorni një temë që me të vërtetë do ta shfjelloni gjatë javës(ëve) në vijim.



Sigurohuni që të gjithë të punojnë me materiale për diçka që mund të përdorin me të vërtetë gjatë mësimeve të tyre të ardhshme! Ecni përreth, ndani vëzhgimet tuaja me ta dhe të jeni të gatshëm të ndihmoni dhe të bisedoni me ta. Gjatë punëtorisë vijuese ju mund t'i pyesni pjesëmarrësit për përvojat e tyre me atë metodë.

Shënim: Tregojuni pjesëmarrësve që pas pushimit të drekës do të qëndrojnë në grupet e tyre të ndërlidhura me temat.

PAUZË E DREKËS

AKTIVITETI NR. 6

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Planet javore	Zbatimi i metodës dhe zhvillimi i planit javor	6a Sesioni plenar	20' Shembujt e planeve javore,	Sllajdet 9	60'
		6b PG (e ndërlidhur me lëndën)	5'		
		6c PI/PG	35'		

Aktiviteti 6a Hyrje në planet javore



Aspekt i rëndësishëm për ligjëruesin

Para se të filloni të shpjegoni këtë metodë, sigurohuni që të gjithë e kuptojnë se ka një problem me emërtimet! Në Kosovë "plani javor" (ose edhe plani mujor) do të thotë plani, të cilin mësimit duhet ta përgatisë dhe t'ia dorëzojë drejtorit para se të japë mësim. Kjo shpesh shihet si një lloj kontrolli, një kontroll i asaj se çka një koleg ka planifikuar në të vërtetë. Plani javor të cilin i referohet këtu, do të thotë diçka krejt tjetër.

Inputi – informatat që duhet mbuluar:

- Mësimdhënësi zhvillon një plan për një javë me të cilin nxënësit duhet të punojnë. (Nëse ka vetëm dy mësimet në javë, ju mund të dëshironi të mbulonit më shumë se një javë.) Nxënësit punojnë kryesisht në mënyrë të pavarur dhe vet. Nëse mësimit janë mësuar me atë mënyrë të mësimit, ata madje zhvillojnë plane për të njëjtën temë në nivele të ndryshme për klasën e tyre heterogjene.
- Arsyja prapa kësaj: Nxënësit duhet të mësojnë të menaxhojnë kohën e tyre! Kjo duhet të bëhet në situata ku ata trajtohen. Në këtë mënyrë nxënësit mësojnë se ata janë gjithashtu përgjegjës për procesin e tyre të të nxënës. Detyrat duhet të trajtohen çdo ditë dhe duhet të merren me to përpara testit përkatës.
- Shpesh, nxënësit janë të lirë të zgjedhin, me cilën pjesë dëshirojnë të fillojnë → ajo mënyrë e mësimit ka një ndikim tek mësimit dhe roli i tyre. Ata duhet të kenë parasysh se detyrat nuk mund të bëhen më të vështira nga hapi në hap, por se duhet të ketë detyra të ndryshme të cilat janë disi të mbyllura në vetvete.
- Nëse një mësimit dëshiron të fillojë me një plan javor të një niveli për një klasë të trajtuar, ai/ajo duhet të krijojë detyra të cilat janë të detyrueshme për të gjithë, dhe duhet të sigurojë detyra shtesë që janë opsionale për nxënësit me nota të larta dhe ata që punojnë shpejt.
- Në varësi të lëndës, mësimit mund të japë një renditje të caktuar të lëndëve që ai/ajo e konsideron kuptimplotë (p.sh. në mësimin e gjuhëve të huaja).

Në klasat më të ulëta:

- mësimit fillon me një plan ditor ose edhe gjysmë-ditor (pastaj, gradualisht rrit kohëzgjatjen e periudhës).
- mësimit gjithmonë mundësojnë kohë për reflektim në fund të çdo dite/njësie mësimore. Në këtë mënyrë nxënësit gradualisht bëhen ekspertë për të nxënës e tyre
- mënyrat për të pasqyruar proceset e të nxënës në klasat e ulëta janë, testimi i gishtit të madh ose biseda të drejtuara në një rreth klase për shembull. Mësimit duhet të japin një impuls këtu si:
 - Çka keni mësuar sot?
 - A keni punuar mirë/në mënyrë të përqendruar / ...
 - Çka ju ka pëlqyer më së shumti sot?

Në klasat më të larta:

Nëse nxënësit tashmë janë trajtuar, atëherë mësimit fillojnë me aplikimin e planit javor me disa ditë, mbase dy ditë nëse duhet të prezantohet metoda. Dhe padyshim që reflektimi bëhet më kompleks. Nxënësit mund të flasin me bashkëmohatarët e tyre ose personin që ulet pranë tyre për arritjet e tyre ose ku kanë pasur ngecje dhe të japin arsye pse diçka ka funksionuar dhe diçka jo.



Ju mund të dëshironi të përmendni se sigurisht që ekziston mundësia e zhvillimit të planit javor në të gjithë kurrikulën. Me fjalë të tjera, dy ose më shumë lëndë mund të zhvillojnë bashkërisht një plan javor dhe kështu t'i qasen një teme nga kënde të ndryshme.

Shpjegimi i mundshëm shtesë

Në Gjermani, planet javore shpesh zbatohen qysh në klasën e parë të shkollës fillore.

Në përgjithësi, nëse punoni në një mënyrë të tillë, kjo nënkupton shumë përgatitje në fillim, por padyshim më pak kur nxënësit i trajtojnë detyrat e dhëna. Dhe gjatë njësive mësimore, mësimdhënësit kanë shumë më shumë kohë për të mbështetur fëmijët individualisht!

Aktiviteti 6b Shqyrtimi i mostrave (Sllajdi 9)

Dorëzoni disa plane javore si shembuj dhe lërnini pjesëmarrësit që të ngrenë pyetje në grupe me nga katër veta.

Udhëzim:

✓ Shikojini mostrat. Flisni për to dhe ngritni ndonjë pyetje nëse keni.

Aktiviteti 6c Zhvillimi i planit javor**Udhëzimet:**

- ✓ Qëndroni në grupet tuaja të lidhura me lëndën ose klasën dhe vendosni për një temë për të cilën do të hartoni një plan javor. Këshillohet që ta bëni këtë për të njëjtën temë për të cilën keni zhvilluar grafikun e kompetencës.
- ✓ Nëse nuk ka askush që jep mësim në të njëjtën klasë/temë me ju, zhvilloni një plan javor për veten tuaj dhe kërkonit prej dikujt nga lëndët e ngjashme të japë informata kthyesë më pas.
- ✓ Përdorni materialin që keni sjellë me vete.
- ✓ Sigurohuni që nuk punoni për asgjë: përdorni një temë që me të vërtetë do ta zhvilloni në mësim gjatë javës(ëve) në vijim.



Sigurohuni që të gjithë të punojnë me materiale për diçka që do të përdorin me të vërtetë gjatë mësimeve të tyre të ardhshme! Ecni përreth, bisedoni me ta dhe ndihmohuni. Gjatë punëtorisë vijuese ju mund t'i pyesni pjesëmarrësit për përvojat e tyre me atë metodë.

AKTIVITETI NR. 7

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Krijimi i rrjeteve	Krijoni rrjete brenda shkollës dhe ndërmjet shkollave (të një komune)	Grupet e ndërlidhura me temën – shkollën 7a PG 10' 7b PG/PI 30' 7c PG 5' 7d PG 10'	Fletë pune vetë-reflektimi: 1pP	Sllajdet 10 - 14	60'

Aktiviteti 7a

Formohen grupet e ndërlidhura me temën (sllajdi 10)



Grupet janë ende të ulur në grupet e ndërlidhura me temën.

Aspektet për ligjëruesin

Kjo fazë tjetër është për krijimin e rrjeteve që ndërlidhen me lëndët ndërmjet shkollave (të një komune) por edhe brenda një shkolle. Ky rrjetëzim është i rëndësishëm për të zbatuar metodat e sapo mësuara në shkollë, për të mbështetur njëri-tjetrin, për të shkëmbyer materiale dhe ide, etj.

Në këtë punëtori jepet koha për tu organizuar, së pari nga jashtë dhe më pas nga brenda dhe shpesh zbatohen hapat që përdoren në trajnim.

Udhëzimet:

- ✓ Qëndroni së bashku në grupet tuaja sipas lëndëve. Nëse janë më të mëdha se 5 veta, ndani sipas klasave 1 - 5, 6 - 9 ose sipas komunave.
- ✓ Kërkojini një anëtar të grupit të shkruajë emrat dhe adresat e postës elektronike për t'ia dërguar me postë elektronike anëtarëve të tjerë të këtij grupi.
- ✓ Ju lutemi caktoni një anëtar që ndihet përgjegjës për këtë grup (dhe jepjani këtë emër ligjëruesit për një kontakt të mundshëm me të).

Aktiviteti 7b

Pajtohuni rreth metodës dhe gjeni tema të përshtatshme (Sllajdi 11/12)



Pjesëmarrësit vijnë së bashku në grupet e tyre shkollore me të gjitha materialet dhe gjërat e tyre. Si një grup shkollore, ata duhet të pajtohen për një ose dy metoda që duan të provojnë dhe të dokumentojnë në takimin e ardhshëm. (dita 3 dhe 4)

Për atë arsye, të gjitha metodat e prezantuara deri më tani shqyrtohen shkurtimisht edhe njëherë. (Sllajdi 11)

Udhëzimet: (Sllajdi 12)

- PG: Pajtohuni për një ose dy metoda që dëshironi të provoni në muajin tjetër (deri në punëtorinë tjetër).
- PI: - Merrni rreth 10 minuta kohë dhe shkruani kur dhe në cilën klasë individualisht dëshironi të përdorni atë metodë.
- Mendoni për **një temë të përshtatshme së pari**, dhe pastaj mundësisht i përdorni shënime të tuaja në fletat e metodës.
- Skiconi idenë që keni. Nëse keni kohë, përgatitni mësimin në më shumë detaje. Shkruani idetë tuaja.
- PG: Shkurtimisht, tregojuni të tjerëve për planet tuaja (metoda 'Në qendër të vëmendjes', 30 - 60 sekonda).

Aktiviteti 7c

Caktoni takimin e parë në shkollë (Sllajdi 13)

Informatat që duhet mbuluar



“Meqenëse jeni një grup nga e njëjta shkollë, ne ju kërkjmë të shkëmbeni ide herë pas here ose edhe të punoni së bashku për të kursyer kohë. Meqenëse fillimi është gjithmonë më i vështiri, ne do të dëshironim që ju të pajtohni për një ditë dhe kohë të javës se kur do të keni takimin tuaj të parë.”

Udhëzimet:

- ✓ Shkurtimisht, shkëmbeni idetë tuaja (metoda ‘Në qendër të vëmendjes’, 30 – 60 sekonda) në lidhje me një mënyrë të përshtatshme për tu takuar në shkollën tuaj.
- ✓ Pajtohuni për një datë fikse kur mund të takoheni, mundësisht javën tjetër. Përdorni kohëmatësit tuaj!
- ✓ Shkruajeni në një copë letër.

Aktiviteti 7d

Hyrje në fletën e vetë-reflektimit (Sllajdi 14)



Për të promovuar shkëmbimin në shkollë jepuni pjesëmarrësve ide për temat për të cilat mund të flasni. Për informata më të hollësishme shikoni në sllajdin 14.

Dorëzoni fletët individuale të punës “vetë-reflektimi” (që mund të gjenden në shtojcë).

Udhëzimet:

- ✓ Pas kësaj punëtorie, kur provoni metoda të reja dhe filloni të jepni mësim ndryshe, individualisht reflektoni mbi ndryshimet me ndihmën e këtij dokumenti. Dhe gjithashtu mund të dëshironi ta përdorni atë gjatë takimeve tuaja në shkollë për të krahasuar përvojat tuaja me përvojat e të tjerëve.
- ✓ Ju lutemi ta keni këtë fletë reflektim me vete në punëtorinë vijuese.



Sigurohuni që të merrni vërtet të gjitha listat e postës elektronike. Personi përgjegjës për një grup të caktuar duhet të jetë i shënuar. Kjo rrit angazhimin dhe kërkon më shumë besueshmëri.

AKTIVITETI NR. 8


Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Informatat kthyesë Rrethi i synuar	Njoftimi me perceptimin e pjesëmarrësve	8 P1 Sesioni plenar (opsionale)	20' Fleta e metodës 10, rrethi i synuar	Sllajdi 15	20'

Aktiviteti 8 Dhënia e informatave kthyesë (Sllajdi 15)

Siç është përmendur tashmë në ditën e parë, informatat kthyesë janë mjet i rëndësishëm në çdo proces mësimor dhe të zhvillimit grupor.

Rrethi i Synuar është një metodë e dhënies së informatave kthyesë të cilën mësimdhënësit lehtë mund ta përshtatin për çdo temë dhe pyetje për të cilën duan një përgjigje nga klasa. Me vetëm disa fotografi të prera përreth rrethit, ajo mund të përdoret madje edhe në klasën e parë.

Për informata më të hollësishme shikoni fletën e metodës 10.



Rrethi i Synuar duhet të jetë në dispozicion në një format të rritur (formatit A4) për çdo pjesëmarrës.

Udhëzimet:

- Dorëzoni letrat e formatit -A4 dhe kërkojini që t'i plotësojnë.
- Pjesëmarrësit duhet ta lënë kopjen e tyre të kthyer mbrapsht në tavolinën e tyre.
(Në mënyrë alternative: në një karrige që e vendosni afër hyrjes, ata e lënë letrën kur të dalin.)
- Tregojuni përsëri se shënimet e tyre janë anonime.

✓ *Ju lutemi vendoseni një x në secilën pjesë ku dëshironi të jepni informata kthyesë. Qendra qëndron për më të mirën, skaji për atë që nuk është realizuar.*

✓ *Ju lutemi plotësoni edhe 2 kutitë poshtë rrethit. (Nëse nuk ka vend të mjaftueshëm, mund të përdorni edhe pjesën e pasme të letrës.*



Nëse pjesëmarrësit dëshirojnë të ndajnë diçka në mënyrë publike, ata duhet ta kenë këtë mundësi.

AKTIVITETI NR. 9

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Përmbyllja dhe planet e ardhshme	Dhënia e orientimit	9 Sesioni plenar 10'	Fleta të tabelës së madhe me të gjitha ato që i kërkon t'i sjellin.	Sllajdet 16, 17	10'

Aktiviteti 9 Përmbyllja dhe planet e ardhshme (Sllajdet 16, 17)

Kjo fazë shpesh nënvlerësohet, por është e rëndësishme të tregohet vlerësimi për të garantuar një pjesëmarrje të mirë dhe për t'i dhënë pjesëmarrësve një orientim të asaj që pritet herën tjetër.

Aspektet për këtë fazë:

Ndarja e perceptimit tuaj dhe shfaqja e vlerësimit:

- Ndani vëzhgime pozitive me ta.
- Tregojuni diçka që keni mësuar, vëzhguar etj.
- Shprehni një dëshirë për punëtorinë e ardhshme.
- apo...
- Falënderojini për pjesëmarrjen e tyre aktive.

Përmendni gjërat të cilat pjesëmarrësit duhet t'i sjellin në punëtorinë e ardhshme (Sllajdi 16):

Udhëzimet:

Tri gjërat të cilat do të dëshiroja që ju t'i sillnit në punëtorinë e ardhshme:

1. Një lloj dokumentacioni dhe fleta të reflektimit për metodën/at që keni vendosur të provoni.
(Përdorni fletën e dhënë të reflektimit!)
2. Grafiken e kompetencave që e keni zhvilluar për një nga klasat tuaja. (Mund të përdorni fletën e zbrazët të dhënë nëse dëshironi).
3. Materialet për planifikimin e mësimit për një nga klasat tuaja. (Tekstet, librat e punës, materialet e pavarura të librave shkollorë etj).

Jepni një pasqyrë për punëtorinë e ardhshme (Sllajdi 17):

Ndani përvojën tuaj dhe tregoni mirënjohje:

- Reflektime mbi metodat e zbatuara në nivelin e shkollës
- Prezantimin kryesor mbi Mësimin e Bazuar në Detyra (MBD) – duke ofruar kontekstin për atë mënyrë të planifikimit të mësimit
- Planifikimi aktual i një sekuence mësimesh për një temë. (Pra, ju lutemi sillni së bashku materialet tuaja mësimore aktuale).
- Më shumë metoda dhe fletë metode
- Intensifikimi i rrjetit



Ndërmjet dy moduleve duhet të ju dërgohet "një letër pjesëmarrësve". Ju e gjeni formën në shtojcë si "dokumenti për trajnerin 3."

Prapavija e objektivave

- 1** Nxënësit në një botë moderne duhet të zhvillojnë kompetencat e duhura që sigurojnë qasje në informacion dhe aftësinë për të përpunuar dhe ri-organizuar në mënyrë të pavarur informacionin. Ata duhet të mësojnë individualisht, të punojnë së bashku në një ekip, të shkëmbejnë mendime dhe të negociojnë rezultate. Një proces i tillë kërkon shumë kohë në të cilin nxënësit mësojnë në mënyrë aktive për veten e tyre me ndihmën e një mësimitdhënësit. Në këto faza, mësimitdhënësit janë moderatorë sesa trajnerë. Nxënësit mësojnë në mënyrë aktive, mbase ndjekin rrugë ose ide të gabuara, paraqesin rezultatet e tyre dhe reflektojnë mbi to.
- 2** Për të ditur pse kjo ndryshim në paradigme (nga udhëzimet kryesisht paraprake të të mësuarit bashkëpunues) është kuptimplote do të sigurohen disa sfond shkencor që ju ndihmon të kuptoni dhe ndoshta të shpjegoni bazën teorike të qasjes së re.
- 3** Metodatat e bashkëpunimit ndihmojnë jashtëzakonisht në rritjen e kohës së të nxënës të të gjithë studentëve pasi që shpesh të gjithë nxënësit mund të jenë aktiv në të njëjtën kohë ose duhet të kontribuojnë diçka në temë.
Si pasojë, metoda të ndryshme janë në fokusin e kësaj punëtorie. Do t'i mësoni t'i provoni në mënyrë aktive dhe të mendoni se në cilat situata mund t'i zbatoni në lëndën (et) tuaja specifike.
- 4** Një qasje që është më e orientuar drejt studentit nënkupton që rolet e studentëve dhe të mësuesve ndryshojnë njësoj. Ju do të rrisni njohuritë tuaja në lidhje me rolet përkatëse.
- 5** Për ta bërë këtë qasje të qëndrueshme dhe për të siguruar krijimin e rrjeteve të zbatimit të saj. Synimi është shkëmbimi i përvojave tuaja, materialet tuaja dhe bashkëpunimi nëse dëshironi. Në këtë kontekst, feedback-u dhe vetë-reflektimi janë thelbësore. Prandaj, do të njiheni me një numër mjetesh që mund t'i përdorni në shumë raste.

DOKUMENTI 2 PËR TRAJNERËT, METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 1, DITA 1

Prezantimi kryesor –MNQ – Dita

(PPT 2, 29 sllajde)

Për lexueshmëri dhe dinamikë kryesisht duhet përdorur apo menduar vetëm fjalët kyçe

SLLAJDI 1: HAPJA – PREZANTIMI KRYESOR

→ Kërkoni nga pjesëmarrësit që të marrin një letër dhe stilograf dhe të marrin shënime, t'i shkruajnë pyetjet, etj.

SLLAJDI 2: KLASA E VJETËR

- Fillimi i shekullit të 20-të (klasa e vjetër në Gjermani) – vetëm djemtë – rreth 50 nxënës në klasë – ulje si në teatër, - pozita e mësimit: dominuese, -atmosfera: kryesisht shumë e rregulluar, e ngurtë, fjalët kyçe në mësimit: përsëritje, mësimi përmendsh, mësimit frontale

SLLAJDI 3: MËSIMET E SOTME

Klasa moderne: grupet e përziera – ndërmjet 25 - 30 nxënës – tavolinat grupore – mësimit është më pak dominues, nuk duket në sllajd – fjalët kyçe në mësimit: mësimit e vetërregulluar, bërja e gjërave, mësimit bashkëpunuese, të kuptuarit dhe transferit

SLLAJDI 4: CILA ËSHTË BAZA PËR KËTO PUNËTORI

KKK (Korniza e Kurrikulës së Kosovës) 2011

Rezultatet e PISA-së (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve) 2015, 2019

Programi i GIZ-it për përmirësimin e sistemit shkollor

QZhISH (Qasja për Zhvillimin e Integruar të Shkollës) 2018

SLLAJDI 5: KKK

Aspektet qendrore:

Bazohet mbi kompetencat – kërkon t'u mundësojë nxënësve përshtatjen e njohurive dhe rritjen e nivelit të transferit

→ **inkurajimi i mësimit së qëndrueshme!**

Që do të thotë:

Nxënës – ka nevojë - për më shumë bashkëpunim, vetëreflektim, zhvillim më të madh të përgjegjësisë për vetë procesin mësimit

Mësimit – kanë nevojë – të lëvizin nga mësimit e fakteve dhe shifrave (bazuar në përmbajtje) në mësimit të bazuar në probleme/detyra – duke i bërë nxënësit që të mendojnë, të marrin pjesë **në mënyrë aktive** dhe të reflektojnë në procesin mësimit.

SLLAJDI 6: PISA

Rezultatet e dobëta – nxënësit kryesisht riprodhojnë, diagnostikimi në Kosovë:

kreativitetit – strategjitë e zgjidhjes së problemeve – të menduarit kritik =

Aspektet të cilat kryesisht kanë të bëjnë me nivelin 3 (2) = transferi, (komentimi; gjetja e zgjidhjes nga vetë nxënësi)

Përvoja në shtete të tjera: ndryshimi është i mundshëm (p.sh. në Gjermani 2001 = tronditja e PISA-së – shumë rezultate të këqija --> ndryshimi në mentalitetin e mësimit --> 2015 (Vendi i 15-të, qartazi mbi mesataren e OBEZh-it) – megjithatë merr kohë! Të gjithë akterët duhet të kenë durim.

SLLAJDI 7: QZHISH = PROGRAMI NGA GIZ

(Punëtoritë mbi organizimin e shkollës = zhvillimi i strukturave të tjera shkollore dhe rritja e pjesëmarrjes në institucion);

Në punëtori shkollat kanë zhvilluar: **Vizione – objektiva – plane të veprimit në nivel shkolle, kanë rritur pjesëmarrjen (EZSh, KSC, AP (Kryesuesi)**

Metodologjia me nxënësin në qendër (MNQ) është pjesë e atij programi – ajo promovon pjesëmarrjen aktive të nxënësve, promovon qarkullimin e përmbytjes – i bënë nxënësit që të reflektojnë dhe të diskutojnë mbi alternativat

SLLAJDI 8: NË THELB, ÇKA ËSHTË MËSIMDHËNIA E MIRË

(Është kërkuar nga ju që të mendoni në mënyrë aktive lidhur me këtë në grupin e gumëzhimës. Aktivitetet e tilla paraprake shpesh përdoren për të nxitur interesimin dhe për të rritur fokusin e nxënësve për bëhet prezantimi i një teme të re. Kjo ndërton mbi njohuritë e tyre paraprake.

Çka është mësimit e mirë? Tema e katër ditëve – dhe një numër punëtorish që mund të pasojnë.

Sot ne fillojmë me: Një lloj konteksti shkencor

Këto njohuritë teorike do të duhej t'ju mundësonin që t'ua shpjegoni të tjerëve se pse është domethënës ndryshimi në mendësinë e mësimit.

SLLAJDI 9: KOMPETENCAT

Janë katër fushat kryesore ku nxënësit e sotëm duhet t'i zhvillojnë shkathësitë e tyre – ky sllajd ju jep një pasqyre – të cilat do t'i shqyrtojmë në detaje shkurtimisht.

Ekzistojnë kompetencat të cilat nxënësit duhet t'i mësojnë për të qenë të suksesshëm në shkollë, dhe çka është më me rëndësi u nevojiten në jetë për të garantuar pjesëmarrjen e tyre. Këto kompetenca duhet të zhvillohen vazhdimisht në shkollë (mësimit, nxënësi dhe në shtëpi me prindër) por gjithashtu edhe jashtë shkollës. Ato janë pjesë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Shënim: ekzistojnë kompetencat e veçanta – karakteristike të cilat ndërlidhen me lëndën të tilla si:
 në matematikë: për përdorimin e modeleve matematikore/zgjidhjen e problemeve në mënyrë matematikore /
 në histori: kompetencat interpretuese dhe analitike/orientimi dhe gjykimi
 në gjuhët: zhvillimi i kompetencave të leximit, shkrimi i kompetencave apo mësimi i një gjuhe tjetër
 – **ato nuk janë adresuar veçanërisht në këtë punëtori, si për shembull**

Katër kompetencat kryesore në hollësi:

SLLAJDI 10: KOMPETENCA E LËNDËS:

Nxënësit duhet të zhvillojnë **njohuritë thelbësore të ndërlidhura me lëndën**.

Për ta arritur këtë synim, nxënësit duhet shpesh t'u ekspozohen temave në mënyra të ndryshme.

Kjo duhet të bëhet në tri nivele të ndryshme:

riprodhimi (= thjeshtë duke thënë atë që kanë mësuar, se çka nënkuptonte teksti, cilat fakte/shifra janë përmendur)

aplikimi/përdorimi i njohurive (= diçka me të cilën nxënësi duhet të mësohet në situata të ngjashme/ apo: fushat e ndryshme të njohurive duhet të kombinohen)

transferi (= diçka e mësuar duhet të zhvillohet më tej, e cila ndërlidhet me kontekstin e ri, të aplikohet në mënyrë kreative (gjithashtu në procesin mësimor – nxënësi duhet të jetë në gjendje të shpjegojë gabimin dhe të shpjegojë se pse dhe ku ka gabuar.

→ Në këtë fushë, një përparësi e metodës me nxënësin në qendër bëhet e dukshme pasi që **aftësia për të reflektuar/shpjeguar/etj**, trajnohet në mënyrë të përhershme (tema e kësaj punëtorie)

SLLAJDI 11: KOMPETENCA SOCIALE:

Për të mësuar me sukses, **nxënësit mësojnë për të ndërvepruar**. Kompetencat e tilla si shfaqja e ndjeshmërisë, bashkëveprimi apo pranimi i roleve të ndryshme dhe detyrave të ndryshme, apo menaxhimi i frustrimit (e rrisin tolerimin e frustrimit) etj.

Nëse nuk i zhvillojnë këto kompetenca, nxënësit lehtë dalin jashtë loje, bëhen të marginalizuar.

SLLAJDI 12: VETË-KOMPETENCA:

Nxënësit duhet të dinë për **përparësitë dhe dobësitë e tyre personale** por gjithashtu **edhe për strategjitë e të nxënësve** në përgjithësi dhe ato individuale të cilat u mundësojnë atyre që të mësojnë në mënyrë të suksesshme. Dhe ata duhet të **reflektojnë** mbi procesin e tyre mësimor.

SLLAJDI 13: KOMPETENCA E METODËS:

Nxënësit duhet t'i mësojnë **metodat e ndryshme** dhe të dinë si të punojnë ato. (Synimi: për të mësuar në mënyrë graduale se cilën metodë mund ta përdorin në mënyrë individuale apo ta aplikojnë në kuadër të kontekstit).

Në këtë punëtori, ju (si mësimdhënës) do të njiheni me një numër metodash të cilat – pas një trajnimit të caktuar – do t'ju ndihmojnë nxënësve për ta organizuar veten vetëm nëse thjeshtë e përmendni metodën përkatëse. P.sh. metoda e gumëzhimës

→ **Kalimi në hulumtimin shkencor:**

Pa hyrë në shumë detaje në këtë kohë është e rëndësishme të dijmë dhe të jemi në gjendje t'ua **shpjegojmë** të tjerëve se ka **shumë dëshmi** sot të cilat e përkrahin ndryshimin e mendësisë.

Së pari, është John Hattie dhe 6 sllajdet e ardhshme do të jenë mbi të!

SLLAJDI 14: JOHN HATTIE (J.H.) – LIBRI I TIJ “MËSIMNXËNIA E DUKSHME” 2009

→ Është bërë “bestseller” libri më i shitur për njerëz në mësimdhënie në mbarë botën si dhe ka pasur shumë ndikim në ndryshime.

J. H. = nga Zelanda e Re, kanë përdorur studime dhe metastudime (= studime të përgjithshme të cilat përbëhen nga shumë studime të vetme) në shtetet anglofone – Përkundër faktit që sistemi shkollor dallon, shumë rezultate mund të përgjithësohen/transferohen.

SLLAJDI 15: LIBRI “MAKSIMIZIMI I EFEKTIT MBI MËSIMNXËNIEN” 2012

I shtjellon rezultatet e hulumtimit të tij si dhe fokusohet mbi mënyrën e mësimdhënies. .

→ **Këtu përmendni vetëm rezultatet më të rëndësishme.**

SLLAJDI 16: SLLAJDI NË SHIKIM TË SHPEJTË

Për **mësimdhënësit**, është thelbësore që ata të mund t'i **ndërrojnë këndvështrimet**.

Ata duhet të jenë në gjendje të reflektojnë mënyrën e tyre të mësimdhënies nga këndvështrimi i nxënësit. Prandaj, është e rëndësishme që të inkurajohen nxënësit për të dhënë informata kthyesë për vetë mësimnxënien e tyre, që të inkurajohen të reflektojnë mbi atë që u është mësuar. Dhe – **mësimdhënësit janë më të rëndësishmit!**

(Do të mund të ishte e dobishme gjithashtu që të përdoret videografia e njësive mësimore (vetëm në faza të caktuara si për shembull nxënësit në një strukturë bashkëpunuese)

Shënim: mbrojtja e të dhënave është një çështje që duhet marr parasysh këtu --> *ju si trajner duhet t'i dini kushtet e mbrojtjes së të dhënave në Kosovë*

Për **nxënësit** është thelbësore që të dinë rreth objektivit të njësive mësimore, të dinë se çka pritet prej tyre, në mënyrë që të mund ta motivojnë **veten**, dhe të dinë (vetë) lidhur me **strategjitë mësimore**. Për më tepër ata duhet ta shohin vetën si **vetë-efikas**.

(Informatat kthyesë nga bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësi janë të rëndësishme këtu)

SLLAJDI 17: ME RËNDËSI PËR NXËNËSIT DHE MËSIMNXËNIEN E QËNDRUESHME:

- motivimi
- perceptimi individual i njësive mësimore dhe mësimdhënësit
- mësimnxënia aktive
- strategjitë individuale mësimore
- dhënia dhe marrja e informatave kthyesë

Ku këto aspekte do të jenë qendrore në këtë punëtori dy ditore!

SLLAJDI 18 → LEXONI ME ZË TË LARTË

- **menaxhimi i klasës**: qartësia dhe kalimi i mirëfilltë nga njëra fazë në tjetrën (rutinat) janë të rëndësishme – *nuk është ndonjë problem gjatë këtyre 2 ditëve, por ndoshta në punëtorinë e ardhshme*
 - **aktivizimi njohës (kognitiv)** është gjithashtu i rëndësishëm – jo vetëm **riprodhimi**, por edhe nivele të tjera siç janë **zbatimi dhe transferi** - *(do të preken vetëm aspekte të tilla si: diferencimi i brendshëm, gjithëpërfshirja etj = të adresohen ndryshe, disa prej tyre nuk janë të aftë t'i arrijnë dy nivelet e fundit)*
 - **minimizimi psikologjik i madhësisë së grupit** (p.sh. me përdorimin e metodave bashkëpunuese) – apo grupimin e nxënësve
- Mësimdhënësit duhet të përpiqen t'i japin secilit nxënës ndjenjën se ai vlen. Hattie thotë se mësimdhënësit e mirë e bëjnë këtë. (Sidoqoftë, një deklaratë e “vështirë”: Në Gjermani kjo ka shpjer në diskutim se madhësia e klasës nuk është e rëndësishme – nëse je mësimdhënësi i mirë, mund të japësh mësim gjithkund pavarësisht madhësisë së grupit – një aspekt që është jashtëzakonisht i polemizuar pasi që të gjithë ata që janë në mësimdhënie e dinë se kërkohet shumë më shumë energji nëse madhësia e grupit është e madhe).

SLLAJDI 19: FAKTORËT NDIKUES

Kjo skicë tregon cilët faktor kanë shumë ndikim mbi mësimnxënien:

→ **Le t'i shikojnë dhe shkurtimisht t'i komentojnë** →

- **Së pari**: Nëse të gjeturat e t - **Hattiet janë të vërteta, ekzistojnë dëshmi për të përdorur mësimnxënien dhe metodat me nxënësin në qendër.**

- **Së dyti**: **Një profesor dhe hulumtues me rëndësi në Gjermani:**

Hilpert Meyer (Profesor Gjerman i didaktikës dhe pedagogjisë shkollore) ka vëzhguar të gjitha llojet e grupeve mësimore përgjatë dekadave në situata të ndryshme (jo vetëm në shkollë) dhe ka bërë shumë hulumtim për të kuptuar se cilat aspekte qojnë drejtë mësimnxënies së qëndrueshme ...

→ **Kujtoni – para këtij prezantimi ju kërkova të mendoni lidhur me “mësimdhënien e mirë”**

Këtu është çka Hilpert Meyer ka kuptuar – shumë në pajtim me të gjeturat e Hattie

SLLAJDI 20:

1. Struktura e qartë e njësive mësimore (= Hattie) (**menaxhimi i klasës është i rëndësishëm**)

2. Proporcioni i lartë i kohës reale për mësim (= Hattie)

(që do të thotë: **vet-efikasiteti**, por si nxënës gjithashtu duhet të bëni shumë punë vetë: të mendoni, t'i shprehni mendimet tuaja, të llogaritni, apo...)

Me fjalë të tjera – jo kryesisht apo vetëm të kuptoni – t'i ndiqni idetë e njerëzve të tjerë apo të mësoni përmendsh atë çka ka thënë mësimdhënësi, por gjithashtu **që të jeni aktiv vet ju.**

- **Së treti**: **Të gjeturat në neuroshkencë:**

Një fushë tjetër që e përkrah këtë ndryshim të mendësisë është neuroshkenca.

Neuroshkenca jep informata të thukëta mbi fushat e reja, emocionuese. Shpesh qasjet e mësimdhënësve tani konfirmohen në mënyrë shkencore për herë të parë por nganjëherë edhe dëshmohen supozimet si të gabuara.

SLLAJDI 21: NEUROSHKENCA

Neuroshkenca ndër të tjera shqyrton **se si funksionon mësimnxënia**. Duke dhënë informata të thukëta mbi trurin e njeriut. (përmes EEG, MRT)

Për të mësuar diçka, për të deponuar informata, neuronet duhet të krijojnë lidhjet.

SLLAJDI 22: RRJETI(ET) NERVORE

Për të krijuar të ashtuquajturin **rrjetin nervor**, ajo çka mësohet duhet të **aktivizohet shpesh**.

Në kontekstin e mësimdhënies: Subjektet duhet të synohen shpesh në mënyrë që nxënësi të njoftohet me to dhe t'i automatizojë informatat.

Me fjalë të tjera: Thënia e diçkaje njëherë, posaçërisht nëse është e re, thjeshtë dhënia e një të dhëne nuk është e mjaftueshme nëse duam që informata të na qëndrojë në mendje = për mësimnxënien e qëndrueshme.

Megjithatë ekziston një aspekt pozitiv në procesin mësimor.

Shtigjet e shpejta (autostradat) mund të krijohen, por ato gjithashtu mund të zhduken nëse nuk përdoren më. (mendoni mbi vozitjen, gjuhët e huaja të cilat i përdorni shpesh) – (ku shtigjet mësimore duhet të shpjegohen).

Për të shpjeguar një rrejt të tillë nervor, nuk është e mjaftueshme që të synohet në mënyrë njohëse, por në shumë mënyra – e ashtuquajtur **Nxitja** – është një term shkencor për ndikimin dhe ndërlidhjen e stimulimit.

Thënë shkurt: nxitja e njohjes = duhet të përdoren shqisat e ndryshme për të pasur ndikim (për ta njoftuar trurin tuaj me çështjen).

SLLAJDI 23: SYNONI TRURIN TUJ NË NJË MËNYRË TË SHUMËFISHTË:

Përdorni shqisat e ndryshme.

Kjo shpesh bëhet në shkollën fillore, por shpesh zhduket nga mësimdhënia në nivelin e ulët të mesëm.

Balada mund të transferohet në një video,

Një situatë historike mund të transferohet në një lojë rolesh,

apo

Një eksperiment kimik mund të shpjegohet me intervistë, etj.

Në këtë kontekst shumë mund të arrihet përmes **detyrave domethënëse (detyrave të synuara)** --> **tema e punëtorisë numër dy.**

- **Së katërti:** teoria e **konstruktivizmit** e cila e transferon këtë idenë e mësimnxënies dhe mësimdhënies – një emër i rëndësishëm këtu është **Kersten Reich**

SLLAJDI 24: KERSTEN REICH

– Teoria e tij është jashtëzakonisht komplekse për prezantimin e sotëm. Sidoqoftë, disa aspekte relevante që ndërlidhen me temën tonë duhet të preken këtu.

Në këtë kontekst, dallimet midis vendeve dhe zakoneve të tyre mund të shërbejnë si një shembull.

DOKUMENTI 3 PËR TRAJNERËT, METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 1, DITA 1

(Njerëzit rriten ndryshe, por i marrin gjërat si të mirëqena me të cilat përballen çdo ditë. Kontekstet janë të ndryshme; normat/vlerat shoqërore - rrjedhimisht konceptet e realitetit janë të ndryshme, informatat e reja që duhet t'u bashkëngjiten përvojave.

→ **Për të demonstruar se si funksionon kjo – tregojeni këtë në një performancë:** Për instruktorin:

Ju ngriheni në këmbë dhe vizatoni një kuti të paramenduar rreth jush = Kjo simbolizon ndërtimin tuaj të botës, por unë jam gjithashtu ai konstrukt.

Pastaj - lëvizni një hap anash dhe përsëritni vizatimin e një kutie të paramenduar rreth jush, duke thënë: “Sigurisht, personi tjetër ka konstruktin e tij/saj dhe e sheh atë të tijën/sajën logjike dhe timin jo logjike”.

“Por unë e shoh timen si logjike, të tijën apo të sajën si jo logjike sepse unë jam rritur ndryshe, jam shoqëruar ndryshe” etj.)

* (Ndoshta, këtu mund të krijoni vetë një ide dinamike, p.sh. një përvojë ndërkulturore që keni pasur)

Si mësimdhënës/dhe si instruktor gjithashtu duhet të di se kam konstruksione të shumëfishta të ulura para meje, të ashtuquajturit nxënës, të cilët mund të arrij thellësisht vetëm (në mënyrë të qëndrueshme) nëse ndihmoj për ta bërë mësimin një proces individual. Ku nxënësit do të ndryshojnë konstruktin e vetvetes vetëm nëse ka kuptim për ta, nëse mund të integrojnë pjesë të reja të informatave në konstrukt.

→ Si pasojë, nuk ka mënyrë të njëjtë për të gjithë që të mësojnë diçka. Mësimdhënësit duhet të ofrojnë mënyra të ndryshme për të arritur një objektivi të caktuar - mësimdhënësit duhet të ofrojnë një larmi mundësish për të mësuar.

Një shprehje e mirë që mund ta mbajmë në mend lehtë atë që nënkuptohet këtu:

Unë mund ta shpjegojë, por nuk mund ta kuptoj për ju.

apo

Kalin mund ta dërgoni te burimi i ujit por nuk mund ta detyroni që të pinë ujë. (Thënie angleze)

Për të cituar Kersten Reich: ”Secili njeri është një sistem i vetë-përmbajtur dhe prandaj vetë është përgjegjës për mësimin e tij/saj”.

SLLAJDI 25: PASOJAT E KËSAJ TEORIE PËR MËSIMDHËNËSIT:

1. mbështetja e secilit nxënës në procesin e tyre mësimor
2. krijimi i mundësive të ndryshme mësimore

(Përdorni rezultatet e neuroshkencës; përqendrohuni te kompetencat në kontekstin e përmbajtjes kuptimplotë, përdorni njohuritë tuaja në lidhje me strategjitë e të mësuarit në përgjithësi dhe i bëni që t'i riorganizojnë informatat).

3. Ndryshoni rolin e mësimdhënësit tuaj (jepni udhëzime/orientim) në fazat plenare - trajnim gjatë shoqërimit të nxënësve drejtë proceseve mësimore në fazat bashkëpunuese.

Këto janë inteligjenca të shumëfishta (Howard Gardner, Vgotisky) të cilat duhet të arrihen.

SLLAJDI 26: KONSTRUKTIVIZMI NË SHKOLLË NË NJË VËSHTRIM

Bashkëveprimi në çifte dhe në grupe është thelbësor!

→ **Një ndërveprim i shkurtër: Grupet e gumëzhimës - 1 minutë**

SLLAJDI 27: SLLAJDI I CILI TREGON PLOTËSIMIN E MANGËSISË

✓ *“Shikoni dhe tregojini njëri tjetrit se çka keni parë”.*

→ **Kërkoni nga anëtari i grupit që ta shpjegojë atë në mënyrë publike.**

Këtu dallimi bëhet i dukshëm:

Thuaj: “Nëse do ta kisha shpjeguar sllajdin, ju do të kishit kuptuar këndvështrimin tim (ndoshta do të kishit miratuar mendimin tim, konstruktin tim. Megjithatë, ka shumë!!) Dhe duket se ekziston vetëm një zgjidhje (e mësimdhënësve) për të kapërcyer mangësinë.”

SLLAJDI 28: MËSIMNXËNIA BASHKËPUNUESE

Thuaj: “Gjatë këtyre dy ditëve ju do të njiheni/ose do t’i rikujtoni njohuritë tuaja mbi disa parime dhe metoda themelore që mund të zbatohen. Ajo ka për qëllim t’ju ndihmojë juve si mësimdhënës, dhe nxënësit në proceset e tyre të të nxënësve”.

Gjatë aplikimit të disa prej metodave në shkollë, mbani mend:

Filloni me diçka të vogël, por filloni. Keni vetëbesim! “

SLLAJDI 29: JU FALEMINDERIT

- pauzoni një minutë apo dy – ajroseni pak sallën për oksigjen??

→ *Veprimi pasues: aktiviteti i radhës*

✓ *“Merrni disa minuta kohë për të kaluar përmes shënimeve tuaja dhe për të formular 2-3 pyetje për ato pjesë të cilat nuk i keni kuptuar mjaftë mirë dhe për fushat për të cilat do të dëshironit të dinit më shumë”.*

Letër pjesëmarrësve

Si përkujtues dhe për t'u siguruar që ata vërtet kanë provuar metoda të reja, dërgojani këtë letër pjesëmarrësve rreth dy javë para modulit të 2-të.

Kolegë të nderuar,

Punëtorja e radhës tashmë po afrohet. Është koha për të dërguar një përkujtues të vogël.

Ne përgatitëm me zell disa materiale për mësimin e bazuar në detyra, kurse disa ide të reja janë duke u përgatitur.

Ne jemi kurioz të dëgjojmë për përvojat që keni pasur gjatë përdorimit të metodës që kemi prezantuar herën e kaluar.

Në mënyrë që të kemi edhe një herë një shkëmbim të frytshëm, do të dëshironim t'ju kujtonim që të sillni me veti fletën e reflektimit në lidhje me metodën që kemi shpërndarë dhe fletën e aftësive që ju kemi kërkuar ta plotësoni.

Në ditën e dytë të punëtorisë praktike që do të vijë, ju do të jeni në gjendje jo vetëm të bëni planet tuaja javore për _____ (muaji) por edhe të bëni disa planifikime të hollësishme.

Meqenëse ka më shumë kuptim që të sigurohen disa materiale në mënyrë dixhitale, do të dëshironim që të gjithë të sillni një laptop dhe/ose një USB me veti. Ne gjithashtu ju kërkojmë që të sillni librat tuaj shkollore dhe materialet e tjera që përdorni kur i planifikoni mësimet, për ditën e dytë.

Shpresojmë që të gjithë të jeni me shëndet të mirë dhe mirëpresim që të shihemi përsëri.

Të gjitha të mirat nga ... (Qyteti)

_____ (emri i trajnerit)

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 1, DITA 1 – FLETË PUNE 1

Cili raport ndërmjet mësimit frontal dhe punës individuale të nxënësve është i arsyeshëm?

Të përfundojmë përfundimisht një mosmarrëveshje

Mësimi frontal është ende fjalë që nxitë. Mirëpo do të ishte mirë, nëse mund ta përfundonim më në fund debatin për përparësitë dhe dobësitë e kësaj. Mësimi frontal është pjesë e secilit koncept të mirë mësimit. Mësimdhënësit duhet të zotërojnë edhe këtë formë të mësimdhënies, sikurse aftësinë për të organizuar punë bashkëvepruese në grupe. Për nxënësit është fat, nëse kane përkujdesje nga një person i cili mund të rrëfej, sqaroj, paraqes, udhëzoj, korrigjoj, ndihmoj dhe që është aty për ata nëse ata kanë vështirësi, dhe nëse kanë vështirësi, ata i bën të mahnitën, të qeshin dhe të mendojnë. Ekziston konsensus edhe në literaturën e re profesionale, që debati për mësimin frontal është e paarsyeshme. Ndërsa Heimke sqaron: „ndonjëherë lëvizë gjatë krahasimit të „instruksioneve“ dhe „konstruktivizmit“ bëhet edhe një vlerësim, sipas motos: të shmangim sa më shumë instruksionet, dhe ta rrisim sa më shumë konstruktivizëm. Një këndvështrim i tillë, e cila i nxit instruksionet dhe konstruktivizmin ndaj njëra tjetres është naive, sepse të nxënit në shkollë kërkon gati çdoherë të dyja: nxitje, udhëheqje, parashtrimin e detyrave nga mësimdhënësi dhe procese individuale mësimore në anën e nxënësit“. Drejtimi i të mësuarit dhe të nxënit me vet-përgjegjësi janë dy polaret e çdo procesi të mirë mësimit. Mirëpo për të përfunduar grindjen e pashprehur duhet të ballafaqohemi me problemin e vërtetë, që krejt kjo qëndron në masën e dozës.

Nuk duhet që mësimdhënësit të mbajnë mësim vetëm frontal, dhe nuk duhet që çdo ligjëratë e mësimdhënësit të kritikohet, sepse është shumë e gjatë. Mësimi frontal dhe puna e pavarur e nxënësve: Kur të ofrohet çka? Si duket një përzierje e mirë?

Procesi mësimit i orientuar kah veprimet

Procesi mësimit i orientuar kah veprimet nisët nga një koncept fleksibël mësimit, i cili lëviz ndërmjet dy polareve të procesit mësimit të drejtuar nga mësimdhënësi dhe procesit mësimit me nxënësin në qendër. Fokusi qëndron në përshtatjen e nxënësit duke vepruar. Fazat e mësimit frontal e kanë funksionin që veprimet e nxënësve të përgatiten më mirë. Pasi që nxënësit të pajisen me mjetet dhe informacionet e nevojshme ata kalojnë në punën e tyre të pavarur, ndërsa mësimdhënësit në fund iu ndihmojnë që të përpunojnë dhe shkëmbejnë përvojat e tyre. Mësimi frontal është një metodë e përshtatshme për të filluar secilën temë të re mësimore.

“Paramendoni, ju jeni mbretër të fuqishëm të mesjetës! A do të udhëtonit nëpër tërë mbretërinë me kali, për të zgjidhur vet problemet apo do të angazhoni ndihmës, të cilët do ta kryenin punën për juve? Mendojeni këtë!” Ose: “Shtatë njerëz më kanë ndihmuar. Për fat të keq i pata vetëm tri çokollata për t’i falënderuar! Çfarë të bëj?”

Mësimi frontal në fillim të një cikli duhet t’i bëjë nxënësit kureshtar për risitë, sepse kureshtja është një nxitës i fuqishëm i motivimit. Nëse përpos kësaj edhe sqarohet se cila është tema që do të mësohet, cili është qëllimi i trajtimit të temës dhe cila është mënyra e planifikuar e punës, atëherë e ka kryer funksionin e tij. Mësimi frontal mbështet proceset e përshtatjes së nxënësve dhe u mundëson pavarësi. Për strukturën “mendo-çiftëzo-ndajë” mund të kombinohet mësimi frontal në fazën e hyrjes me mësim të shkurt individual dhe pastaj shkëmbim në çifte. Kjo madje rekomandohet urgjentisht, sepse mësimdhënësi që nga fillimi i orës mësimore i përfshin të gjithë nxënësit. Nëse aplikohet mësimi frontal nuk do të thotë që nxënësit nuk janë aktiv. Kalimi në fazën më të gjatë të punës së pavarur bëhet, pasi që të jenë sqaruar parakushtet. Tani nxënësit janë duke përvetësuar kompetencat e kjo gjë mundësohet vetëm gjatë “learn-

ing by doing” (të nxënit duke bërë). Pjesë kulminante janë prezantimet e nxënësve. Këtu aplikohet të nxëniti dhe mund të vëzhgohet zhvillimi i kompetencave. Prapë mund të vazhdoj një fazë e mësimi frontal, sepse tani mësimdhënësit duhet të ndihmojnë nxënësit që të sigurojnë rezultatet mësimore, të korrigjojnë gabimet dhe të përgatiten për risi në të nxënë.

Shumë mësimdhënësit të rinj kanë menduar që në orën e tyre shembullore mësimore duhet të kalojnë nëpër të gjitha këto faza me rezultat, që ata kanë kaluar tepër shpejt dhe pa kërkesat të mjaftueshme për nxënësit nëpër orë mësimore. Disa mësimdhënësit të rinj ende nuk mund të paramendojnë përdorimin e teksteve me më shumë se një faqe, sepse ata konsiderojnë që nuk mund të trajtohet brenda një orë mësimore. Nevojitet kohë për të nxënë, sepse duhet të jete sfiduese dhe e qëndrueshme. Nëse e bëjmë vetëm prezantimin e thyesave dhe i bëjmë disa ushtrime plotësohet një orë 45 minutëshe. Procesi mësimor mund të jetë edhe më intensiv për nxënësit, nëse gjatë një ore të tërë mësimore zhvillohet vetëm mësim frontal. Gjatë prezantimit të metodave për zhvillimin e kompetencës së leximit nuk mund të bëhet ndryshe


Gjithçka nuk mund të bëhet për 45 minuta

Shkatërrimtar është të mendojmë, që gjithçka mund të kryhet brenda 45 minutave – duke filluar nga motivimi, përpunimi e deri te prezantimi i detyrave të përfunduara si dhe diskutimi i tyre, duke siguruar kështu rezultate të rëndësishme. Kjo është hipoteza më e keqe e mundshme, të cilën na e ka imponuar mënyra tradicionale e mësimdhënies

Kjo arsyetohet, nëse në orën e radhës mësimore zhvillohet punë e pavarur dhe bëhet prezantimi i rezultateve dhe jepet informacion kthyes. Nuk duhet të marrim një orë të vetme si njësi matëse krahasuese për përzjerjen e metodave mësimore ndërmjet mësimi frontal dhe punës së pavarur të nxënësve. Cikli i planifikuar duhet të jetë baza.

Si rregulla kryesore vlejnë:

- Assesi mos të shpenzohet më shumë se gjysma e kohës me çështje organizimi të mësimi frontal.
- Më mirë një e treta e kohës për mësim frontal, një e treta e kohës për punë të pavarur të nxënësve dhe një e treta e kohës për diskutim dhe informacion kthyes.



METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 1, DITA 1 - FLETË PUNE 2

METODA E 5 GISHTAVE

<https://www.lmz-bw.de/medien-und-bildung/medienbildung/methoden/feedback-hand/>



METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 1, DITA 1 – FLETË PUNE 3

Tabela e kompetencave me nivele të ndryshme

Kompetenca	++	+	√ +	√	-

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 1, DITA 1 – FLETË PUNE 3B

Tabela e kompetencave (klasa 5/6) _____

Data			
-------------	--	--	--

Kompetenca	Këtë mund ta bëj tani			Këtë mund ta bëj më mirë			Këtë dua ta mësoj		

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 1, DITA 1 – FLETË PUNE 4

Tabela e kompetencave histori me fotografi

Data									
Kompetencat	Këtë mund ta bëj tani			Këtë mund ta bëj më mirë			Këtë dua ta mësoj		
Unë e kam gjetur një titull të përshtatshëm .									
Unë iu kam vënë emra personave dhe kafshëve.									
Unë kam shkruar, se çka ka ndodhur para fotografisë së parë .									
Unë e kam paraqitur përmbajtjen në tërësi .									
Unë kam përshkruar, se çka ka ndodhur ndërmjet fotografive .									
Unë kam rrëfyer në mënyrë emocionuese dhe qesharake .									
Unë e kam gjetur një përfundim logjik .									
Unë kam shkruar fillime të ndryshme të fjalive.									
Unë kam shkruar shumë folje dhe ndajfolje .									
Unë kam përdorur gjuhën letrare .									
Unë kam vënë shenjat e sakta të pikësisimit .									
Unë kam shkruar në një kohë (p.sh. koha e tashme)									
Unë e kam gjetur një titull të përshtatshëm .									
Unë iu kam vënë emra personave dhe kafshëve.									
Unë i kam shkruar dy gjëra për secilën fotografi.									
Unë e kam gjetur një përfundim logjik .									
Unë kam rrëfyer në mënyrë emocionuese dhe qesharake .									
Unë kam shkruar çfarë kanë thënë dhe mendojnë personat .									

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 1, DITA 1 – FLETË PUNE 4A

Emri: _____

Tabela e kompetencave basketboll

Rregullat		Unë i di 3 rregulla të basketbollit.	Unë i di 3 rregulla të basketbollit dhe ju përmbahem atyre.	Unë i di 5 rregulla Të rëndësishme të Basketbollit.	Unë i di 5 rregulla të rëndësishme të basketbollit dhe mund të ju përmbahem atyre.	Unë i di të gjitha rregullat E rëndësishme të basketbollit dhe i udhëzoj Bashkë-lojtarët të ju përmbahen atyre.	Unë i di të gjitha rregullat e rëndësishme të basketbollit dhe e udhëheq lojën si gjyqtar.	Unë i di të gjitha Rregullat e basketbollit dhe e Udhëheq pa problem lojën si Gjyqtar.
Teknika	Driblimi	Unë mund ta gjuaj topin në tokë me 10 dorën më të fortë 10 herë pa ndërprerë.	Unë mund ta dribloj topin me një dorë gjatë vrapimit. (Dribbling).	Unë mund të dribloj me të dy duart.	Unë mund të dribloj gjatë vrapimit të shpejt.	Unë mund të bëj mashtrime të ndryshme trupore, gjegjësisht trike gjatë driblimit.		
	Gjuajtja	Unë e qëlloj koshin/dërrasën me cilëndo teknikë të gjuajtjes nga vija e gjuajtjes së lirë.	Unë qëlloj nga cilido pozicion 2 nga 10 herë në kosh.	Unë e di tekniken e përgatitjes së koshit (driblimi i saktë)	Unë i qëlloj 4 nga 10 Koshat e përgatitur ose 3 nga 10 gjuajtje të lira.	Unë mund ta përfundoj një sulm të shpejt me sukses dhe qëlloj pastaj 3 nga 10 "treshe".		
	Kalimi	Unë mund ta kaloj topin me bashkë-lojtarët së paku 10 x, ashtu që ai ta kap topin. (distanca rreth 5 m)	Unë mund të demonstroj saktë tri lloje të ndryshme të kalimit të topit. (distanca rreth 5 m)	Unë mund të demonstroj nga driblimi disa kalime të dyfishta të topit.	Unë mund të ec gjatë lojës dhe që të jem me qëllim i lirë dhe të kaloj topin në mënyrë të sigurt		Unë mund të aplikoj aftësitë e mia në mënyrë të sigurt gjatë sulmit/ mbrojtjes/ kalimit të topit.	
Ekipi	Unë trajtoj bashkë-lojtarët, kundërshtarët dhe gjyqtarin në mënyrë të drejt dhe me kujdes.	Unë angazhohem për bashkë-lojtarët në lojë dhe jashtë lojës.	Unë jam i motivuar dhe tregoj gatishmëri në lojë.	Unë tregoj ambicie dhe e bind edhe ekipin tim.	Unë mund ta sakrifikoj vetën për ekipin, barazoj gabime dhe e motivoj ekipin.			
Organizimi	Unë ndihmoj nganjëherë në përgatitje të lojës.	Unë ndihmoj rregullisht dhe në mënyrë të pavarur në përgatitjen e lojës.	Unë ndihmoj në përgatitjen e lojës dhe largimin e të gjitha pajisjeve, deri sa të vendosen në vendin e tyre.	Unë marr përgjegjësi gjatë përgatitjes dhe largimit të gjërave.	Unë mund ta udhëheq vet përgatitjen e lojës dhe largimin e gjërave.	Unë mund të organizoj përgatitjen e lojës dhe largimin e gjërave dhe ti përmbahem planit të përcaktuar kohor.		
Nxënësia	Unë ushtroj kur më thotë mësimdhënësi.	Unë ushtroj dhe bëj shpesh pushime.	Unë ushtroj vazhdimisht, Nëse motivohem nga nxënësit e tjerë dhe mësimdhënësi.	Unë ushtroj vazhdimisht dhe në mënyrë të pavarur.	Unë ushtroj vazhdimisht dhe në mënyrë të pavarur dhe motivoj bashkëmoshatarët e mi.			

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 1, DITA 1 – FLETË PUNE 4B

Tabela e kompetencave - punë grupore

	++	+	✓ +	✓	-
Bashkëpunimi në grup	Unë marr përsipër përgjegjësi dhe balafaqohem i orientuar kah qëllimi, duke ndihmuar dhe në mënyrë konstruktive në çështjet personale dhe grupore.	Unë marr pjesë i orientuar kah qëllimi dhe në mënyrë konstruktive në punën grupore dhe i respekton nevojat e të tjerëve.	Unë marr pjesë në punën grupore dhe i respektoj nevojat e të tjerëve.	Pasi më kërkohet marr pjesë nganjëherë në punën grupore.	Unë shpesh e pengoj punën grupore.
Kompetenca për detyrat	Unë i kuptoj dhe i zgjidhi detyrat në mënyrë të pavarur dhe i orientuar në qëllim dhe und të shikoj, përzgjedh dhe interpretoj pa ndihmë tekste dhe burime të përshtatshme.	Unë i kuptoj dhe i zgjidhi detyrat gati çdo herë në mënyrë të pavarur dhe i orientuar kah qëllimi dhe mund të shikoj dhe përzgjedh pa ndihmë tekste dhe burime të përshtatshme.	Unë i kuptoj dhe i zgjidh detyrat kryesisht në mënyrë të pavarur dhe i orientuar kah qëllimi.	Për zgjidhjen e detyrave dhe gjetjen e materialeve kam nevojë për mbështetje.	Unë rrallë i kuptoj detyrat e parashtruara dhe nuk mund të punoj pothuajse fare në mënyrë të pavarur. Unë nuk kërkoj ndihmë.
Qëndrimi i jashtëm i punës	Unë punoj çdo herë pa zhurmë, me përpikëri dhe me materiale dhe mjete të plota. Unë e plotësoj orën mësimore me mjete dhe informacione të sjellura nga unë.	Unë punoj çdo herë pa zhurmë, me përpikëri dhe me materiale dhe mjete të plota.	Unë punoj çdo herë pa zhurmë ose me përpikëri dhe me materiale dhe mjete të plota.	Unë punoj rrallë herë pa zhurmë ose me përpikëri dhe me materiale dhe mjete të plota.	Unë punoj rrallë herë pa zhurmë dhe rrallë herë me përpikëri dhe me materiale dhe mjete të plota.
Prezantimi i rezultateve	Prezantimin tim të posterit në mur mund ta prezantoj në formë të lirë dhe ta shoqëroj me mimikë dhe gjepte përkatëse dhe mund të iu përgjigjem pyetjeve në mënyrë përkatëse.	Prezantimin tim të posterit në mur mund ta prezantoj në formë të lirë dhe mund të iu përgjigjem pyetjeve në mënyrë përkatëse.	Prezantimin tim të posterit në mur mund ta prezantoj me ndihmën e fjalive udhëzuese në formë të lirë dhe mund të iu përgjigjem pjesërisht pyetjeve.	Unë mund ta mbaj prezantimin me tekst dhe me kontakt më të rrallë me sy me dëgjuesit.	Unë vetëm i lexoj.
Posteri në mur	Tekstet, fotografitë dhe grafikët janë shumë të pastra, me pamje të mirë dhe të shumëllojshme dhe ndërlidhen me përmbajtjen. Informacionet janë paraqitur në mënyrë gjithëpërfshirëse.	Tekstet, fotografitë dhe grafikët janë shumë të pastra dhe ndërlidhen me përmbajtjen. Informacionet janë paraqitur në mënyrë pak gjithëpërfshirëse.	Tekstet, fotografitë dhe grafikët janë të pastra dhe ndërlidhen pjesërisht me përmbajtjen. Informacionet janë të mangëta.	Tekstet, fotografitë dhe grafikët janë të papastra dhe nuk ndërlidhen me përmbajtjen. Informacionet janë shumë të mangëta.	Tekstet, fotografitë dhe grafikët janë jo të plota, të papastra dhe nuk ndërlidhen me përmbajtjen.

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 1, DITA 1 – FLETË PUNE 5A

Emri:

nga

deri

Emri:

nga

deri

Plani javor

Lënda	Detyrat	Si?	✓	Kon-trolli	Shënim
Shkrim					
Lexim					
Llogaritje					

Plani javor

Lënda	Detyrat	Si?	✓	Kon-trolli	Shënim
Shkrim					
Lexim					
Llogaritje					

Detyra zgjedhore	Si?	✓	Kon-trolli	Shënim
Shkrim				

Detyra zgjedhore	Si?	✓	Kon-trolli	Shënim
Shkrim				

E hënë	E marte	E mërkure	E enjte	E premte
😊 😐 😞	😊 😐 😞	😊 😐 😞	😊 😐 😞	😊 😐 😞


E hënë	E marte	E mërkure	E enjte	E premte
😊 😐 😞	😊 😐 😞	😊 😐 😞	😊 😐 😞	😊 😐 😞

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 1, DITA 1 – FLETË PUNE 5B

Plani javor gjuhë shqipe 3b

Nr. _____

Emri: _____

			përfun- duar	kontr.
				
				
				
				
				

E kam punuar gjithashtu edhe këtë:

				
---	--	--	--	--

Informacion kthyes:

☺ Kjo gjë më ka pëlqyer posaçërisht në planin javor: _____

☹ Kjo gjë nuk më ka pëlqyer: _____

☹ Dëshira dhe propozime për planin e ri javor: _____

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 1, DITA 1 – FLETË PUNE 6

Fletë reflektimi - pas aplikimit të një metode (metodave)

Emri: _____ Shkolla _____ Klasa _____ Lënda _____

Këndvështrimi i mësimitdhënësit

Cilat ndryshime i kam vëzhguar gjatë mënyrës së mësimitdhënies?	
A ka ndryshuar marrëdhënia me nxënësit?	
A ka ndryshuar marrëdhënia ndërmjet nxënësve?	
A ka ndryshuar mënyra e punës së nxënësve?	
A e kanë ngritur nxënës të ndryshëm dorën gjatë seancave plenare?	
Vëzhgime të mëtejshme/ ose këtë çështje dua ta diskutoj në punëtorinë e radhës?	

Këndvështrimi i nxënësit - bazë: një diskutim me nxënësit për metodën e aplikuar


Çka ka ndryshuar për ju si nxënës?	
Si ju pëlqeu metoda? (Vlerësim me metoden e ngritjes së gishtit) dhe pastaj deklarata	
Aspekte të tjera që përmendën nxënësit	

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 1, DITA 1 – FLETË PUNE 7

Objektivi – Rrethi

Komentet tuaja janë me rëndësi për ne – kështu që mendoni për punëtorinë dy ditore dhe shkruani reagimet tuaja

- Jam **mësimdhënës 1-5** **mësimdhënës 6-9** - ju lutemi ta shënoni kryqin qartë
- Ju lutemi t'i vlerësoni pjesët e dhëna dhe bëjeni një kryq në segmentin e duhur.
- Sa më afër rrethit të synuar të jetë kryqi juaj, aq më pozitiv do të jetë vlerësimi juaj.






Ja çka do të marrë me vete në shtëpi si diçka të re dhe të çmuar

1.
2.
3.

Dua po ashtu të them – nëse dëshironi, mund ta shfrytëzoni edhe pjesën e pasme të kësaj flete.

--


Material shtesë





Menaxher i detyrave

Është detyrë e jote të kujdesesh që grupi yt të punoj në detyrën e saktë. Ke kujdes, që askush të mos pengohet.



Lajmëtar

Nëse grupi yt ka pyetje për mësimdhënësin, atëherë është detyrë e jotja që t'ia parashtrësh pyetjet mësimdhënësit dhe t'i kthesh përgjigjet te grupi.




Shkruesi

Detyrë e jotja është që të dokumentosh mendimet dhe rezultatet e punës së grupit tënd.



Menaxher i kohës

Është detyrë e jote të kujdesesh që grupi yt të menaxhoj kohën mirë. Tregoju rregullisht anëtarëve të grupit edhe sa kohë ju ka mbetur.




Menaxher i materialit

Është detyrë e jote të kujdesesh që grupi yt të përdor materialin në mënyrë të arsyeshme. Në fund të punës në grup e kthen krejt materialin në vendin e vet. Nëse gjatë punës keni nevojë për më shumë material, atëherë ti shkon e merr atë.



Kujdestari i lartësisë së zërit

Është detyrë e jote të kujdesesh që grupi yt të mos pengoj grupet e tjera.



Folësi

Është detyrë e jote që ti prezantosh rezultatet e grupit.
Udhëzim: mbaj shënime edhe gjatë fazës së punës për prezantimin.



Parashtruesi i pyetjes



Shefi i grupit



Kujdestari i zhurmës



Përgjegjësi për materialin

Stacioni i autobusëve





Moduli 2

Moduli 2 - Agjenda për trajnerët

Dita 1 - Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Koha	Dita 1
09:00 – 09:15	Përshëndetja e pjesëmarrësve
09:15 – 10:00	Shkëmbim dhe reflektim i metodave të aplikuara në shkollë
10:00 – 11:00	Shkëmbimi i këshillave me kolegët
11:00 – 11:20	Pauza e kafes
11:20 – 11:50	Fjalimi kryesor për të nxënësit bazuar në detyrë
11:50 – 12:30	Reflektimi i strukturuar lidhur me prezantimin
12:30 – 13:30	Dreka
13:30 – 14:30	Aktivitetet lidhur me përditshmërinë – dhe gjuha akademike (teknike)
14:30 – 15:30	Skela
15:30 – 15:50	Informatat kthyesë – telegrami
15:50 – 16:00	Parashikimi i ditës 2, moduli 2

● Me trajnerin në qendër ● Pauzat ○ Me nxënësin në qendër në bashkëpunim me trajnerin

KUSHTET DHE MATERIALET E NEVOJSHME PËR TRAJNIM

- **Salla** - madhësia
Pjesëmarrësve do t'u duhen tavolina për grupe dhe hapësirë e mjaftueshme për të lëvizur përreth. Padyshim, madhësia e sallës varet kryesisht nga numri i pjesëmarrësve, por duhet të zgjidhet me kujdes. Salla duhet të jetë e rehatshme. Gjithashtu, një sallë e dytë do të mund të merrej parasysh nëse e ndani grupin.
- **Pajisjet:** projektori (me internet pa tela (wifi)), laptop, tabela të meta planeve, tabela me fleta të mëdha, altoparlanta
- **Materiale:** (mundësisht në kutia)– fleta pune, fleta të metodës, prezantime në power point
 - Kartat e meta planeve në ngjyra të ndryshme në një sasi më të madhe (të kaltër dhe të kuqe për aktivitetin e 2-të)
 - Gjilpëra të mjaftueshme
 - Fllomastera të zi (nëse është e mundshme nga një për secilin) dhe disa me ngjyra të ndryshme
 - Shirit ngjitës
 - Ngjitës letre
 - Letra e formatit A4 në 5 ngjyra: e kaltër, e verdhë, e kuqe, e gjelbër, e bardhë (për aktivitetin numër 3)
- **Sinjali akustik**

Moduli 2 - Agjenda për trajnerët

Dita 2 - Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Koha	Dita 2
09:00 – 09:20	Hapja e ditës së dytë/ orientim
09:20 – 10:10	Të menduarit divergjent dhe konvergjent
10:10 – 10:50	Lidhur me aspektet relevante të planifikimit të mësimit, fleta e kriterëve, shabllonët e tjerë
10:50 – 11:10	Pauza e kafes
11:10 – 12:45	Lidhur me lëndën: përgatitja e njësisë së plotë në një strukturë tjetër + planet javore
12:45 – 13:45	Dreka
13:45 – 14:30	Lidhur me lëndën: përgatitja e njësisë / shkëmbimi / informatat kthyesë / korrigjimi i mundshëm
14:30 – 14:50	Ekipet shkollore – çështje lidhur me MNQ
14:50 – 15:30	Grupi 1: Diagrami Venn; grupi 2: koordinatorët për sigurimin e cilësisë – shkëmbimi lidhur me procesin e ndryshimit
15:30 – 16:00	Informatat kthyesë dhe perspektiva

● Me trajnerin në qendër ● Pazuat ○ Me nxënësin në qendër në bashkëpunim me trajnerin

KUSHTET DHE MATERIALET E NEVOJSHME PËR TRAJNIM

- **Salla** - madhësia
Pjesëmarrësve do t'u duhen tavolina për grupe dhe hapësirë e mjaftueshme për të lëvizur përreth. Padyshim, madhësia e sallës varet kryesisht nga numri i pjesëmarrësve, por duhet të zgjidhet me kujdes. Salla duhet të jetë e rehatshme. Gjithashtu, një sallë e dytë do të mund të merrej parasysht nëse e ndani grupin.
- **Pajisjet:** projektori (me internet pa tela (wifi)), laptop, tabela të meta planeve, tabela me fleta të mëdha, altoparlanta
- **Materiale:** (mundësisht në kutia)– fleta pune, fleta të metodës, prezantime në power point
 - Kartat e meta planeve në ngjyra të ndryshme në një sasi më të madhe (të kaltër dhe të kuqe për aktivitetin e 2-të)
 - Gjilpëra të mjaftueshme
 - Fllomastera të zi (nëse është e mundshme nga një për secilin) dhe disa me ngjyra të ndryshme
 - Shirit ngjitës
 - Ngjitës letre
 - Letra e formatit A4 në 5 ngjyra: e kaltër, e verdhë, e kuqe, e gjelbër, e bardhë (për aktivitetin numër 3)
- Sinjali akustik

Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Moduli 2

DITA 1

AKTIVITETI NR. 1

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Mirëseardhje pjesëmarrësve/objektivat	Dhënia e orientimit	1 Sesion plenar	Sinjali për fillim, shirit ngjitës, fllomastera, projektor, tabela me letra të mëdha të përgatitura (objektivat)	Prezantimi 1: Sllajdet 1, 2	15'

Faktorët e përgjithshëm për t'u marr parasysh para aktivitetit të parë:

Shkruani objektivat në tabelë, në mënyrë që të jenë të dukshme gjatë gjithë kohës (si alternativë: prezantimi në Power Point). Sot organizimi i ak-

tiviteteve gjatë ditës është shumë kompleks, dhe ju si trajner do të keni shumë materiale për të siguruar. Pra, qëndroni të qetë dhe sigurohuni që gjithçka të

jetë gati kur të filloni. Nëse nuk jeni të njoftuar me konceptin e mësimnxënies të bazuar në detyra, shikoni dokumentin nr. 1 për trajnerin, modu-

li 2, dita 1 – lidhur me mësimnxënien e bazuar në detyra. Do të t'ju duhet kjo informatë lidhur me kontekstin kur flisni për objektivat.

→ Pjesëmarrësit ulen në grupet sipas shkollave deri në pauzën e drekës.

Aktiviteti 1

Analiza e objektivave (Sllajdi 2)

Jepni një prezantim të shkurtër të programit dy-ditor. Ditën e parë, fokusi është mbi informatat e kontekstit të MBD-së (mësimnxënien e bazuar në detyra) dhe kohës për punë praktike. Ditën e dytë, do të ketë më shumë kohë për punë praktike dhe rrjetëzim.

Objektivi kryesor: rritja e nivelit të aktiviteteve të nxënësve/kohës së të nxënësve aktiv

- Reflektimi i metodave të aplikuara në shkolla
- Zhvillimi i një kuptimi më të thellë të metodave të zbatuara në shkolla
- Kuptimi dhe zbatimi i parimeve të detyrave komplekse të mësimnxënies
- Njohja dhe përdorimi i metodave më bashkëpunuese
- Përmirësimi i rrjeteve dhe shkëmbimi



Sigurohuni që t'i shprehni mirëseardhje të gjithëve. Flisni për kohën ndërmjet punëtorive dhe tregojni se jeni kureshtar të mësoni në lidhje me përvojat që kanë fituar në shkollë kur i kanë zbatuar metodat e prezantuara në modulin e fundit.

Edhe një herë: krijoni një atmosferë të këndshme dhe kërkoni nga pjesëmarrësit të mbajnë një etiketë të dukshme me emrin e tyre. Nëse kanë harruar ta sjellin, vendosni disa ngjitës dhe fllomastera në dispozicion në një tavolinë afër hyrjes.

Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Moduli 2

DITA 1

AKTIVITETI NR. 2

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Shkëmbimi i përvojave Metoda: Fanari	Reflektimi i përvojave gjatë (4) javëve të fundit	2a PG (4) 25' 2b Sesion plenar 10' 2c PI 10'	Sinjali akustik, Tabela me fleta të mëdha, Për secilin grup: 1 karton i kuq dhe 3 kartonë të kaltër moderimi, fleta metodës 11 – fanari	Sllajdi 3 – 8	45'



Metoda e 'Fanarit' është një metodë shkëmbimi për grupe më të mëdha. Pjesëmarrësit formojnë grupe me tre ose katër persona me rolet e mëposhtme: 1 fanari (kartoni i kuq), 2 - 3 anije (kartoni i kaltër). Trajneri shpërndan në mënyrë të rastësishme kartonët e moderimit gjatë prezantimit të metodës.

Sigurohuni që të ketë nga një fanar në çdo grup.

→ Për informata më të hollësishme shikoni në pletën 11 të metodës.

Pjesëmarrësit përdorin fletët e tyre të reflektimit (të shpërndara në punëtorinë e fundit) në të cilat kanë plotësuar përvojat e tyre me metodat e përdorura.

Dhe ndoshta ata gjithashtu sjellin dokumentacionin e tyre të metodave të përdorura në shkollë.

Aktiviteti 2a: (sllajdi 3 – 7) Shkëmbimi lidhur me javët e fundit

Tregojuni se kanë 4 minuta në çdo fanar dhe një 1 minutë për të shkuar te një tjetër.

Udhëzime:

Hapi 1: Tregojini njëri-tjetrit për metodën që keni aplikuar në shkollën tuaj dhe në cilën klasë e keni përdorur atë.

Shkëmbeni përshtypjen tuaj të përgjithshme: Si ka funksionuar? → ndërroni fanarët

Hapi 2: Cilat ndryshime kam vëzhguar në mënyrën time të mësimdhënies? A ndryshoi roli im si mësimdhënës? → ndërroni fanarët

Hapi 3: A ka ndryshuar raporti im me nxënësit? → ndërroni fanarët

Hapi 4: A kishte ndonjë ndryshim në qëndrimin e nxënësve ndaj punës? (motivimi dhe përfshirja) → ndërroni fanarët

Hapi 5: Cila ishte përmbajtja e informatave kthyesë që kanë dhënë nxënësit tuaj rreth metodave të reja? → kthehuni tek karriget tuaja

Aktiviteti 2b: Përmbyllja

Udhëzime:

A ka ndonjë gjë që dëshironi të ndani në lidhje me përvojat tuaja në sesionin plenar?

Nëse po, trajneri mbledh aspekte në tabelë dhe nëse ka kohë të mjaftueshme, diskutojini ato hap pas hapi. Përndryshe ndoshta në një kohë tjetër. Por këtu duhet të ketë një shkëmbim të gjerë.

Aktiviteti 2c: Shpjegime të mëtejshme për metodën + plotësimi i fletës së metodës: (Sllajdi 8)

→ Ndërsa shpërndani fletën e metodës 11, u thoni pjesëmarrësve që mësimdhënësi është duke i caktuar rolet e "fanarëve" në heshtje ndërsa po i shpërndan kartonët: fanari (roje) janë të mira për nxënësit "më të dobët" ose nxënës të turpshëm, të cilëve nuk u pëlqen të ecin përreth. Ata mund të qëndrojnë në vendin e tyre kur grupet e reja vijnë tek fanari. Kjo metodë është një alternativë ndaj rrethit të dyfishtë dhe mund të përdoret gjithashtu në fazat e ofrimit të informatave kthyesë.



Në punëtorinë tona, pjesëmarrësit sollën dokumente të mrekullueshme në lidhje me njësitë mësimore në të cilat kishin aplikuar metodat e reja. Dhe, të gjithë ata ishin shumë krenarë dhe dëshironin t'i tregojnin ato për ne dhe pjesëmarrësit e tjerë. Për të vlerësuar përpjekjet e tyre, aktiviteti 2b zgjati shumë më shumë. Ne e hoqëm aktivitetin 2c dhe përdorëm një pjesë të kohës së aktivitetit 3 dhe pushimin e kafesë. Sigurohuni që të reagoni me fleksibilitet këtu.

Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Moduli 2

DITA 1

AKTIVITETI NR. 3

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Zhvillimi i ideve për kolegët të cilët nuk janë të njohur me MNQ-në, MKN	Reflektimi i përvojave, mbështetja e rrjeteve shkollore	3a PI/PG 25' 3b Sesion plenar 35'	Sinjali akustik, 2 – 3 tabela të meta-planeve Për secilin grup: 2 flomastera, letër (formati A4/5) në 5 ngjyra, 2 prej secilës: e kuqe, e gjelbër, e kaltër, e verdhë, e bardhë	Sllajdi 9 – 11	60'

Në këtë fazë, trajneri duhet të marrë përsipër shumë punë organizative. Pra, sigurohuni që gjithçka të jetë përgatitur më parë. Pjesëmarrësit vazhdojnë të punojnë në grupet e tyre të lidhura me shkollën. Për **aktivitetin 3b** ju duhet një hapësirë e madhe në dysheme, ku i gjithë grupi mund të ecë përreth dhe të shikojë rrethin e dyfishtë të letrave.

Aktiviteti 3a: Zhvillimi i ideve



Të gjithë mësuesit zhvillojnë ide për sfidat e ndryshme me të cilat përballen kur punojnë me metoda komplekse të orientuara drejtë nxënësve. Ata kanë nevojë për letra me ngjyra të ndryshme për aspekte të ndryshme.

- Para mësimit:** përqendrohet në procesin e planifikimit dhe sfidat e prezantimit të një metode të re në klasë
- Gjatë mësimit:** merret me ndryshimin e rolit si mësues, reflektojnë vetë rolin e tyre
- Gjatë mësimit:** merret me ndryshimet në sjelljen e mësuesve ndaj nxënësve dhe ndryshimin në marrëdhëniet e tyre.
- Pas mësimit:** merret me vështirësitë në ruajtjen e rezultateve dhe në sigurimin e korrektesisë.

Meqenëse 2 + 3 kanë të bëjnë me sjelljen individuale të mësuesve gjatë procesit të të nxënës dhe janë më emocionale, atyre u duhet më shumë kohë për të diskutuar këto çështje.

Në **aktivitetin 3b**, do të gjeni se si të merreni me këtë aspekt.

Udhëzime:

"Ju keni fituar një përvojë me MNQ gjatë javëve të fundit në shkollë në nivele të ndryshme. Në këtë fazë fokusi është në zhvillimin e ideve për kolegët të cilët gjithashtu dëshirojnë të përshtatin mënyrën e tyre të mësimit."

Hapi 1 (PI): (Sllajdi 9) *Mendoni për veten tuaj së pari dhe shkruani disa këshilla për kolegët tuaj bazuar në përvojën tuaj (gjithashtu reflektoni atë që do të bënit ndryshe herën tjetër dhe pse. Përdorni një copë letre të zakonshme).*

Hapi 2 (PG): *Shkëmbeni idetë tuaja dhe pajtohuni lidhur me **dy ide (këshilla) për ngjyrë! Vetëm një ide në një letër!***

Hapi 3: (Sllajdi 10)

1. E kuqe: *Idetë: Fazat para-bashkëpunuese të mësimit:*

Kjo duhet të respektohet veçanërisht kur prezantoni një metodë.

2. E kaltër: *Idetë: Gjatë fazave të bashkëpunuese të mësimit:*

Këto ide kam për mësuesit. (p.sh. mos u përfshini me një nxënës shumë intensivisht, përveç nëse vërtet dëshironi ta mbështesni atë sot).

3. E verdhë: *Idetë: Gjatë fazave të bashkëpunuese të mësimit:*

Këto ide kam për mësuesit gjatë punës me nxënësit e tyre. (p.sh. kërkoni nga nxënësit të shpjegojnë detyrën/çka do të bënin ata. (Kur t'i keni dhënë udhëzimet më parë!))


4. E gjelbër: *Idetë: Fazat pas-bashkëpunuese të mësimit:*

Kjo është mënyrë e mirë për të kontrolluar nëse rezultatet janë të sakta/dhe t'i ruani për të gjithë.

5. E bardhë: *Vetëm nëse ka më shumë kohë:*

Nëse keni ide tjera praktike, i shkruani në një letër të bardhë, sepse nuk dëshirojmë që t'i humbim ato).

1. Më pas, kartonët e **kuq** dhe të **gjelbër** grupohen nga pjesëmarrësit në muret e meta planit, të cilat mund të shihen nga të gjithë. Pjesëmarrësit i shpjegojnë idetë e tyre dhe i kuptojnë idetë e të tjerëve. (Kjo është “pjesa e ndarjes me të tjerët” nga mendo – krijo çift – ndaj me të tjerët, të cilën ata gjithashtu mund ta përdorin me nxënësit në shkollë.)
2. Ato të **verdha** dhe të **kaltra** vendosen në dysheme në një rreth të dyfishtë – e verdhë brenda, e kaltër jashtë. I gjithë grupi ecën përreth rrethit dhe i lexon idetë. Nëse ka pyetje, “autori i kartonit” përgjigjet drejtpërdrejt. Padyshim, pjesëmarrësit mund të bëjnë fotografimin e ideve.



rrethi i brendshëm: këndvështrimi i mësimeve
rrethi i jashtëm: këndvështrimi i nxënësve



A ka ndonjë pyetje të hapur në lidhje me përvojat që keni bërë me këto metoda?

Nëse është kështu, vendosi ato në tabelën e metaplanit. Përdorni pushimin e kafesë për t'i lexuar dhe komentuar më pas.

(Kurdo që është e përshtatshme, trajnerët i ruajnë rezultatet dhe bëjnë fotografi për t'i dokumentuar ato. Për këtë arsye, trajnerët mund të dëshirojnë t'i grupojnë idetë në tabelat shtesë të metaplaneve).

Shënim:

Ta keni parasysh që pas pauzës së kafesë do t'ju duhet prezantimi në Power Point 2: prezantimi kryesor



Gjithashtu mund të jetë një opsion për t'i ruajtur rezultatet në cloud.

PAUZA E KAFES

tregojuni kur duhet të kthehen.

Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Moduli 2

DITA 1

AKTIVITETI NR. 4

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Prezantimi kryesor Metoda e këndit të djathtë	Ofrimi i kontekstit teorik	4a Sesion plenar 5' 4b Sesion plenar 25'	Projektori, Fleta e punës 1: këndi i djathtë	Prezantimi 2: prezantimi kryesor	30'

Dokumenti për trajnerin 1, : moduli 2, dita 1, – Mbi detyrat komplekse të mësimnxënies

Aktiviteti 4a Udhëzime për fletën e punës: këndi i djathtë



Udhëzime para prezantimit kryesor: (Sllajdi 1, 2)

→ Shpërndani dhe shpjegoni fletën e punës “këndi i djathtë” para se të filloni me prezantimin.

→ Për informata të hollësishme shikoni fletën e metodës 12

Sigurohuni që gjatë prezantimit, pjesëmarrësit të plotësojnë vetëm kutinë e parë “aspektet e temës”.

(Pjesa e parë e prezantimit kryesor siguron disa informata të kontekstit të prezantimit kryesor në modulin 1, dita 1. Më pas, jepen informatat mbi detyrat komplekse të mësimnxënies dhe kontekstin e tij shkencor.)

Aktiviteti 4b Prezantimi kryesor (Sllajdi 3 – 21)

Përdorni dokumentin për trajnerin 1 – moduli 2, dita 1.

Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Moduli 2

DITA 1

AKTIVITETI NR. 5

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Metoda e këndit të djathtë	Procesimi i informatave të kontekstit teorik	4a PI/PG 20' 4b Sesion plenar 10' 4b PI 10'	Projektor, Fleta pune 1, këndi i djathtë, Fleta e metodës 12	Prezantimi 2: prezantimi kryesor, Sllajdi 22	40'

Dokument për trajnerin 1: moduli 2, dita 1, – mbi detyrat komplekse të mësimnxënies

Aktiviteti 5a Fleta e këndit të djathtë



Pas prezantimit kryesor, të gjithë pjesëmarrësit punojnë me fletën e punës 1, kënd i djathtë.

Udhëzime:

✓ Plotësoni pjesët e tjera të fletës së punës në mënyrë individuale. 10 minuta

(Sllajdi 22):

✓ Merrni fletët e punës dhe diskutoni çështjet e përmendura në prezantimin kryesor së bashku në tavolinën e grupit tuaj.

✓ Shtoni aspekte në letër, nëse ju ka ikur ndonjë.

✓ Më pas shkruani aspektet që dëshironi të diskutoni në sesionin plenar. 10 minuta

Aktiviteti 5b Diskutimi i aspekteve të prezantimit kryesor

Përgjigjuni pyetjeve që pjesëmarrësit kanë për aspektet e përmendura në prezantimin kryesor dhe diskutoni aspektet me të cilat kanë punuar pjesëmarrësit në fletët e tyre me këndin e djathtë.

Aktiviteti 5c Fleta e metodës 12

→ Shpërndani fletën e metodës 12. Pjesëmarrësit e plotësojnë individualisht.

Shënim:

Metoda “këndi i djathtë” është kryesisht për nxënësit më të rritur nga klasa 6/7 e tutje, sepse nxënësit duhet të jenë në gjendje të mendojnë në një mënyrë abstrakte. Si një hap për t'i njoftuar ata me atë metodë është e mundur të filloni me çështjet më pak komplekse: p.sh. “Shpjegoni një aspekt në një mënyrë më të detajuar”.



Informojini që pas drekës do të punojnë në grupet e ndërlidhura sipas lëndëve për pjesën tjetër të ditës!

PAUZA E DREKËS

(sigurohuni që t'u tregoni se kur duhet të kthehen.)

Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Moduli 2

DITA 1

AKTIVITETI NR. 6

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Rritja e nivelit të gjuhës në vetëdijesim, (MKN)	Rritja e ndjeshmërisë ndaj vështirësive të nxënësve për gjuhën akademike	6a PI 10' 6b PI/PG (MKN) 10' 6c Sesion plenar 10' 6d PG (MKN) 10' 6e Sesion plenar 10'	Sinjali akustik, projektori	Prezantimi 1: Sllajdi 12 – 17	60'

- Të gjithë pjesëmarrësit ulen në **grupet e ndërlidhura sipas lëndëve tani**.
(Si trajner, duhet t'i ndihmoni të organizohen. Përdorni listën e regjistrimit për emrat, shkollat, lëndët dhe klasat).

Aktiviteti 6a Eksperimenti me gjuhën (Sllajdi 12):



Filloni me eksperimentin e marrë nga revista gjermane "Pädagogik".
Kërkoni që së pari të shikojnë sllajdin 12. Këmbëngulni që të punojnë individualisht. Duhet të jeni të rreptë këtu!
Zgjidhja e detyrës është jo vetëm e vështirë por pothuajse e pamundur. Prandaj, duhet të jeni të përgatitur që disa prej tyre mund të ankohen!
Pastaj tregoni sllajdin 13 me udhëzimet dhe kthehuni tek sllajdi 12 më pas.

Udhëzime: (Sllajdi 13):

- ✓ *Ju lutemi përshkruani strukturën eksperimentale në gjuhën e huaj që e dini më së miri!
(Vetëm nëse nuk flisni një gjuhë tjetër: përpiquni ta përshkruani në shqip!)*
- ✓ *Keni 10 minuta për ta përshkruar.*
- ✓ *Askush të mos flas këtu!*

Aktiviteti 6b Reflektimi mbi eksperimentin (Sllajdi 14)

*Detyra ishte: Ju lutemi përshkruani strukturën eksperimentale në gjuhën e huaj që e dini më së miri. (Metoda: Mendo/Krijo
çift/Ndaj me të tjerët)*

- PI:** Reflektoni mbi përvojat që sapo keni fituar.
- Çka ka shkuar mirë, cilat vështirësi keni?
 - Së pari shkruani disa vëzhgime individualisht. 5 minuta

Pastaj, pas sinjalit

PG: Shkëmbeni vëzhgimet dhe komentet tuaja në tavolinën tuaj. 5 minuta

Aktiviteti 6c Informatat e kontekstit për eksperimentin (Sllajdi 15, 16)



Informatat që duhet të mbuloohen

Mësimdhënësit kanë kaluar përmes vështirësive që (disa) nxënës kanë në lidhje me gjuhën e përdorur dhe gjuhën e kërkuar gjatë njësisë mësimore në shkollë. Nxënësit zakonisht flasin gjuhën e përditshme → në shkollë ata duhet të flasin (dhe shpesh mësojnë): gjuhën akademike → dhe mbi të gjitha: terminologji të specializuar, teknike në shumicën e lëndëve.
Mësimdhënësit duhet të jenë të vetëdijshëm për prejardhjet e ndryshme të nxënësve të tyre në klasë, në aspektin kulturor dhe arsimor, por edhe sa i përket pjekurisë, gjinisë, gjuhës amtare (gjuhës).

Sllajdi 15: jep një shembull të fjalorit që nevojitet për eksperimentin. Mësimdhënësit shpesh e marrin si të gatshme fjalorin që përdoret ose atë që ata vetë e përdorin se po kuptohet nga ana e nxënësve, sepse janë mësuar aq shumë me të.

Sllajdi 16: tregon sfidat e gjuhës gjithnjë e më abstrakte në një shembull.

Aktiviteti 6d Aplikimi i ndërlidhur me lëndën



Pjesëmarrësit punojnë në grupe të ndërlidhura me lëndët nëse është e mundur, madje ndani një grup të së njëjtës lëndë në klasa ose forma shkollore.

Pas udhëzimeve, jepni një apo dy shembuj (p.sh.: për të modifikuar = për të bërë ndryshime të vogla për të përmirësuar diçka = për të bërë diçka në një mënyrë tjetër, riaranzhuar/dogma: një sërë besimesh të fuqishme/flakëdhënësi i Bunsenit: pajisje që prodhon flakë të nxehtë gazi / terminologji e veçantë në lëndë të ndryshme: sporte: driblimi, biologjia: hoja e bletëve, dylli i bletëve...).

Shënim:

Nëse ka kohë, referojuni kuptimit të kurrikulës spirale për të prezantuar gjuhën teknike të lidhur me lëndën..

Udhëzime: (Sllajdi 17):

- ✓ *Pl:* Mendoni për terminologjinë teknike në lëndën tuaj. 10 minuta
- ✓ *PÇ:* Diskutoni rezultatet tuaja me fqinjin tuaj. 5 minuta
- ✓ *PÇ:* Pajtohuni për 2 terma sfidues dhe përpiquni t'i "përktheni" ato në gjuhën e përditshme. 5 minuta

Aktiviteti 6e Përmbyllje



Grupe të ndryshme ndajnë shkurtimisht rezultatet e tyre në sesionin plenar.

Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Moduli 2

DITA 1

AKTIVITETI NR. 7

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Aplikimi i Skelave	Të kuptuarit më të thellë të konceptit për lëndë të ndryshme	7a Sesion plenar 7b PI/PÇ/PG	10' Projektori 10' Për person: Fletat e punës për skela 2 + 3	Sllajdi 18 - 21	60'

Aktiviteti 7a Kontribute të mëtejme për skelat (Sllajdi 18):



Referojuni prezantimit kryesor. Me kontributin tuaj, ju intensivikoni të kuptuarit e skelave. Më pas pjesëmarrësit kanë mundësinë të punojnë me informatat e dhëna.

Koncepti i skelave nënkupton nivele të ndryshme: mësimdhënësi duhet të ndërtojë skela:

- Ndërlidhur me përmbajtjen (ndërlidhur me lëndën): reduktime didaktike mund të kërkohen në fillim të një njësie. Ndoshta edhe qasje të ndryshme për disa nxënës në mësimnxënie gjithëpërfshirëse.
- Ndërlidhur me gjuhën: Ndihmoni nxënësin(it) që të njoftohen me gjuhën akademike.

Skelat ndërtohen dhe sigurohen, por gjithashtu hiqen, nëse nuk nevojiten më.

Në grupe heterogjene, mësimdhënësi mund të ketë nevojë/të sigurojë skela të ndryshme për nxënës të ndryshëm.

(Sllajdi 19):

Kur mësimdhënësit përdorin skelat gjatë planifikimit të tyre, ata duhet të mendojnë së pari për klasën e tyre specifike:

- "Ekzaminoni se çfarë u duhet nxënësve për të kuptuar me sukses / për të bërë një detyrë të synuar / ose për të kuptuar dhe për të përdorur plotësisht njohuritë e tyre. Çfarë dinë ata tashmë? Cilat kompetenca i kanë tashmë? Në cilën fazë kanë nevojë për skela?"

Mbani në mend se ekziston dallimi midis:

- Kontributi i skelave: lexim, dëgjim, mënyra të ndryshme për njohjen e tekstit semantik (gjithashtu si mjet i diferencimit të brendshëm)
 - Rezultati i skelave: Shkrimi, të folurit (zbatimi i strategjive të ndryshme për të shkruar), siguroni pjesë të caktuara (gjithashtu për prezantime)
 - Hulumtimet tregojnë se nxënësit shikojnë së pari paraqitjet pamore, ndërsa mësimdhënësit shikojnë tekstin! Dhe shpesh nxënësit nuk i kuptojnë paraqitjet pamore si duhet dhe paraqitjet pamore mund të jenë edhe mashtruese.
- Shpërndani fletën e punës: Skela 1. Tregon një larmi aspektesh të cilat mësimdhënësit mund të kontrollojnë për skelat e mundshme. Për informata të hollësishme shikoni atë fletë pune. Ajo çon në aktivitetin e radhës.

Aktiviteti 7b

Puna praktike me tekstet shkollore



Pjesëmarrësit punojnë me librat shkollorë që i përdorin në shkollë. Pra, mund të ndodhë që disa prej tyre duhet të punojnë vetëm dhe jo si çift ose në një grup të vogël.

Lërimi të vendosin se çfarë u përshtatet më së miri.

- Shpërndani fletën e punës: Skela 2, e cila i ndihmon mësime dhënëse kur planifikojnë skela kuptimplota në shtëpi, por edhe në aktivitetin pasues. (Për informata të detajuara shikoni në fletën e punës.)

Udhëzime: (Sllajdi 20)

- ✓ Merrni një faqe të dyfishtë nga një libër shkollor që planifikoni ta përdorni në të ardhmen e afërt.
- ✓ Identifikoni pengesat (formulimi pozitiv: sfidat në tekst)
 - a) në nivelin semantik (terma teknik, fjalë akademike, ...)
 - b) në nivelin sintaksor (fjalë të gjata, komplekse, struktura pasive, ...)
 - c) në nivelin e tekstit (dendësia e lartë e informatave, jashtëzakonisht të rëndësishme sipas fakteve, ...)
- ✓ Zhvilloni një draft sa i përket vështirësive që parashikoni në nivelin semantik, sintaksor dhe të tekstit.
- ✓ Kontrolloni nëse mbështetja e dhënë në libër është e mjaftueshme dhe shtoni material mbështetës, nëse është e nevojshme.

(Sllajdi 21)

Sa i përket paraqitjeve pamore në faqen e tekstit shkollor:

- ✓ A e mbështesin paraqitjet e dhëna pamore kuptimin e tekstit apo ndoshta e shpërqendrojnë? A janë nxënësit tuaj në gjendje të kuptojnë paraqitjet pamore?
- ✓ Përcaktoni nëse nxënësi(it) kanë aftësitë e nevojshme gjuhësore për të shkruar ose për të folur për paraqitjen pamore.
- ✓ Mendoni për një material shtesë që i ndihmon nxënësit të përballen me detyrën, nëse është kuptimplote. Merrni parasysh nivele të ndryshme të mbështetjes.

Nëse grupi përfundon herët, këtu është një detyrë shtesë:

Nga përvoja e juaj personale:

- ✓ Jepni këshilla për të nxitur të mësuarit gjithëpërfshirës (p.sh.: një nivel shtesë i skelave, shkoni te nxënësi i caktuar dhe shpjegoni mësimin me fjalë të thjeshta...)
- ✓ Shkruajini ato në kartonët e metaplanit dhe vendosini në një tabelë të metaplanit.

- Le të ecin pjesëmarrësit përreth sallës dhe le t'i shikojnë rezultatet/idetë.



Në punëtoritë tona kemi hasur në faktin që mësime dhënësit kanë gjetur shumë paraqitje pamore të cilat nuk e mbështesnin kuptimin e tekstit apo ishin edhe të gabuara. Ishte hera e parë që ata i zbuluan këto gabime sepse para këtij ushtrimi, ata vetëm e shikonin tekstin.

Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Moduli 2

DITA 1

AKTIVITETI NR. 8

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Informatat kthyesë Telegrami	Njohja me perceptimet e pjesëmarrësve	8a PI 8b Sesion plenar 8c PI	10' Projektori Prezantimi: 1 kartolinë 5' moderimi 5' Fleta e metodës 13, Telegrami	Sllajdi 22	20'

Aktiviteti 8a Dhënia e informatave kthyesë



Pjesëmarrësit njihen me një mjet të ri të informatave kthyesë: informatat kthyesë të telegramit.

Dorëzoni të gjithëve vetëm një karton të moderimit. Secili pjesëmarrës jep informata kthyesë me saktësisht 10 fjalë të cilat i shkruajnë në atë karton.

Për informata të hollësishme shikoni [fletën e metodës 13](#).



Ne kemi parë që mësime-dhënësit gjithmonë duan të shkruajnë më shumë fjalë dhe të fillojnë një diskutim. Bëhuni të rreptë për numrin, këtu! U thoni se nuk kanë nevojë të shkruajnë fjali (të plota).

Udhëzime (Sllajdi 22):

- ✓ Merrni një copë letër dhe jepni informata kthyesë për punëtorinë e sotme me saktësisht 10 fjalë!
Informatat tuaja kthyesë mund të jenë lidhur me përmbajtjen, moderatorin, objektivat, atmosferën ose – thjesht për ndonjë gjë që doni të jepni informata kthyesë.
- ✓ Nuk keni nevojë të shkruani me fjali të tëra!!
- ✓ Kur të jeni gati, shkruani versionin tuaj përfundimtar në kartonin e metaplanit.



Si trajner, ju mblidhni kartonët, i përzieni dhe i shpërndani përsëri: një për secilin pjesëmarrës. Nëse e marrin kartonin e tyre, ata mund të marrin një tjetër.

(Por sigurisht, nëse nuk i tregojnë askujt, ata mund ta mbajnë kartonin sepse askush nuk do ta dijë)

Aktiviteti 8b Leximi me zë të lartë

Pjesëmarrësit lexojnë kartonët e tyre me zë të lartë në sesionin plenar – njëri pas tjetrit.

Ju thjesht dëgjoni për informatat e tyre kthyesë. Mos komentoni për asgjë! Mblidhni kartonët më pas. Më vonë mund t'i lexoni në qetësi pas punëtorisë dhe ndoshta të ngritni nesër ndonjë çështje.

Aktiviteti 8c Fleta e metodës 13

- Shpërndani [fletën e metodës](#). Nëse ka kohë të mjaftueshme, kërkoni nga pjesëmarrësit që ta lexojnë dhe plotësojnë.

Metodologjia me Nxënësin në Qendër (MNQ)

Moduli 2

DITA 1

AKTIVITETI NR. 9

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Përmblyllja dhe vështrimi në të ardhmen	Dhënia e informatave	9 Sesion plenar	Letra e përgatitur e tabelës me fleta të mëdha	-----	10'

Aktiviteti 9 Përmblyllja dhe vështrimi në të ardhmen



Tani keni mundësi të jepni perceptimin tuaj rreth ditës. Bëhuni pozitiv por autentik! Shprehni një dëshirë për nesër dhe falënderojini për pjesëmarrjen e tyre aktive dhe informatat e tyre kthyesë.



Jepni një vështrim për nesër.

Ende objektivi kryesor është: **rritja e kohës së të mësuarit për nxënësit dhe zhvillimi i njësive mësimore të bazuar në një synim (problem).**

- ✓ Më shumë kontribut për mësimnxënien e bazuar në detyra
- ✓ Diferencimi i brendshëm; puna me grupe heterogjene
- ✓ Aktiviteti i drejtuar për të krijuar detyrat e synuara dhe planet mësimore
- ✓ Rrjetëzimi i mësimdhënësve/KSC-të
- ✓ Puna përsëri në grupe të lidhura me shkollën dhe lëndët

Gjërat për t'i sjellë me veti nesër:

Udhëzime:

- ✓ Nesër është rasti për të planifikuar një njësi mësimore për muajin tjetër, kështu që mund të bëni (disa nga) përgatitjet tuaja gjatë punëtorisë.
- Prandaj, është absolutisht e nevojshme: **të sillni të gjithë materialin e nevojshëm si librat, materiale të tjera që përdorni, madje edhe laptop, USB ...**

-> Në fund, u thoni se mezi po prisni t'i takoni nesër në ora 9:00.

FUNDI I MNQ, MODULI 2, DITA 1

Metodat me nxënësin në qendër (MNQ)

moduli 2

DITA 2

AKTIVITETI NR. 1

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Hapja e ditës	Duke iu përgjigjur pyetjeve të mbetura dhënia e një studimi në lidhje me strukturën dhe objektivat e ditës	Plenare	Tabelë për qëllimet kryesore	PPT 3: Udhëzime të ndryshme: Slide 1 - 3	20'



→ Përshëndetni pjesëmarrësit dhe kërkonini që të ulen në grupet e tyre që kanë të bëjnë me shkollën. (Ky rregullim ulësesh do të ndryshojë pas pauzës së kafesë dhe përsëri më vonë pasdite).

Aktiviteti 1

Mirëseardhje/ orientimi (Slljadi 1, 2):

Udhëzimet:

✓ A ka mbetur ndonjë gjë nga dje?

Ju mund t'i referoheni disa deklaratave në telegramet e tyre që keni mbledhur në fund të informatave kthyesë dje ose të ndani ndonjë ide tjetër me ta.

Prezantimi i shkurtër i programit të sotëm (Slljadi 1, 2):

Objektivi kryesor është ende: Rritja e kohës së të mësuarit për nxenesit dhe zhvillimi i detyrave komplekse së të mësuarit (detyrat e synuara).

Ato duhet të jenë të orientuara në problem dhe të bazohen në një njësi të librit shkollor ose në një temë.

✓ Më shumë kontribut për të mësuarit e bazuar në detyra

✓ Diferencimi i brendshëm; duke punuar me grupe heterogjene

✓ Aktivitet i drejtuar për të krijuar detyra komplekse së të nxënësve (detyrat e synuara) dhe planet e mësimit

✓ Komunikimi me anë të internetit me mësuesin / KSC-të



Rrjetet e kompetencës (Slljadi 3)

Ka edhe një letër që ju kam kërkuar të sillni me vete dje - atë për rrjetet e kompetencës:

✓ Ata që duan të marrin një informate kthyesë mund të më tregojnë rrjetin e tyre më vonë pasdite kur punoni për planet e mësimit.

Metodat me nxënësin në qendër (MNQ)

moduli 2


DITA 2

AKTIVITETI NR. 2

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Detyra komplekse së të mësuarit, të menduarit konvergjent/divergjent	Kuptimi i dallimit midis të menduarit konvergjent dhe divergjent	2a Sesion plenar	Fleta e punës 4: divergjente/ konvergjente që pritët horizontalisht para- praktikisht	Sllajdi 4, 5	50'
		2b PI	20'		
		2c PI	10'		
		2e Sesion plenar	10'		
		2c PI	5'		



Para fillimit të këtij aktiviteti, duhet të keni prerë fletët e punës horizontalisht në dy gjysma. Gjithashtu, përgatitni 3 ose 4 letra ne tabelle me vetëm një kuti, ngjitni ato në tabela dhe ktheni tabelat. Alternativë, nëse nuk ka tabela të mjaftueshme: vendosni letrat e përgatitura si tabelë në cepa të ndryshëm të dhomës, ku ato nuk mund të shihen nga pjesëmarrësit.



Aktiviteti 2a

Për detyrat komplekse së të nxënit (Sllajdi 4):



Një kontribut shumë i shkurtër mbi rëndësinë e detyrave kuptimplota duke iu referuar ditës së djeshme dhe PISAs në drejtim të krijimtarisë, zgjidhjes së problemeve dhe të menduarit kritik. Fleta e mëposhtme e punës do t'i ndihmojë mesimdhënësi ta përjetojnë atë.

Aktiviteti 2b

Plotësimi i pjesës së sipërme të fletës së punës (sllajdi 4):



→ Kur ta shpërndani, jini shumë strikt dhe sigurohuni që pjesëmarrësit të shikojnë vetëm letrën e tyre në lidhje me të menduarit divergjent. Përndryshe, ata nuk janë vërtet të lirë në krijimtarinë e tyre! Tregojuni atyre, nuk ka mënyrë të drejtë apo të gabuar. Ata duhet të vizatojnë pa parë fletët e punës të fqinjëve të tyre.

Dhe, shumë e rëndësishme: Nëse shikoni një vizatim ose ju pyesin, a lejohet kjo apo ajo mënyrë: Mos komentoni, por thjesht buzëqeshni!

Si përgatitje për **aktivitetin 2d**, vëzhgo ose shikoni fshehurazi, kush ka përdorur zyrtarisht kutitë dhe kush ka përfshirë vijat për të vizatuar në mënyrë krijuese fotografi. Kërkojuni atyre të skicojnë idenë e tyre në një letër të përgatitur. Sigurohuni që të tjerët nuk mund ta shohin atë gjatë kohës kur personi po vizaton.

Udhëzimet:

✓ Përdorni fletën e punës dhe plotësoni pjesën e sipërme.

Nëse disa janë më të shpejtë se të tjerët, kërkoni që të vizatojnë në heshtje vizatimin e tyre të preferuar në njërin nga tabelat e përgatitura.

Pasi të kenë mbaruar vizatimet e tyre: Leni ti tregojnë zgjidhjet e ndryshme duke i mbajtur lartë – flisni për ndryshimet

E rëndësishme: çdo zgjidhje është ne rregull → krijimtaria është e pakufizuar.



Tregoni fotografitë në tabela dhe lëri pjesëmarrësit të shohin zgjidhjet në tabelat e tyre. Ndonjëherë ata kanë bere këtë në procesin e punës, kur shikonin idetë e njëri-tjetrit. Si trajner, do ta kuptoni, sepse ka shumë zgjidhje të ngjashme në një tabelë. Diskutoni me ta dhe tregoni se qasja e tyre ka kufizuar krijimtarinë e tyre.

Aktiviteti 2c Plotësimi i pjesës së poshtme (sllajdi 5):**Udhëzim:**

✓ Tani plotësoni pjesën e poshtme.

Aktiviteti 2d Të dhënat për të menduarit konvergjent

Informacioni që duhet të mbulohet

Në shkollë shpesh kërkohet vetëm mendim konvergjent, me fjalë të tjera mendimi analitik. Ekziston vetëm një zgjidhje e saktë, e vërtetuar mirë për një problem. Kjo mënyrë e të menduarit kryesisht kërkohet, kur kemi të bëjmë me detyra në shkollë; megjithatë, të menduarit divergjent është po aq i rëndësishëm. Nëse njerëzit i përmbahen vetëm të menduarit konvergjent, idetë dhe zgjidhjet e reja të problemeve, të cilat kërkohen gjithmonë, nuk do të gjenden. (Referojuni përsëri PISAs. Dhe përmendni përsëri se duhet të ofrohen qasje të ndryshme për të mësuar. Gjithashtu theksoni kuptimin e rrjeteve nervore. Përmendni një fakt tjetër: Mësimdhënësi shpesh e perceptojnë qasjen e tyre si më të mirën – ata duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë!)

Aktiviteti 2e Vetë reflektimi**Grupi gumezhites (1'):**

Dy njerëz flasin me njëri-tjetrin dhe pasqyrojnë pyetjen vijuese:

✓ Cila mënyrë është më e lehtë për mua – mendimi divergjent apo konvergjent?

Metodat me nxënësin në qendër (MNQ)

moduli 2

DITA 2

AKTIVITETI NR. 3

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Detyrat komplekse së të nxënit	tregoni se si të përmirësoni detyrat në një libër shkollor	3a Sesion plenar 25' 3b PG 15'	Fleta e punës 5: "Detyrat komplekse së të nxënit"	Slljadi 6 - 14	40'

Dokument për trajnerin 2- moduli 2, dita 2, - Në lidhje me detyrat komplekse së të nxënit

Aktiviteti 3a

1. Në lidhje me përmirësimin e teksteve të librave shkollorë (Sllajdi 6 – 14, në lidhje Leisen):



Të dhënat do të jepen sllajd për sllajdi. Tema e këtij informacioni është se si të punojmë praktikisht me tekstet e ofruara në librat shkollorë ose burime të tjera.

Për informacion të detajuar shikoni në **dokumentin për trajner 2.**

2. Për detyrat komplekse të prirjes, p.sh. Leisen (Sllajdi 15 – 22):



Të dhënat do të jepen gjithashtu sllajd për sllajdi. Tema e kësaj të dhëne është se si të krijoni një detyrë komplekse së të mësuarit.

Për informacion të detajuar shikoni në **dokumentin për trajner 2.**

→ Para se të filloni këtë pjesë së të dhënave, shpërndani modelin mbi "Detyrat komplekse së të nxënit". U thoni atyre se çdo hap do të shpjgohet në minutat e ardhshme.

Aktiviteti 3b

Shkëmbimi tek tabela (15')

Udhëzimet:

✓ Shkëmbeni shpejt disa ide, nëse librat shkollorë ose planifikimi juaj i orëve normale tashmë përfshijnë aspektet e dhëna.

PAUZA E KAFESË

Tregojuni atyre që pas pauzës së kafesë, ata do të ulen në **grupe sipas lëndëve.**

Metodat me nxënësin në qendër (MNQ)

moduli 2

DITA 2

AKTIVITETI NR. 4

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Detyra kom-plekse së të nxënit	Planifikimi i një njësie ose një teme – Shkëmbimi + informata kthyesë	4a Plenare 4b Plenare 4c PI/PG 4d PG 4e Plenare	20' – FP Nr. 6: Plani për këtë temë, e bardhë 10' – FP Nr. 7: Plani për lëndë, p.sh. gjuha angleze 30' – F Nr. 8, "Shoku kritik" 10' – Stilolapsi për tabelë, stilolapsa për tekst	Sllajdi 23 - 26	140'

Dokumenti për trajner 3 - moduli 2, dita 2, : Të nxënit në bazë të detyrave hap pas hapi (slide 23)

→ Pjesëmarrësit tani janë ulur në **grupe që kane te bëjnë** me temat.

Aktiviteti 4a Edhe një dokument model për planifikimin e mësimeve (Sllajdi 23):

→ Dorëzoni fletën e punës nr. 6 "Plani për temën", të bardhë - punimi është identik me PPT.
(Keni disa fletë të tjera të bardha te planit në dispozicion për planifikimin e tyre më vonë, dy fletë letre për të gjithë janë të këshillueshme)



Ju duhet të integroni
pauzën e drekës (60')



Të dhënat për sllajdin 23 do të jepen hap pas hapi. Çështja është që të zbatohet koncepti i të mësuarit të bazuar në detyra (KMD) dhe aspektet që mësuesit duhet të marrin në konsideratë gjatë planifikimit.

Për informacion të detajuar shikoni **në dokumentin për trajner 3.**



Nëse dëshironi, mund të skiconi një shembull në një letër të madhe në një tabelë meta plani.
Nëse nuk e bëni: Përdorni sllajdin 23 dhe fletët e bardha. Pjesëmarrësit mund të dëshirojnë të mbajnë shënime ndërsa ju i udhëhiqni ata përmes letrës.

Aktiviteti 4b Letra nga lënda e gjuhës angleze shërben si model (Sllajdi 24):



→ Dorëzoni një shembull në anglisht (fleta e punës 7)

Në shikim të parë kjo fletë pune duket e mbingarkuar. Por kur e kaloni hap pas hapi dhe me fletën e bardhë pranë tij, pjesëmarrësit do ta kuptojnë konceptin.

Aktiviteti 4c Planifikimi praktik i një njësie / teme



Në grupet e tyre të lidhura me lëndën, pjesëmarrësit vendosin, nëse punojnë vetëm ose si çift. Lejoni vetëm grupe të vogla, nëse nuk ka zgjidhje tjetër! Çiftet varen nga lënda që do të japin në të ardhmen e afërt.

Udhëzimet: (Sllajdi 25)

PI/ PG

✓ Diskutoni për një temë, për të cilën do të punoni. Nëse nuk ka ndonjë temë të përbashkët, ndahuni dhe punoni individualisht. Është e rëndësishme që të planifikoni diçka që do ta përdorni vërtet në shkollë më vonë dhe që mund ta vlerësoni vetë ose me të tjerët.

✓ Më vonë, ju do të mbështesni njëri-tjetrin si miq kritikë, prandaj nuk është e nevojshme të punoni së bashku në këtë fazë.



Sigurohuni që të ecni përreth dhe të shikoni planifikimin e çdo pjesëmarrësi. Ne kemi pas përvoja që disa mësues thjesht kanë punuar me detyrat e dhëna në librat e tyre dhe as nuk kishin menduar për një detyrë të synuar. Ata thjesht na thanë se gjithmonë kanë punuar kështu dhe librat janë të mirë. Edhe nëse kjo është e vërtetë, ideja është që të provoni diçka ndryshe. Prandaj, inkurajojini ata të jenë më fleksibël dhe të përfshihen në diçka të re dhe të panjohur.

Roli juaj gjatë këtij aktiviteti nuk është të jeni trajner, por më tepër këshilltar (coach).

Ju jepni komente për vlerësimet e tyre, ndoshta këshilla. Bëni pyetje, motivojini dhe vlerësoni, nëse ata e kanë lidhur planifikimin e tyre me disa aspekte të përmendura në inputet teorike.

Gjithashtu, nëse vëreni një ide që mund të jetë interesante edhe për të tjerët, mund të ndërpritni punën e tyre. Me kusht që pjesëmarrësi të pajtohet se ajo ose ai mund të paraqesë idenë.

Aktiviteti 4d Shoku kritikues



→ Dorëzoni fletën e punës 8 "Shoku kritikues". Për informacion të detajuar shikoni në fletën e punës. Të gjithë pjesëmarrësit duhet të kenë kohë të lexojnë së pari fletën dhe të bëjnë pyetje nëse kanë ndonjë.

- Sigurohuni që të gjithë të kenë një partner të ri tani dhe prezantojini planin e tyre. Partneri i ri duhet të dëgjojë me kujdes, të bëjë pyetje dhe / ose ndoshta të sigurojë më shumë ide që prezantuesi mund t'i integrojë në planifikim. Pas disa kohësh, ata ndërrojnë rolet.

Udhëzim: (Sllajdi 26)

✓ Paraqisni planifikimin / njësinë ose temën tuaj tek një mik kritikues.

- Kërkonte nga pjesëmarrësit të ulen së bashku në **grupe lidhur me shkollën** në fillim të fazës tjetër.

Aktiviteti 4e Finalizimi i këtij aktiviteti të gjatë dhe intensiv



Në fund të kësaj faze pyesni në seancë plenare nëse ata vërtet kanë rënë dakord për një takim apo një telefonatë në të cilën ata shkëmbejnë ide të mëtejshme dhe gjithashtu a kanë caktuar një takim / telefonatë tjetër më pas, në të cilën ata do të flasin për përvojat e tyre dhe do të pasqyrojnë mënyrën e funksionimit të planifikimit të tyre.

Me një buzëqeshje, thoni se ky është një mjet nga stërvitja që ndihmon për t'i bërë njerëzit në të vërtetë të bëjnë atë që ju është kërkuar ose atë që dëshirojnë. Nxitni që të provojnë atë edhe me nxënësit e tyre gjithashtu.



Nëse ka mbetur pak kohë, ftoni disa prej tyre të tregojnë planet e tyre. (Ju ndoshta i keni parë të mirët kur keni ecur përreth...)

Metodat me nxënësin në qendër (MNQ)

moduli 2

AKTIVITETI NR. 5

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Implementimi i MNQ-së	Identifikimi i status quo / sfidave	5 PG në lidhje me shkollën		Sllajdi 27, 28	20'



KSC-të dhe mësimdhënësit e së njëjtës shkollë ulen së bashku. Tregojuni pjesëmarrësve që pas këtij aktiviteti mësimdhënësit do të njohin një metodë të fundit ndërsa KSC-te do të ulen së bashku për të biseduar rreth çështjeve që lidhen me rolin e tyre dhe MNQ-ne.



Kërkojini KSC-ve të shkruajnë një protokoll dhe t'ju dërgojnë një kopje përmes postës elektronike.

Aktiviteti 5 Diskutimi i status quo-së (Sllajdi 27):

KSC-të udhëheqin diskutimin në grupin e tyre shkollor. Nëse KSC nuk është i pranishëm sot, grupi duhet të kërkojë nga një person që të jetë përgjegjës për diskutimin dhe të shkruajë dhe dërgojë protokollin.

Udhëzimet:

✓ Diskutoni status quo-në dhe sfidat që shihni në nivelin e shkollës.

Pyetjet udhëzuese (sllajdi 28)

- Si funksionon rrjeti KSC –mësimdhënës
- A ka mbështetje nga DSH?
- A zbatohet MNQ-ja në shkollë në përgjithësi?
- A ka ndonjë informate kthyesë nga mësimdhënësit e tjerë?
- A ka mësimdhënës të tjerë që mund të futen në bord?
- A ka ndonjë pengesë?

Metodat me nxënësin në qendër (MNQ)

moduli 2

DITA 2

AKTIVITETI NR. 6

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Çështjet lidhur me rolin e KSC-se	Shkëmbimi i pikëpamjeve dhe përmirësimi i rrjeteve	6.1 PG (KSC)	Fletë pune 9 (vetëm për KSC-te) Nëse është e mundur: një dhomë tjetër (e vogël) ose një sallë	---	40'

- Ky është një aktivitet i ndarë! KSC-të bëjnë diçka ndryshe nga mësimdhënësit – dhe ata takohen veçmas në një dhomë tjetër. Ju e gjeni detyrën e mësimdhënësve në **aktivitetin 7!** Nëse është e mundur, KSC-te takohen në një dhomë tjetër ose diku tjetër që është e përshtatshme. Tregojuni atyre, që herë do të jeni me ta dhe herë me mësimdhënësit e tjerë.

Sipas përvojës sonë, duhet të ketë një hapësirë kohore kur KSC-të e shkollave të ndryshme kanë mundësinë të shkëmbejnë mendimet e tyre në lidhje me rolet e tyre të veçanta, detyrat dhe sfidat që vijnë me punën e tyre të re. Në punëtoritë tona kemi vërejtur sfida të ngjashme për disa mësimdhënës të cilët u përpoqën të zbatonin metoda bashkëpunimi në shkollën e tyre. Nga njëra anë atyre u tha se sa krenare është shkolla për përpjekjet që ata bëjnë, një përpjekje nga e cila fiton e gjithë shkolla. Por nga ana tjetër, të njëjtët mësimdhënës kishin vështirësi në marrjen e një dite pushimi për të marrë pjesë në punëtoritë tona.

Padyshim, kishte raporte krejtësisht të ndryshme, dhe nganjëherë DSH-të madje na vinin gjatë pushimit të drekës, vetëm për të thënë një përhëndetje dhe për të falënderuar ne dhe mësimdhënësit e tyre për pjesëmarrjen.

- Shpërndani fletën e punës 9 për KSC-te, tregojini atyre ku të shkojnë dhe kërkojuni atyre të fillojnë individualisht. Nëse është e mundur ata duhet të ulen në një rreth.
- Ndërkohë, ju u jepni udhëzimet tuaja mësuesve. Detyra e tyre përshkruhet në **aktivitetin 7**. Të dyja aktivitetet drejtohen paralelisht!!

Udhëzimet:

✓ Flisni për çështjet e përmendura në shabllon. Ju duhet të filloni me aspekte që kanë të bëjnë me MNQ-në që dolën në diskutim me kolegët tuaj.

Metodat me nxënësin në qendër (MNQ)

moduli 2

AKTIVITETI NR. 7

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha	
Metoda: Dia-grami i Vennit	Njohja me një metodë strukturimi	7a plenare 7b PI/PG	10' 30'	Fleta e metodës 14, dia-grami i Vennit Letër në format A3 , Tabela- stilolapsi	Sllajdi 29, 30	40'

Aktiviteti 7a Shpjegimi i metodës Diagrami i Vennit

→ Shpërndani fletën e metodës 14, diagrami i Venn-it.



Ndërsa shpjegoni metodën, skiconi skicat në një tabelë. Për informacion të detajuar: Fleta e metodës, 14.



Para se të filloni me udhëzimet për pikturat e Rembrandt, sigurohuni që diagramet DIN A3 të jenë vizatuar në mënyrë korrekte. Ju qëndroni me grupin e mësuesve derisa ata të fillojnë të plotësojnë diagramin e Venn-it. Atëherë mund të shkoni te grupi i KSC-ve.

Aktiviteti 7b Detyra: Diagram i Venn-it (Rembrandt) (sllajdi 29)

→ Dorëzoni një letër të bardhë të formatit A3 për secilën palë dhe kërkoni që të vizatohet skicat e diagramit të Venn-it vet. (sllajdi 28 duhet të jetë i dukshëm)



Ky sllajd tregon dy versionet e një pikturë Rembrandt. E para është nga viti 1635, e dyta nga viti 1636 pas vdekjes së djalit të tij.

Pikturat Rembrandt (sllajdi 30)

Udhëzimet: (sllajdi 29)

Dyshja vendos shpejt se kush është A (foto e majtë) dhe B (Foto e djathtë). Çdo person ka një letër të veçantë për të shënuar vëzhgimet e pikturës së tyre të caktuar.

- ✓ 1. (PI) Shikoni nga afër pikturën tuaj. Shënoni vëzhgimet për pikturën tuaj në fletën tuaj të letrës.
- ✓ 2. (PÇ) Krahasoni dy versionet e pikturës së Rembrandt-it të quajtura: sakrifica e Isakut. (A dhe B janë "si ekspertë" të pikturave të tyre.) Përdorni diagramin e përgatitur të Venn-it në letër A3- dhe shkruani tiparet e veçanta të pikturës së majtë (A) në rrethin e majtë, në rrethin e djathtë ato të pikturës së djathtë (B).
- ✓ 3. (PÇ) Shkruani ngjashmëritë në mes, në pjesën e mbivendosur.
- ✓ 4. (PÇ) Nxirrni një përfundim dhe shkruajeni në kutinë poshtë.

Metodat me nxënësin në qendër (MNQ)

moduli 2

AKTIVITETI NR. 8

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Detyra Rembrandt	Dhënia e informatave	8a Plenare	10'	Fleta e punës 9, Rrethi i	30'
Informata kthyesë: rrethi i synuar	kthyesë për punëtorinë MNQ	8b Plenare	5'	synuar	31
		8c Pl > plenare	30'	Fleta e reflektimit 10, në DKM midis moduleve	

Pjesëmarrësit qëndrojnë ulur tani në **grupe që kanë të bëjnë me shkollën**, së bashku me KSC-të e tyre.



Sigurohuni, pyetja juaj është mjaft e hapur për të mundësuar përgjigje të ndryshme të pjesëmarrësve, qoftë për metodën ose për fotografitë e Rembrandt si të tilla.

Aktiviteti 8a Përmbledhja e ideve të Diagramit të Venn-it

Udhëzim:

✓ A ka ndonjë gjë që dëshironi të ndani në lidhje me përvojën tuaj me diagramin e Venn-it?

Më pas shpërndani fletën e metodës 14 dhe kërkoni që të plotësojnë pjesën e poshtme si zakonisht.

Informacion shtesë për "diagramin e Venn-it"

Ju mund ta përdorni këtë metodë nga klasa 1 deri në universitet. Ndhmon nxënësit të krahasojnë tekstet, të gjejnë ngjashmëri dhe ndryshime (ose, për fëmijët më të vegjël: fotografi / shkrimin e shkronjave /...). Ata me të vërtetë duhet të shohin versionin e tyre dhe të flasën se si të plotësojnë saktë pjesën e mesme të shabllonit. Dhe ndërsa e bëjnë këtë, nxënësit praktikojnë të menduarit abstrakt dhe verbalizimin.

Në klasat e larta ju mund të dorëzoni tekste të ndryshme me të njëjtën temë në çifte të ndryshme dhe t'u kërkoni atyre të gjejnë ngjashmëri (e ndryshimeve) në një seancë plenare më pas (p.sh: matematikë/biologji...: zgjidhje të ndryshme për një problem të caktuar. ne gjuhen shqipe: rishikime të ndryshme për një libër / një shfaqje teatrore...).

Aktiviteti 8b Fletë reflektimi mbi detyrat komplekse së të nxënit



Përdorimi i fletës së mëposhtme të reflektimit varet nga fakti nëse ka një modul tjetër për të ardhur ose jo.

Së pari, ka për qëllim të mbështesë mesimdhënësit që të pasqyrojnë përvojat e tyre kur punojnë me detyra komplekse së të nxënit (DKM) dhe ndikimin që ajo mënyrë e punës ka tek ata dhe tek nxënësi.

Së dyti, mendohet si një udhëzues për rrejetet brenda shkollës dhe për takimet e tyre.

Dhe së treti, mund të shërbejë si një pikë referimi në fillim të një moduli të tretë dhe të lidhë modulet si fleta e reflektimit që pjesëmarrësve u është kërkuar të plotësojnë midis moduleve 1 dhe 2.

→ Dorëzoni fletën e punës 11 (Reflektim mbi detyrat komplekse së të nxënit). Udhëzimet tuaja varen nga moduli i mëposhtëm.

Aktiviteti 8c Informata kthyesë për modulin (sllajdi 31)

Metoda "Rrethi i synuar" është i njohur për pjesëmarrësit (shih: fleta e metodës 10, moduli 1, dita 2, nëse doni të siguroni veten rreth metodës). Rrethi i synuar i sotëm ka rubrika të ndryshme.

- Shpërndani fletët e informatave kthyesë (fleta e punës 10) dhe kërkojuni që ta plotësojnë. Pjesëmarrësit duhet ta lënë kopjen e tyre përmbys në tryezën e tyre.

(Alternativa: në një karrige që e vendosni afër hyrjes. Pastaj, ata e lënë letrën kur të shkojnë.)

Tregojuni përsëri se shënimet e tyre janë anonime.

Udhëzimet:

- ✓ *Ju lutemi bëni një kryq në secilën pjesë për të cilën doni të jepni informata kthyesë. Qendra qëndron për më të mirën, për të qenë drejtë në shënjestër.*
- ✓ *Ju lutemi plotësoni edhe 2 kutitë poshtë rrethit. Nëse nuk ka vend të mjaftueshëm, mund të përdorni edhe pjesën e pasme të letrës.*



Nëse pjesëmarrësit duan të ndajnë diçka publikisht, ata duhet të jenë në gjendje ta bëjnë këtë pasi të kenë mbushur letrat e informatave kthyesë.



Nëse ky është moduli i fundit që mund të ofroni të qëndroni në kontakt me ta.

Ndani disa vëzhgime të fundit me ta dhe komentoni mbi pjesëmarrjen e tyre, atmosferën etj.

Jepni atyre të dhënat tuaja të kontaktit, bëni një foto të fundit me të gjithë grupin së bashku dhe i thoni lamtumirë të gjithëve me një buzëqeshje.

Metodat me nxënësin në qendër (MNQ)

moduli 2

DITA 2

AKTIVITETI NR. 9

Përmbajtja	Objektivi	Forma e punës	Materialet	PPT	Koha
Parashikimi i modulit tjetër	Dhënia e orientimit	9 Plenare 10'	Tabela	---	10'

Ky aktivitet varet shumë nga fakti nëse ekziston një modul tjetër apo jo. Nëse nuk ka, **aktiviteti 8** është fundi i këtij moduli.



DOKUMENTI 1 PËR TRAJNERËT, METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 2, DITA 1

Prezantimi kryesor

(Prezantimi në Power Point 2, 22 sllajde)

→ Para se ta bëni prezantimin kryesor, flisni për sllajdin 1 + 2.

SLLAJDI 1: FOKUSI I KËTIJ PREZANTIMI DO TË JETË MBI DETYRAT KOMPLEKSE TË NXËNIT.

SLLAJDI 2: → SHPËRNDANI DHE SHPJEGONI FLETËN E PUNËS „KËNDI I DJATHTË”.

Prezantimi kryesor

SLLAJDI 3: DETYRAT KOMPLEKSE TË NXËNIT

Në përkufizimin në ekran theksohen tre aspekte:

I pari dhe më i rëndësishmi - përcaktohet synimi i një detyre komplekse të mësimnxënies, synimi që ua mundëson nxënësve të përmirësojnë aftësitë e tyre; **çdo** nxënës duhet të ketë mundësinë ta bëjë këtë pavarësisht nga niveli ose aftësia e tij.

Të gjithë do të pajtoheshin me një synim të tillë i cili tingëllon thjeshtë, por në fakt nuk është aq e lehtë për tu arritur nëse mendoni për aftësitë e ndryshme të nxënësve tuaj në klasë.

Detyra komplekse - shpesh e ndërlidhur ngushtë me të ashtuquajturën detyrë të synuar - është detyra që nxënësit duhet të jenë në gjendje ta bëjnë në fund. Duhet të jetë e qartë për çdo nxënës që nga fillimi. Vetëm atëherë do të dinë se çka pritet prej tyre në fund të një njësie mësimore ose kur merren me një temë. Me fjalë të tjera, nxënësit orientohen.

Nëse e kanë atë orientim, mund të kuptojnë pse duhet të bëhen detyra dhe ushtrimet e caktuara - e nëse ende nuk e kuptojnë, mësimdhënësi mund t'u ndihmojë të kuptojnë rëndësinë e tyre.

Në këtë lloj organizimi, detyrat ka më shumë gjasa të bëhen “kuptimplota” për nxënësin.

(p.sh. gjuha: Nëse detyra komplekse e mësimnxënies është të porositni me sukses diçka në një restorant, ata do të kuptojnë pse përvetësimi i një fjalori të caktuar ka kuptim.)

(p.sh. matematika: Nëse detyra është të ndahet një torte në mënyrë të barabartë midis 12 mysafirëve, nxënësit kanë një sfidë këtu dhe shpresojmë të shohin kuptimin në të mësuarit diçka rreth pjesëtimit).

→ Pse janë detyrat komplekse të mësimnxënies aq jetike?

SLLAJDI 4: NJË SHIKIM I SHKURTËR PRAPA – 5 SLLAJDE NGA PREZANTIMI I PARË:

Në prezantimin kryesor në punëtorinë e fundit - disa prej juve do t'ju kujtohet - përveç aspekteve të tjera, fokusi ishte në neuroshkencën, konstruktivizmin, kompetencat kryesore që duhet të zhvillohen, rezultatet e PISA-s dhe mësimnxënien bashkëpunuese. Le ta rifreskojmë memorien tonë dhe t'i shohim shkurtimisht ato pesë fusha përsëri.

SLLAJDI 5: NEUROSHKENCA

Sa i përket neuroshkencës, u përmend që rrjetet nervore duhet të nxiten shpesh dhe në mënyra të shumëfishta (multimodale). Përndryshe mësimnxënia e qëndrueshme nuk është e mundur.

SLLAJDI 6: KONSTRUKTIVIZMI

Sa i përket konstruktivizmit, u theksua se çdo nxënës duhet të ndërtojë dhe rindërtojë (+ bashkë-ndërtojë) realitetin e tij kundrejt kontekstit të tij dhe informatave në dispozicion të tij ose të saj.

SLLAJDI 7: KOMPETENCAT (AFTËSITË)

Fushat kryesore të kompetencave janë prekur. Ato janë të ndërlidhura me lëndën dhe përfshijnë nivele të ndryshme të tilla si riprodhimi, zbatimi i njohurive dhe transferimi. Ato u mundësojnë nxënësve të ndërveprojnë me sukses dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në fusha të tjera. Për më tepër, ato u mundësojnë nxënësve të veprojnë në mënyrë më të pavarur, t'i zhvillojnë vetë-aftësitë si dhe kompetencat metodologjike. Këto kompetenca do t'u ndihmojnë atyre që të trajtojnë me sukses një problem dhe të pasqyrojnë rezultatin.

SLLAJDI 8: PISA 2015

Një përkujtues tjetër. Gjatë interpretimit të rezultateve të PISA-s, mendimi kritik, zgjidhja e problemeve dhe kreativiteti janë parë si mangësi kryesore.

→ PISA 2018: niveli i njëjtë, madje rezultatet në shkencë edhe janë përkeqësuar



Si trajner i punëtorisë: kontrolloni të dhënat e fundit dhe mundësisht jepni një azhurnim!

SLLAJDI 9: MËSIMNXËNIA BASHKËPUNUESE

Mësimnxënia bashkëpunuese dhe aplikimi i metodave bashkëpunuese ishin tashmë në fokus pasi që ka të ngjarë që t'i aktivizojnë nxënësit në mënyrë më intensive. Në punëtorinë e parë është theksuar se **metodat gjithmonë mbështesin** përmbajtjen dhe nuk duhet të jenë kurrë faktori i parë kur planifikoni një proces mësimor.



(Mund t'i përdorni informatat në sllajd në më shumë detaje).

Fjalët kyçe janë: metodat e të nxënit dhe aranzhimet, për të cilat nevojiten veprime të koordinuara të nxënësve për të gjetur një zgjidhje; nxënësit bashkëpunojnë në çifte ose grupe, kanë detyra të ndryshme ose të njëjtë;

Gjatë një periode mësimdhënësit duhet të aplikojnë shumë metoda të ndryshme.

Aspekte të rëndësishme: Metoda duhet të mbështesë çdoherë përmbajtjen; përmbajtja është fillimi i planifikimit, e jo e kundërta.

SLLAJDI 10: PLANI JAVOR



Shënim: Merrni parasysh emërtimin e "planit javor"! Ka dallime në mes të Kosovës dhe Gjermanisë në këtë aspekt.

Koment anësor: plani javor tregon se disa ide të fokusuara në këtë punëtori, tashmë janë pjesë e sistemit. Tregojuni pjesëmarrësve:

- *"Sipas meje, aspekti jashtëzakonisht pozitiv është se planifikimi për një javë tashmë kërkohet dhe është mjaft i zakonshëm. Çdo mësimdhënës tashmë e di se çfarë duhet të bëjë në javën që vjen, ka një ide se sa kohë donë të kalojë në një detyrë të caktuar lidhur me lëndën, etj.*
- *Ajo që padyshim nuk mund të shoh është se çfarë lloj materiali përdoret ose ofrohet në libër.*
- *Kjo punëtori ofron ide shtesë që duhet të merren parasysh kur planifikoni njësite mësimore në të ardhmen".*

Vërejtja e mundshme personale

Ndoshta ju tani ndiheni sikur unë në kohën kur ideja e përgjithshme kërkonte një **planifikim tjetër** nga ana ime, isha skeptik! Dhe u desh pak kohë derisa u binda se **planifikimi nga fundi deri në fillim dhe përzgjedhja e materialit të duhur nga librat gjatë rrugës** ka shumë përparësi për nxënësit.

Siç u përmend më parë, një aspekt që shkon së bashku me këto ndryshime është ideja e përdorimit të së ashtuquajturës **detyrë e synuar** si një **pikë fillestare** e planifikimit të njësisë mësimore nga ana e mësimdhënësit.

(Tradicionalisht në fund të procesit mësimor, nxënësit duhet të përdornin njohuritë e tyre në detyra që vijnë disi si të papritura dhe kërkojnë një lloj kalimi të njohurive. Planifikimi ishte vetëm në kokën e mësimdhënësit. Është sikur mësimdhënësi të kishte fshëhur disa dhurata në një kopsht dhe detyra në fund ishte gjetja e tyre. Me fjalë të tjera, vetëm mësimdhënësi i dinte faktet dhe fjalët kyçe të cilat nxënësit duhet t'i mbulonin për të marrë një notë të mirë).



Sipas përvojës tonë, shumë pjesëmarrës kishin vështirësi të shumta për të kuptuar domethënien e detyrës së synuar ose detyrave komplekse që kërkojnë planifikim prapavajtes.

Meqenëse është krejtësisht ndryshe nga ajo që janë mësuar gjatë jetës së tyre profesionale deri më tani, nuk është për t'u habitur.

Prandaj, me të vërtetë merrni kohën që ju nevojitet për të shpjeguar këtë fokus siç duhet. Kjo do t'ju ndihmojë më vonë kur grupet fillojnë të bëjnë punë praktike.

SLLAJDI 11: TRE NIVELET E KËRKESËS

Sa i përket procesit mësimor në shkollë, janë kryesisht 3 nivele të kërkesave:

1. Niveli i përmbajtjes
2. Niveli i gjuhës
3. Niveli social

(gjithashtu përdorni informatat e dhëna në sllajd)

Sidoqoftë, sot dhe nesër kryesisht do të fokusohemi në dy të parat.

Niveli social ishte tashmë një çështje e trajtuar në punëtorinë e parë kur fokusi ishte të bashkëveprimi.

Më shumë vëmendje do t'i kushtohet kësaj fushe në punëtoritë e ardhshme.

SLLAJDI 12: NIVELET E NDRYSHME TË MËSIMNXËNIES

Siç është përmendur më parë, (sllajdi 5) njerëzit mësojnë në mënyra të ndryshme (përqendrohuni tek individi: disa mësojnë në mënyrë kognitive, të tjerët të orientuar drejt veprimit etj.) Por ka edhe nivele të ndryshme të mësuarit.

(Sllajdi 7): disa mund (vetëm) të riprodhojnë, disa mund të përdorin aftësitë dhe njohuritë e tyre në një fushë të paracaktuar dhe disa mund të transferojnë kompetencat dhe njohuritë e tyre dhe t'i përdorin ato në një fushë tjetër.

Pra, padyshim që nxënësit në çdo klasë ndryshojnë sa i përket aftësive të tyre. Disa do ta arrijnë me lehtësi qëllimin, të tjerët kanë nevojë për pak apo shumë ndihmë ose përndryshe kurrë nuk do ta arrijnë qëllimin përfundimtar.

SLLAJDI 13: SKELA

Një koncept që paraqet në mënyrë pamore se si nxënësit mund të ndihmohen në procesin e tyre të të mësuarit kur trajtojnë një detyrë është skela. (Referojuni fotove në këtë sllajd këtu).

- Në një kantier ndërtimi, skelat janë jashtëzakonisht domethënëse, pasi që ato i ndihmojnë punëtorët të kryejnë punën e tyre.
- Disa skela janë më pak domethënëse (siç shihet në Indi) sepse ato janë të pamjaftueshme dhe rrezikojnë paraqitjen e ndonjë aksidenti fatal ose thjesht mosarritja e qëllimit është e mundshme.
 - Shumë prej nesh kemi përjetuar një lloj skele që nuk reflektohet kurrë. Kur fëmijët mësojnë të ecin, dora e prindërve është e natyrshme dhe natyrisht shumë domethënëse - por pas një kohe kjo dorë bëhet më pak e rëndësishme, asnjë prind nuk do ta mendonte kurrë që dora e tyre duhet të mbështesë fëmijën përgjithmonë.

Pra, ideja kryesore e skelave është se ajo është e nevojshme në një moment në kohë, por më vonë largohet.

Më vonë sot do të kemi një vështrim më të thellë të skelave ku do të punoni me atë koncept.

SLLAJDI 14: LIDHUR ME SKELAT

Siç u tha tashmë, fëmijët në çdo klasë janë të ndryshëm; disa mund të kenë nevojë për më shumë mbështetje, të tjerët më pak; disa mund të kenë nevojë për mbështetje në një fushë tjetër nga të tjerët. (p.sh.: ngjitja në një pemë - (gjashtë/dhjetë vjeç))

Në kontekstin shkollor ekzistojnë dy fusha kryesore ku shumë fëmijë kanë nevojë për mbështetje:

- a) Përmbajtja
- b) Gjuha

Sidoqoftë, skelat janë **gjithmonë të përkohshme** - ato nuk qëndrojnë kurrë!

Kur t'i kenë shërbyer qëllimit të tyre, ato hiqen, zhduken.

SLLAJDI 15: ZHVILLIMI I PËRAFËRT

Një ide tjetër kryesore thjesht do të thotë që nxënësit duhet të jenë në gjendje ta arrijnë qëllimin. Nëse hapat e kërkuar janë shumë të mëdhenj, ata nuk mund ta arrijnë qëllimin sado që përpiqen. Këtu zona e zhvillimit të përafërt hyn në lojë.

(p.sh.: për të blerë një biletë në internet për një nxënës të klasës së dytë = normalisht kjo është një kërkesë shumë e lartë)

(p.sh. futboll: profesionistët shpesh integrohen ngadalë në një ekip më të mirë, sepse u duhet kohë që të zhvillojnë shpejtësinë, t'i dinë taktikat etj.)

SLLAJDI 16: TEORIA E AJSBERGUT (CUMMINS)

Cummins shqyrtoi gjuhën e përdorur në situata të ndryshme dhe merita e tij është se ai bëri shumë kërkime dhe i bëri njerëzit të kuptojnë vështirësitë gjuhësore në proceset e mësimnxënies.

Cummins, një profesor Kanadez dhe ekspert në përvetësimin e gjuhës së dytë, bëri dallimin midis BICS dhe CALP qysh në vitin 1970 - megjithëse në një kontekst krejtësisht tjetër në atë kohë. Pra, në një farë mënyre, dallimi i tij është një teori e vjetër - ose do të thosha një vëzhgim i vjetër – megjithatë është ende e rëndësishme sot dhe e zbatuar në një mënyrë shumë të gjerë.

BICS = Shkathtësitë themelore të komunikimit ndërpersonal - përdoren midis miqve, me të huajt në komunikimin real për çfarëdo aspekt të jetës në jetën e përditshme.

CALP = Njohja e Gjuhës Akademike Kognitive - përdoret në fushat akademike, është shumë më formale, nga pikëpamja kognitive më sfiduese dhe kërkon strategji të menduarit kritik ose zgjidhjes së problemeve.

(shikoni fragmentin më poshtë për informata më të hollësishme)

KRAHASIMI I BICS DHE CALP

BICS

- Gjuha që përdoret në komunikim midis miqve apo me të huajt, apo në komunikimin real për çfarëdo apo të gjitha aspektet e jetës
- Për të zhvilluar BICS, nxënësve duhet t'u sigurohen shumë mundësi për situatat e gjuhës ku ata i luajnë rolet dhe kanë ndërveprime të sofistikuara sociale.
- BICS përfshinë shprehjet idiomatike dhe proverba, thënie, dhe shprehje popullore.
- Njohuritë e BICS janë shumë të rëndësishme për t'u ndjerë rehat, dhe për të përdorur gjuhën e duhur sociale në situatat e komunikimit në jetën reale.

CALP

- Gjuha që përdoret në fushat e përmbajtjes, gjuha e të menduarit kritik të nivelit të lartë, për krijimin e hipotezave, për të folur rreth matematikës, kimisë, muzikës, historisë, shëndetit, etj.
- Nxënësi nuk e një rrjedhshëm gjuhën angleze derisa nuk e zotëron CALP. CALP duhet të jetë fokusi i zhvillimit gjuhësor të të gjitha programeve institucionale për të gjithë nxënësit.
- Për të zhvilluar CALP, nxënësve duhet t'u sigurohen shumë mundësi për të vëzhguar, dëgjuar, dhe folur për konceptet e fushës së përmbajtjes, që nxënësit duhet të zotërojnë leximin dhe shkrimin duke përdorur CALP.
- Njohuritë rreth CALP sigurojnë suksesin akademik. Njohuritë rreth CALP janë thelbësore për suksesin akademik dhe arsimin e lartë, si dhe për mendimin kritik.

<http://www.educationalquestions.com/qa51.htm>

SLLAJDI 17: PËR PËRDORIMIN PRAKTIK NË SHKOLLË:

Pra, çfarë do të thotë kjo për ju si personel mësimdhënës, cilat janë pasojat?

Sa i përket procesit të planifikimit - çdo mësimdhënës, jo vetëm mësimdhënësi i gjuhës, duhet të fokusohet në fusha të ndryshme:

- Përmbajtja është në thelbin e planifikimit të çdo njësie mësimore ose kur merreni me një temë të re. Por duhet të vendoset (përkthehet) në një detyrë komplekse kuptimplote për nxënësit.
- Pastaj, duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejta me pyetjen se cila kompetencë/duhet të zhvillohet me atë njësi/në atë temë. Pra, ka të bëjë me marrjen e një vendimi këtu.
- Nëse bëhet fjalë për materialet/metodat etj., bëhet fjalë për të bërit e zgjedhjes. Ju duhet ta përdorni librin ose materialin “si pyetje” - me fjalë të tjera: zgjidhni ato që i konsideroni të jenë pjesë të duhura dhe lini mënjanë ato që i konsideroni më pak domethënëse. Pra, përpuni të mos përdorni gjithçka që keni në dispozicion. (një gabim që shpesh e bëjnë mësimdhënësit e papërvojë)
- Në fund, gjithmonë duhet të keni kritere vlerësimi në fund të njësisë mësimore ose kur prezantoni një temë të re - të paktën, nëse ka vlerësim përmbledhës (sumativ). Dhe është absolutisht e nevojshme t'ua komunikoni atyre paraprakisht, sepse kështu nxënësit do të dinë se çfarë kërkohet prej tyre, cili është qëllimi dhe çfarë duhet të arrijnë.)

Nesër do të fokusohemi në një proces të tillë në mënyrë më të detajuar me një model që kemi zhvilluar. Kjo do të shërbejë si një bazë për përgatitjen tuaj të një njësie mësimore ose një teme.

SLLAJDI 18: AKTIVIZIMI NJOHËS (KOGNITIV) – KURRIKULA SPIRALE

Dy aspekte më të rëndësishme për t'u marrë parasysh në një proces të tillë planifikimi janë:

Aktivizimi kognitiv

Mësimnxënia në shkollë kërkon që nxënësit të lidhin vazhdimisht informata të reja me informatat që tashmë i kanë mësuar. Kur nxënësit janë në gjendje të përdorin informatat hyrëse për të aktivizuar informatat tashmë në mendjet e tyre, informatat e reja lidhen në mënyrë më të integruar me informatat e vjetra.

--> (referojuni: konstruktivizmit/rrejteve cerebrale)

Kurrikula spirale



Për të dhënë një shembull: kafshët

Nëse nxënësit flasin për habitatin e kafshëve në xhungël, kjo nuk do të jetë hera e parë që ata dëgjojnë për kafshët në xhungël. Nga fazat shumë të hershme në jetën e tyre ata do të kenë dëgjuar për to dhe kafshët në përgjithësi me siguri janë përfshirë në programin mësimor më parë. Pra, megjithëse para-njohuritë e tyre do të ndryshojnë, nxënësit nuk do të qëndrojnë në klasë si “fleta të zbrazëta”.

Ideja e kurrikulës spirale nënkupton që mund t'i aktivizoni nxënësit në mënyrë kognitive, të ndërtoni mbi njohuritë e tyre të përvetësuar në shkollë dhe/ose në shtëpi. Prandaj, shumë programe mësimore zyrtare dhe libra shkollorë ndjekin atë qasje. Materiali nuk është rregulluar në një mënyrë lineare por në formën e një spiraleje në mënyrë që temat individuale të mësohen disa herë gjatë viteve të shkollës, çdo herë në një nivel më të lartë dhe në një formë më të diferencuar.

SLLAJDI 19: PAMJA (DHE THELLËSIA) – STRUKTURAT E NJËSIVE MËSIMORE

Aspekti përfundimtar:

Kur shikoni se çfarë po ndodh në klasë, dallimi i mëposhtëm është i dobishëm:

Të bëhet dallimi midis strukturave të pamjes dhe strukturave të thellësisë.

Struktura e pamjes është gjithçka e dukshme, prandaj është relativisht e lehtë për t'u vlerësuar, komentuar dhe përmirësuar..

SLLAJDI 20: STRUKTURA E THELLËSISË

Struktura e thellësisë: është gjithçka që është e fshëhur, jo lehtë për tu përcjellë.

(p.sh.: Sa i fokusuar është nxënësi? A ka ndonjë mendim shpërqendruar? A ka ndonjë problem në shtëpi që dominon të menduarit e tij? ...)

Disa nga këto struktura të thellësisë mund të bëhen të dukshme në një masë të caktuar nëse marrëdhënia ndërmjet mësimit dhe nxënësit është e vendosur mirë dhe janë zhvilluar strukturat bashkëpunuese, të hapura me prindërit dhe nxënësit, gjithashtu, nëse ekipet ndërdisiplinore punojnë së bashku me konfidencialitet.

SLLAJDI 21: VËSHTRIMI NË TË ARDHMEN

Më lejoni të përfundoj me një vështrim duke marrë nga ngjitjen në mal:

Çdo shëtitje fillon me hapin e parë – hapat e parë shpesh (duken) janë më të vështirë sesa në të vërtetë janë, ku më pas këto hapa bëhen pjesë e rutinës dhe hapin horizontale dhe sfida të tjera dhe mali bëhet më i lehtë për tu ngjitur.

→ SLLAJDI 22: KËNDI I DJATHTË – UDHËZIME PËR GRUPET E TAVOLINAVE

DOKUMENT PËR TRAJNER 2 – METODAT ME NXËNËSIN NË QENDËR MNQ, MODULI 2, DITA 2

Rreth detyrave komplekse së të nxëniet (DKN)

(Sllajdi 6 – 22 = 16 sllajde)

Ky dokument në sfond është i ndarë në seksione:

Pjesa e parë:

Një shembull i përmirësimit të një detyre të librit shkollor (bazuar në një libër të fizikës të shkollës gjermane, prezantuar nga Prof. Leisen).

Pjesa e dytë:

Një model i "detyrave komplekse të të mësuarit" në lidhje me shembullin e Leisen.

Ne anën tjetër: Prof. Dr. Josef Leisen: një trajner i mirënjohur i seminarit gjerman, pedagog dhe ish profesor i didaktikës së fizikës në universitetin e Mainz, Gjermani.

PËR 1. (ZMADHIMIN E NJË LIBRI SHKOLLOR)

Sllajdi (6) / 7: tregon një faqe nga një libër shumë i zakonshëm gjerman i fizikës (klasa 9). Në të majtë të fotos, ka disa informacione të fizikës, si dhe informacione të tjera në lidhje me këtë tenxhere me ujë si "këmbët e gomës", "sistemi qendror pa tel 360 °", "çeliku i pandryshkshëm"...

Sllajdi 8: Ana e majtë tregon detyrat e marra nga libri shkollor, i cili konsiston kryesisht në llogaritje (matematikën): 1., 2., 4. : llogarit, 3. përcakton eksperimentalisht dhe llogarit.

Sllajdi 9: Tani Z. Leisen zmadhon detyrën e dhënë: Shikoni detyrën B në sllajd. Ai shton:

1. *Nënvizoni informacionin në lidhje me fizikën në blu, atë më të lehtë në të kuqe.*

2. *Ju punoni për një revistë të konsumatorëve. Kontrolloni, nëse të dhënat fizike janë të sakta dhe shkruani një raport.*

Përdorni kutinë e materialit (sllajdi 10) dhe kartat mbështetëse (sllajdi 11), nëse është e nevojshme. = Skela

Sllajdi 10: Para mësimit / temës mësimitdhënësi përgatit karta mbështetëse (sllajdi 11) dhe një kuti te materialit (sllajdi 10) të cilën nxënësit mund të përdorin. **Në anën e majtë të sllajdit tregohet përmbajtja e kutisë së materialit: + kutia e sipërme ana e djathtë: ligjet e qarkut, kutia e poshtme, ana e djathtë: është një sugjerim se si të përdorni etiketën e tipit dhe për të përcaktuar performancën efektive..**

Sllajdi 11: Tregon kartat e ndryshme mbështetëse që shpjegojnë marrëdhëniet fizike.

Sllajdi 12: material tjetër që pasuron detyrën e librit shkollor: **këtu: një raport i vërtetë prove për këtë tenxhere me ujë, marrë nga një revistë e konsumatorit.**

Sllajdi 13: Detyra e re në të cilën llogaritja është vetëm një pjesë e saj, *është të shkruash raportin tënd dhe ta krahasosh me atë zyrtar dhe t'i vlerësosh të dyja*. Për të qenë në gjendje ta bëjnë këtë, nxënësit duhet të bëjnë të gjitha eksperimentet fizike paraprakisht..

Sllajdi 14: Tregon një detyrë të mundshme për nxënësit e shkëlqyeshëm (diferencimi):

Një klient pyet: A mundem ta përdori atë në SH.B.A. (115V)?

PËR 2. (DETYRA KOMPLEKSE E TË NXËNIT)

→ Dorëzoni fletën shtesë për detyrat komplekse së të nxënit. Do të shpjegohet hap pas hapi.

Cilat janë aspektet e një detyre komplekse së të nxënit?

Duhet të jetë

Sllajdi 15: 1. Kuptimplotë. Detyra e synuar duhet të jetë kuptimplotë / e rëndësishme për nxënësit. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të lidhen disi. Prandaj, detyra duhet të ketë një lidhje (të dukshme) me jetën e tyre të përditshme.

P.sh. Leisen: ai përdor material autentik, tenxhere me ujë, të njohur për çdo nxënës nga shtëpia dhe vendos një detyrë kuptimplotë në të cilën nevojiten të dhëna fizike. "Ju punoni për një revistë të konsumatorëve. Kontrolloni, nëse të dhënat fizike janë të sakta dhe shkruani një raport. Përdorni kutinë e materialit dhe kartat mbështetëse, nëse është e nevojshme".
Në këtë mënyrë nxënësit e kuptojnë fizikën në mënyrë kuptimplotë dhe të rëndësishme në jetën e përditshme.

→ referoju konstruktivizmit (P I, dita 1)

Një pasojë tjetër: Kur është e mundur, nxënësit duhet të punojnë me material autentik ose të jenë në gjendje të konsultohen / bëjnë hulumtime me burime autentike.



Tani e tutje, jepen informacione shtesë nga lëndët që ne mësojmë..

Ndoshta ju, si trajner, mund të jepni disa informacione nga përvoja juaj. Kjo e bën këtë pjesë më të qartë, më të gjallë dhe ju tregoni ekspertizën tuaj dhe ndani përvojën tuaj.

Sllajdi 16: 2. Transparenca; duke lidhur kompetenca të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit dhe kompetencat e pritshme duhet të njihen nga nxënësit paraprakisht. Gjithashtu, nivele të ndryshme të kompetencave duhet të adresohen këtu (riprodhimi, aplikimi, transferimi) dhe të konsiderohen në procesin e planifikimit.

Në shembullin e dhënë nxënësit kanë ditur për detyrën e synuar "raportin e konsumatorëve" që nga fillimi. Jo vetëm që ishte e nevojshme riprodhimi, por aplikimi i kësaj njohurie në një kontekst të ri. Për më tepër, mësimmshënësi kishte planifikuar një detyrë shtesë për nxënësit e mirë (SHBA).

Sllajdi 17: 3. Zgjidhje të ndryshme individuale, çiltërsia (të qenët i hapur). Detyra e synuar është vendosur në një mënyrë të hapur, në mënyrë që zgjidhjet e ndryshme (individuale) të jenë të mundshme.

Leisen: Detyra 1 ndihmon nxënësin, i cili nuk merret aq shumë me fizikën, për të organizuar informacionin.

Detyra 2 është për të gjitha tipat e nxënësve: ata duhet të kontrollojnë të dhënat, të zhvillojnë një eksperiment. Kjo është për ata që janë veçanërisht të interesuar në fizikë, raporti mund të jetë më interesant për ata që janë më të interesuar nga ana gjuhësore. Për më tepër, zgjidhja është e hapur. Për të mbështetur nxënësit kur zgjidhin detyrën e synuar, mësimmhënësi jep sugjerime dhe mbështetje përmes një kutie te materialit dhe kartave mbështetëse (të cilat nuk duhet të përdoren).

Sllajdi 18: 4. Sfiduese në mënyrë kognitive. Detyra duhet të jetë kërkuese dhe që garanton se bën përparimin e nxënësve jo shumë sfidues, por mjaftueshëm kërkues!

Leisen: Shkruani raportin tuaj dhe krahasoni atë me atë zyrtar dhe vlerësoni të dy. Nxënësit do ta zgjidhin këtë detyrë sipas aftësive të tyre.

Sllajdi 19: 5. Të menduarit kreativ divergjent. Detyra duhet të lejojë të menduarit divergjent (-->referojuni ushtrimit mbi të menduarit di- / konvergjent përpara kësaj te PPT). → Referojuni: mangësive të PISA: zgjidhja e problemeve, mendimi kritik, kreativitetit.

Leisen: Të shkruash një raport dhe ta krahasosh atë me një zyrtar bën të mundur shumë zgjidhje. Nëse nxënësit përqendrohen në aspektet teknike ose vendosin një theks në aspektin e komoditetit, varet nga ata. Gjithashtu, mënyra se si ata strukturojnë raportin e tyre dhe e përhapin mesazhin e tyre është e hapur - një detyrë shumë krijuese, por natyrisht në bazë së të dhënave fizike të sakta.

Sllajdi 20: 6. Heterogjeniteti. Detyra padyshim që e merr parasysh atë aspekt dhe lejon nivele të ndryshme të zgjidhjes së detyrës.

Leisen: Nxënësit më pak të aftë do të përdorin kartat e ndihmës, etj., madje mund të kenë nevojë edhe për mbështetjen e mësimmhënësit drejtpërdrejt. Nxënësit me arritje më të lartë do të punojnë në mënyrë të pavarur dhe gjithashtu do të bëjnë detyrën shtesë.

Sllajdi 21: 7. Mbështetja (skelat: gjuha ose përmbajtja). Mendoni paraprakisht se çfarë lloj mbështetjeje duhet të jepet / do të përdoret nga nxënësit. Cilat probleme mund të parashikoni dhe çfarë mund të bëhet në lidhje me të?

Shënim: Në këtë kontekst për nxënësit me arritje me të ulët shpesh është e dobishme të kesh një zgjidhje model për një detyrë të ngjashme.

Leisen: përdor karta mbështetëse dhe siguron një kuti te materialit dhe ofron një raport të vërtetë prove nga një revistë.

Sllajdi 22: 8. prezantime (të ndryshme) të zgjidhjeve.

Një aspekt i fundit: nxënësit duhet të jenë në gjendje të zgjedhin mënyra të ndryshme për të paraqitur rezultatet e tyre. Nëse kriteret e vlerësimit janë të qarta, nuk duhet të ketë ndryshim nëse nxënësit prezantojnë me gojë raportin ose në një videoklip, etj.

Për tu larguar nga detyra konkrete që Leisen kishte vendosur.

Ata duhej të krijonin një mënyrë për të shprehur temën "mërgim" në një sallë të shkollës si një detyrë e synuar. Disa shkruanin në postera, të tjerët krijuan drama të vogla, të tjerët ndërtuan një mur me një derë ku mund të kalohej - por kriteret që lejonin të kalohej përmes kësaj dere gjithmonë ndryshonin.

Më pas, secili grup duhej të jepte arsyet për zgjidhjen e tyre individuale dhe të arsyetonte pse mendonin se prezantimi i tyre ishte i rëndësishëm për detyrën e dhënë.

→ Shikoni aktivitetin 3c: **Grupi gumëzhitës në tabelën (15')**:

✓ *Shkëmbeni shpejt disa ide nëse librat shkollorë ose planifikimi juaj normal i mësimit tashmë përfshijnë aspektin e dhënë.*

DOKUMENT PËR TRAJNER 3 – METODAT ME NXËNËSIN NË QENDËR MNQ, , MODULI 2, DITA 2

Të mësuarit bazuar në detyra (MBD) hap pas hapi (sllajdi 23)

1. hapi: Mësimdhënësit gjithmonë fillojnë me përcaktimin e **temës** - varësisht nga lënda që ata japin, nota dhe Kurrikula Kosovare (KKK). **Tema** është thelbi (zemra) e të gjithë planifikimit që vijon.
2. hapi: Ata vendosin **detyrën e synuar, një detyrë komplekse**, nga nxënësit kërkohet që ata ta bëjnë atë në fund. Dhe gjithashtu kriteret për vlerësimin dhe dokumentet e vlerësimit në fund duhet të jenë të qarta që në fillim.



Kjo ide e planifikimit të një sekuence është e re për shumicën e mësuesve. Prandaj, sigurohuni që të gjithë e kuptojnë këtë ndryshim të planifikimit të një teme ose një njësie. Është absolutisht e nevojshme që mësimdhënësit të dinë se ata nuk shikojnë vetëm detyrat e dhëna (dhe zgjidhjet) në librat e tyre shkollorë dhe i kalojnë ato një nga një. Në vend të kësaj, ata gjejnë një detyrë të synuar që mund t'i interesojë klasës së tyre dhe të shohin se cilat nga detyrat e sugjeruara në libër duhet të trajtohen gjatë rrugës.


(p.sh: nëse klasa juaj është më e interesuar për teknologjinë, mund të konsideroni të përgatitni një film edukativ përmes telefonave inteligjentë në lidhje me temën. Sidoqoftë, nëse klasa është e interesuar për gjuhë, kërkoni atyre të përgatisin një broshurë arsimore për të njëjtën temë si një detyrë e synuar.)

Si trajner duhet të jeni të qartë dhe transparent në shpjegimet tuaja. Kjo do t'ju ndihmojë më vonë pjesëmarrësve të planifikojnë në mënyrë aktive njësitet ose temat e tyre në një mënyrë më të hollësishme (aktiviteti 4c) dhe ju lehtë mund t'i trajtoni ata në procesin e tyre të planifikimit.

3. hapi: Kur kërkoni një detyrë të përshtatshme të synuar në lidhje me një temë, mësimdhënësit duhet të kenë klasën e tyre në pjesën e pasme të mendjes së tyre dhe të mendojnë për ato që mund të duken interesante në atë kontekst. Nëse nxënësit shohin të rëndësishme për jetën e tyre të përditshme, ata janë më të motivuar dhe do ta kenë më të lehtë për të mësuar. (Orientimi i nxënësit).
4. hapi: Në hapin 4 mësimdhënësit reflektojnë për **kompetencat** e nevojshme për të përmbushur detyrën e synuar dhe ato që duhet të zhvillohen (më tej). Këto kompetenca mund të jenë të lidhura me temat ose më universale si leximi / shkrimi / të folurit / të dëgjuarit ose metodike / (ndër) kulturore / sociale / personale.
5. hapi: Mësimdhënësit përcaktojnë **parakushtet** (e përgjithshme) për nxënësit në grupin e tyre të saktë të të nxënësve. Siç e dinë mësimdhënësit me përvojë, ato parakushte mund të jenë më të vërtetë të ndryshme, madje edhe në klasat paralele të së njëjtës shkollë. Dhe, padyshim që mësimdhënësit duhet ta njohin mirë kurrikulën dhe t'i përgjigjen pyetjes kur dhe brenda cilit kontekst nxënësit mund të kenë fituar kompetenca dhe njohuri më parë.
6. hapi: Këto konsiderata çojnë në kapacitete të ndryshme individuale të të nxënësve. -> **diagnoza dhe diferencimi** janë fjalë kyçe këtu. Për nxënësit me arritje me te ulët pra për nxënësit me nevoja të veçanta mësimdhënësit duhet të zhvillojnë mbështetje, të përdorin skela si p.sh karta, detyra të thjeshtuara...
7. hapi: Mësimdhënësit reflektojnë se cila **metodë/a** mund të jetë e dobishme në një kontekst të dhënë; metodat që aktivizojnë të gjithë nxënësit dhe ka të ngjarë të mbështesin nxënësit në proceset e tyre të të nxënësve.
8. hapi: Më në fund, mund të ketë **kompetenca (të lidhura me lëndë specifike)**, për të cilat mësimdhënësit duhet të mendojnë gjatë planifikimit të njësisë. (p.sh. standardi i kompetencave gjuhësore kur mësohet një gjuhë e huaj).

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 2, DITA 1 - FLETË PUNE 1

Këndi i djathtë



METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 2, DITA 1 - FLETË PUNE 2

Skela – disa pyetje udhëzuese për planifikimin e njësisë / caktimin e njësisë

(vetëm makro-skeleria/dizajni)



Analiza e kërkesave për njësi/caktimi i temës:

1. Cilat terme teknike të reja nevojiten (emra, folje, mbiemra)?
2. Cilat lloje të teksteve janë pjesë e njësisë (duhet t'i lexojnë apo shkruajnë?)
3. Cilat vështirësi të tjera mund t'i kenë tekstet (për shembull ndërtimin pasiv (diateza pësore), gjuha jo e përveçme, etj.)

Niveli aktual i arritshmërisë (performancës) së nxënësve

1. A i përvetësojnë nxënësit strukturat e nevojshme?
 - a) në nivel të përmbajtjes (paraqitja pamore (vizuale), konceptet...)
 - b) në nivel të fjalëve (termet teknike, fjalët akademike,...)
 - b) në nivel të sintaksës (fjalitë e gjata, të përbëra, strukturat pasive, ...)
 - c) në nivel të tekstit (dendësi e madhe e informatave, jashtëzakonisht të bazuara në fakte,...)
2. A kanë ende nevojë për ndihmë?

Planifikimi

1. A kanë kuptim mjetet vizuale shtesë, forma të tjera të prezantimit etj.
2. A ka kuptim radhitja (nga diçka konkrete në diçka abstrakte)
3. A ka kuptim materiali shtesë për nxënësit me rezultate të larta – pak mbi nivelin mesatar)

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 2, DITA 1 - FLETË PUNE 3

Skela – disa pyetja udhëzuese për planifikimin e njësisë / caktimi i temës









(vetëm makro-skeleria/ dizajni)



Aspekti	I njohur	I panjohur	Idetë
Shembull: Përshkrimi abstrakt i eksperimentit			Paraqitja vizuale
Kushtet teknike			
Fjalët akademike (emrat, foljet, mbiemrat)			
Llojet e teksteve			
Struktura akademike e sintaksës, etj.			
	Po	Jo	Idetë
Përmbytja e menaxhueshme			

Ushtrim lidhur me të menduarit divergjent (kreativiteti)

Ju lutemi përdoreni rrethin për ta vizatuar një objekt të ri (të gjallë apo të pajetë). Vizatimet tuaj shkruajani një titull të shkurtër në katrorin nën të.

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 2, DITA 1 – FLETË PUNE 4B

Ushtrim lidhur me të menduarit konvergjent (klasifikoni, përfundoni, „për të hyrë në temë“)

Përdorni vizatimet tuaja për të formuar grupe të cilat përkujtojnë njëra me tjetrën. Shkruajeni titullin kryesor për rubrikat tuaja dhe përmendeni tiparin e përbashkët.

Shkruajeni një përkufizim të grupit nëse është e mundur.

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 2, DITA 1 - FLETË PUNE 5



METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 2, DITA 1 – FLETË PUNE 6

Plani për lëndën në vijim: _____

Tema: _____

Përgatitur nga (shkolla) _____

4. Shkathtësitë (vetëm në esencë)

5. Parakushtet e nxënësve për të mësuar

klasa:

• Njohuria paraprake:

• tematike:

• metodike:

• lingvistike:



1. Tema:

6. Diagnoza dhe dallimi

Diagnoza:

Dallimi:

Tryezat ndihmëse / Skelet

7. Metodatat e aplikuara

2. Detyra e synuar

3. Lidhshmëria me jetën e përditshme – Orientimi i nxënësit

• Referenca në Kornizën e Kurrikulës të Kosovës

8. Aspektet e mëtejshme (të lidhura me lëndën specifike):

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 2, DITA 1 – FLETË PUNE 7

Plani për lëndën në vijim: Gjuhë angleze

Tema: **Mbretëria e Bashkuar**

Eckeberg, e përshtatur nga: S. Gatermann, A. Kopetsch

4. Shkathësitë (vetëm në esencë)

Shkathësitë komunikuese

- **Leximi:** mbliidhni informata nga faqet e internetit (skanimi/leximi i shpejtë)
- **Të shkruarit:** për të dhënë informata lidhur me pamjet dhe qytetet,
- **Të folurit:**
 - në monolog: lexoni/paraqitni tekste të përshtatshme për audiencën, jepni rekomandime
 - në dialog: diskutoni në grup

Metodike- strategjike: - bëjeni një prezantim në power point për një grup të caktuar të synuar, bashkëpunoni në mënyrë domethënëse në grup; dokumentojeni procesin e punës

Ndërkulturore – për të qenë në gjendje të orientoheni në një qytet/rajon, për të dhënë rekomandime turistike dhe për të shprehur karakteristika specifike

5. Parakushtet e të nxënësve për nxënës

Klasa / niveli CEF: klasa 7 / A2 / 2+

- **Njohuria paraprake:**
 - **linguistike:** drejtimitet, fjalori themelor lidhur me pjesët e qytetit që do të përdoret në punën në grup
 - **tematike:** transporti, informatat themelore lidhur me qytetet dhe rajonet
 - **metodike:** shfrytëzimi i fjalorit, kërkimi në internet, njohuria themelore për power point
 - të lexuarit e hartës së qytetit dhe hartave të metros



2. Detyra e synuar

„Krijojeni një udhëzues udhëtimi (audio-vizual) për qytetin, qytezën ose rajonin në MB për udhëtimin e radhës të klasës sonë. Pas prezantimeve, klasa do të votojë për idenë më të mirë për udhëtimin tonë.“

6. Diagnoza dhe dallimi:

- *Ditari i projektit* për ta dokumentuar kontributin tuaj dhe për ta drejtuar procesin e grupit, Vlerësimi i vetes / i kolegut/ mësimdhënësit
- prezantimi i rezultatit me një fletë të vlerësimit

Dallimi:

Tavolinat ndihmëse për hapat e vetëm në procesin e punës:

- Për ta ofruar destinacionin, materialin hulumtues ose faqen e internetit (mësimdhënësi)
- Për të dhënë këshilla lidhur me kërkimin në internet
- Për të dhënë copëza - *si Pajtimi*

Nxënësit i caktojnë vetë grupet e synuara: *udhëtimi me familje, ekipi i futbollit, klubi i vajzave, ...*

7. Metodat

vetëvlerësimi dhe vlerësimi i jashtëm
dhënia e informatave kthyesë të lidhura me aspektin qendra e vëmendjes

3. Lidhshmëria me jetën e përditshme – Orientimi i nxënësve

Udhëtimi – kalimi i pushimit
Referencë në kornizën e kurrikulës (RLP): metropolet dhe rajonet në MB, kultura dhe temat relevante për grup moshën

8. Shkathësitë e mëtejme (të lidhura me lëndën specifike): Këtu SHKATHËSITË GJUHËSORE

- fusha semantike: rezervimi i hotelit/akomodimi, lajmërimi në hotel dhe ç 'lajmërimi
- fusha semantike: shprehja e mendimit dhe bindja e të tjerëve
- fusha semantike: transporti: blerja e biletave, periudha kohore gjatë ditës, përshkrimi i rrugës

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 2, DITA 1 – FLETË PUNE 8

Planifikimi i një njësie / caktimi i një teme

Punë në çift (shoku kritik) 10 minuta për person



Procedura:


Personi A e prezanton shkurtimisht njësinë e vet.

Personi B është dëgjues aktiv i cili jep **informata** të vërteta **kthyesë pas** prezantimit.

Gjatë prezantimit i lejohe vetëm të bëjë pyetje lidhur me të kuptuarit.

Në informacionin kthyes:

- **Filloni me diçka pozitive**, një ide të mirë, diçka që ju është dukur interesante!
- A është **thelbi** (“zemra”) i qartë dhe i arritshëm?
- A i plotëson detyra e synuar kriteret e një detyre komplekse të të nxënit?
- A janë intervenimet e menduara nga partneri juaj domethënëse dhe të përshtatshme për grup moshën?
 - A ekzistojnë tashmë ide për nivel të ndryshme të shkathtësive (reproduktimi, aplikimi, transferimi)
 - A ekzistojnë tashmë ide lidhur me mënyrën e vlerësimit të detyrës së synuar?



- Në fund merruni vesh për një takim / një thirrje telefonike përmes së cilës i shkëmbeni idetë e mëtejme.
- Vendosni kur dëshironi ta provoni njësinë dhe caktojeni një takim tjetër / një thirrje telefonike pastaj, gjatë të cilës flisni për përvojat dhe mënyrën si ka funksionuar njësia.

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) – MODULI 2, DITA 1 – FLETË PUNE 9

Fleta e punës për KSC-të

Takimi i KSC-ve nga shkollat tjera (40 minuta)

Objektivi: **shkëmbimi i ideve dhe përmirësimi i rrjeteve**

Pas diskutimit të çështjeve në shkollat tuaja me kolegët tuaj, cilat janë aspektet për të cilat do të dëshironi të bisedoni në mesin tuaj. Fokusi duhet të jetë mbi **MNQ** por nëse ka kohë do të ishte mirë gjithashtu që të bisedoni për çështje të tjera që ndërlidhen me QZhISh-në. Aspekti i fundit në listë është i detyrueshëm. Pra siguroni që të keni kohë për të **diskutuar në rrjetin tuaj**.

(Disa prej këtyre ideve mund t'i përdorni kur të takoheni me rrjetin e KSC-ve pavarësisht nga modulet)



Një KSC duhet të marrë shënime për grupin dhe instrukturin. Këto duhet të shpërndahen përmes emailit. Një KSC tjetër duhet të jetë moderator i këtij takimi. Uluni në rreth.

Këto janë disa prej ideve që mund t'i përdorni.

✓ **Problemët nga shkolla e juaj lidhur me MNQ**

Pyetjet udhëzuese:

A merrni përkrahje të mjaftueshme nga drejtori i juaj i shkollës?

A ka kohë të mjaftueshme për shkëmbimin e brendshëm, p.sh. oraret kohore?

A janë të interesuar anëtarë të tjerë të stafit lidhur me përvojën tuaj?

✓ **Çështjet e përgjithshme:**

Ekipi Zhvillimor i Shkollës (EZhSh)

Kush është pjesë e tij? – konfliktet? – detyrat e përkufizuara?

Aktivitet Profesional (AP) – kryesuesi? – për të gjitha lëndët? Roli, përgjegjësia?

A takohet aktiva profesionale – sa shpesh?

Roli i juaj si KSC:

A është përkufizuar roli? Si? A është dorëzuar ndonjë përgjegjësi në mënyrë zyrtare?

Si kanë reaguar kolegët tuaj mbi rolin e ri?

A është problem ndërtimi i ekipit?

✓ **Mbështetja e jashtme:**

Përveç materialeve, financave, cila mbështetje tjetër do të mund të ishte e dobishme?

Jepni arsyet këtu.

✓ **Rrjeti i KSC-ve**

Diskutoni çështje të tilla si: A kontaktoni me njëri tjetrin herë pas here/shpesh/asnjëherë?

Si do të duhej të dukej rrjeti i juaj? Cilat aspekte do të duhej të diskutoheshin?

Tregoni sa më konkretisht se si do ta përkrahni njëri tjetrin.

Bisedoni për takimin e radhës, qoftë përmes emailit apo në mënyrë fizike. Gjithashtu mund të ndaheni sipas rajonit nëse kjo ka logjikë.


Pajtohuni rreth datës dhe kohës dhe shkruajeni atë.

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 2, DITA 1 – FLETË PUNE 10

Synimi – Rrethi

Informatat tuaja kthyesë janë me rëndësi për neve- prandaj, ju lutemi të mendoni për punëtorinë dy ditore dhe shkruani përshtypjet tuaja

- Jam mësimdhënës 1-5 mësimdhënës 6-9 - ju lutemi ta shkruani kryqin qartë
- Ju lutemi vlerësoni pjesët e dhëna dhe bëjeni një kryq në segmentin e duhur.
- Sa më afër mesit të rrethit të synuar të jetë kryqi, aq më pozitiv do të jetë vlerësimi juaj.



Ja çka do të marrë me vete në shtëpi si diçka të re dhe të vlefshme

- 1.
- 2.
- 3.

Dëshiroj po ashtu të them – mund ta përdorni pjesën e pasme të fletës nëse dëshironi.

METODOLOGJIA ME NXËNËSIN NË QENDËR (MNQ) - MODULI 2, DITA 1 – FLETË PUNE 11


Fletë reflektimi – për detyrat komplekse të të nxënës

emri: _____ shkolla _____ klasa _____ lënda _____


Këndvështrimi i mësimit

Çfarë ndryshimesh kam vërejtur në mënyrën time të mësimit?	
A i kanë shfrytëzuar nxënësit materialet e skelës që i kam përgatitur? – Kush i ka shfrytëzuar? A ka pasur ndikim?	
Si ka ndryshuar mënyra ime e përgatitjes së njësive? (lidhur me përmbajtjen, kohën e kaluar për përgatitje etj.)	
Në lidhje me planet tuaja javore kosovare - A ka ndryshuar ndonjë gjë në këtë aspekt?	
Si e kam perceptuar mënyrën sipas së cilës kanë punuar nxënësit?	
A i kam përdorur fletët e planifikimit? / A ishte e dobishme?	
A e kemi mbështetur ne (mësimit e rrjetit) njëri tjetrin në shkollë? (i kemi këmbyer përvojat tona lidhur me detyrat komplekse të të nxënës, e kemi ndarë materialin etj.)	
Vërejtjet e mëtejshme / ose kjo është tema që do të doja ta trajtonim në punëtorinë e radhës.	

METODAT BASHKËPUNUESE PËR RITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 1	Blic apo ndriçim	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Është metodë grupore për ta vlerësuar shpejt gjendjen momentale mendore të secilit pjesëmarrës, në mes të fazës së mësimdhënies apo të diskutimit, e cila më së lehti përdoret në mënyrën e të ulurit në rreth. Pjesëmarrësit e japin një deklaratë të shkurtër me radhë, duke filluar me ndonjë vullnetar apo me ndonjë pjesëmarrës të caktuar nga mësimdhënësi. Rezultati është "fotografi blic" e një procesi të caktuar të të nxënit." (Fjalori i të nxënit të rriturve në Evropë i UNESCO-s)</p> <p>Është 'ndriçim' ndërveprues, i shpejtë, i cili përdoret kryesisht gjatë informatave kthyesë për përcaktimin e shpejtë të mendimeve, të gjendjes shpirtërore ose të njohurisë së nxënësve lidhur me një temë të caktuar. Të ulurit: parapëlqehet ulja në rreth, deri në 30 njerëz, mësimdhënësi në rreth.</p> <p>Secili nxënës e shpreh mendimin e tij personal lidhur me një pyetje/ de-tyrë të caktuar një herë, me një apo me dy fjali – jo më gjatë se 30- 60 sekonda. Secili nxënës e shpreh mendimin e vetë, pritjet, etj., duke mos i përmendur të tjerët.</p> <p>Renditja: Rrethore apo sipas rendit të përcaktuar nga ndonjë mjet si topi</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Për ta tërhequr vëmendjen e secilit lidhur me një temë (në fillim; në mes; në fund) • Në situata të konfliktit ose para votimit • ... 	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Kur/ ku mund ta provojë këtë? (javën tjetër /muajin tjetër; me cilin grup / me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>

METODAT BASHKËPUNUESE PËR RRIJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 2	Grupi gumëzhitës	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Qëllimi i kësaj metode është shkëmbimi i ideve shpejt, ide të cilat mund të shfrytëzohen më vonë në diskutime ose në ndonjë formë tjetër të punës.</p> <p>Zakonisht grupet gumëzhitëse përbëhen prej vetëm dy personave, më së shumti prej katër personave.</p> <p>Anëtarët e grupit gumëzhitës flasin me zë të ulët dhe (duke gumëzhitur si bletët) bisedojnë për gjërat për të cilat janë duke menduar.</p> <p>Zakonisht është aktivitetet shumë i shkurtë prej rreth tre minutave apo më pak.</p> <p>Nëse doni t'i mësoni rezultatet e kësaj faze, mund t'i caktohet dikujt roli i prezantuesit. Ata i sqarojnë idetë më vonë.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nëse mbani fjalim të gjatë (për t'i aktivizuar pjesëmarrësit / gjatë apo pas fjalimit / kontribut) - Nëse doni të merrni shpejt shumë ide - Nëse doni të mësoni për njohuritë paraprake të nxënësve - Nëse po, lexojeni një tregim të gjatë dhe kërkoni nga nxënësit të bëjnë parashikime - ... <p>Me rëndësi: Është metodë e mirë për t'i bërë të flasin nxënësit e turpshëm apo të pasigurt gjatë marrjes së rezultateve. Nëse ky është qëllimi juaj, filloni t'i pyesni ata së pari.</p>	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Kur/ Ku mund ta provojë këtë? (javën tjetër /muajin tjetër; me cilin grup / me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>


METODAT BASHKËPUNUESE PËR RITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 3	Rrethi i dyfishtë	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Kjo metodë është lloj i posaçëm i punës në çift, përqendrimi i së cilës është në lirinë e të shprehurit dhe në të dëgjuarit aktiv. Nxënësit në rrethin e brendshëm dhe në atë të jashtëm qëndrojnë përballë njëri tjetrit dhe shkëmbejnë fjalë/këndvështrime/rezultate të punës së mëparshme/ ose...</p> <p>Pas një sinjali me zë, lëvizë së paku një rreth, në mënyrë që secili nxënës të punojë me një partner tjetër. Koha e kaluar në rrethin e dyfishtë do të ndryshojë varësisht nga detyra dhe grup moshë.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nëse doni ta ushtroni të folurit dhe të dëgjuarit aktiv - Nëse doni t'i shtyni nxënësit të flasin dhe njëkohësisht t'i inkurajoni nxënësit e turpshëm - Nëse doni t'iu ndihmoni nxënësve të ruajnë më shumë informata duke marrë kontribute të ngjashme - Nëse përdorni materiale të ndryshme (tekste) si bazë për temën e njëjtë, nxënësit marrin informata të mëtejshme * - ... <p>Shtesë *: Metoda mund të shfrytëzohet në kombinim me metodat e tjera si nënvizimi, hartës mendore (Vërejtje e përkthyesit: teknikë grafike për paraqitjen vizuale të lidhjeve ndërmjet disa ideve dhe informatave), caktimi i prioritetëve ose marrja e shënimeve.</p>	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Kur mund ta provojë atë? (javën tjetër /muajin tjetër)? Me cilin grup / klasë?</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>


METODAT BASHKËPUNUESE PËR RRRITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 4	Mendoni – Punoni në çift – Ndajeni (TPS)	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Hapi 1: Mendoni lidhur me temën / problemin dhe shkruani mendimet tuaja në një copë letër / karton / ... individualisht; (caktojeni kohën, sa minuta)</p> <p>Hapi 2: Bëhuni bashkë me një partner dhe sqaroni/ diskutoni/ krahasoni/ idetë tuaja. (caktojeni kohën, sa minuta)</p> <p>(Nëse detyra është më komplekse, i pari e bën prezantimin partneri A, partneri B dëgjon, i shkruan idetë, duhet të jetë dëgjues aktiv (kuptojeni partnerin, bëni pyetje)</p> <p>Pastaj ndërroni rolet. Në fund shkruani idetë kryesore (në letër, karton, etj.)</p> <p>Hapi 3: Ndajeni idenë tuaj me një çift tjetër / me të tjerët/ në seancë plenare (caktojeni kohën, ... sa minuta)</p> <p>Këmbeni idetë dhe pajtohuni lidhur me ato më të rëndësishmet /interesantet që do të kishit pasur dëshirë t'i prezantoni (shkruani në letër, karton, etj.) (Nëse është e nevojshme, bëjeni formale si në hapin 2. Partneri A i pari, ...)</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>	<div style="text-align: center;"> <h2 style="color: #e67e22;">MENDO-PUNO NË ÇIFT-NDAJE</h2> <p>Xhiro 1 - Mendo Nxënësit të mendojnë ose të shkruajnë për pyetje për diskutim.</p> <p>Xhiro 2 - Puno në çift Lejoni nxënësit që të gjejnë një partner dhe të diskutojnë përgjigjet e tyre.</p> <p>Xhiro 3 - ndaje Filloni një diskutim grupor ashtu që secili çift t'i ndajë përgjigjet e tyre me pjesën tjetër të klasës.</p> </div>	
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<p>- Në shumë situata nëse doni t'i përfshini të gjithë dhe të mendoni për diçka individualisht</p> <p>shembuj: përvetësimi i përmbajtjes së re përsëritja e lëndës shkëmbimi i detyrave të shtëpisë zbulimi i njohurive paraprake ...</p>	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Kur mund ta provojë? (javën tjetër /muajin tjetër, me cilin grup / me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>


METODAT BASHKËPUNUESE PËR RITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 5	Tregu	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Qasja prej tre hapave</p> <p>1. Hapi: Kryerja e ekspertizës Materiali kompleks ndahet sipas fushave të ndryshme. Secili grup punon në fushën e vetë dhe e përgatitë një produkt, p.sh. një pllakat</p> <p>2. Hapi: Prezantimi i ekspertizës tuaj Gjysma e grupit ulet/qëndron pranë produktit të vetë dhe ua sqaron „vizitorëve“ Gjysma tjetër (vizitorët) lëvizin prej një prezantimi te tjetri. Pas një kohe të arsyeshme ndërrohuni.</p> <p>3. Hapi: Ruajtja e rezultateve të të gjitha grupeve Në seancë plenare mbahet diskutimi pasues. Sipas mundësisë, të gjitha rezultatet dokumentohen në një fletë përmbledhëse ose në diçka të ngjashme.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>	 <p>Fernuni Hagen</p>	
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<p>Kur dëshironi t'i aktivizoni të gjithë nxënësit, jepuni shumë shanse të mendojnë lidhur me lëndën dhe kërkoni nga ata t'i prezantojnë rezultatet.</p> <ul style="list-style-type: none"> - në prezantimet - nëse aspektet e ndryshme të një teme janë relevante dhe duhet të sillen së bashku <p>...</p>	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Kur mund ta provojë atë? (javën e ardhshme / muajin e ardhshëm; me cilin grup / me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>


METODAT BASHKËPUNUESE PËR RITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

<p>Metoda 6</p>	<p>Intervista prej tre hapave</p>	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Kjo metodë është e përshtatshme për një këmbim të strukturuar ndaj një teme të caktuar ose për zhvillim të mirë të kuptimit të një teksti.</p> <p>Formoni grupe të përbëra na dy persona për hapin dy dhe tre.</p> <p><u>Hapi 1:</u> Individualisht! Nxënësit lexojnë fjalë dhe paragrafe në tekst dhe i nënvizojnë ato. Ata formulojnë pyetje të cilat ju ndihmojnë ta kuptojnë tekstin. (kontrojojeni sa është kuptuar teksti)</p> <p><u>Hapi 2:</u> Në çifte! Nxënësit i bëjnë pyetje njëri tjetrit në të cilat duhet të përgjigjet partneri.</p> <p><u>Hapi 3:</u> Dy çifte! Nxënësit i këmbajnë njohuritë lidhur me tekstin ose rezultatet e tyre.</p> <p>Dallimi /Alternativa: Punoni në një aspekt tjetër të dhënë nga mësim-dhënësi</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të punuarit me tekst - këmbimi i mendimeve – e rëndësishme: idetë duhet të dokumentohen - aktivizimi i njohurive paraprake - përsëritja e përmbajtjes së lëndës / njohuria ... 	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Kur mund ta shfrytëzojë atë? (javën tjetër / muajin tjetër; me cilin grup /me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>


METODAT BASHKËPUNUESE PËR RRRITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 7	Metoda e 5 gishtave	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Përdoret për informatat kthjese. Është e rëndësishme çka i ngarkoni secilit gisht.</p> <p>Gishti i madh – Ka qenë shumë e mire! Gishti tregues – E kuptova idenë. Gishti i mesëm – Nuk më ka pëlqyer... Gishti i unazës – Kjo më ka pëlqyer veçanërisht. Gishti i vogël – Kjo kishte prioritet shumë të ulët në agjendë.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<p>Nëse doni të keni informata të shpejta kthjese. (në takim, pas ndonjë mësimi ose më shumë se një here)</p>	
<p>Idetë e mia/ situatat konkrete</p> <p>Ku do të mund ta përdorja? (javën tjetër/muajin tjetër) me cilin grup/klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>


METODAT BASHKËPUNUESE PËR RITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 8	Shtroja e tavolinës	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Përgatiteni një letër të madhe me pjesë individuale dhe pjesë të përbashkët në mes (sikur në paraqitjen vizuale) për të arritur rezultate.</p> <p>Caktojeni detyrën!</p> <p><u>Hapi 1:</u> Nxënësit i shkruajnë idetë në pjesë individualisht pa folur me askënd (caktojeni kohën, sa minuta)</p> <p><u>Hapi 2:</u> Nxënësit ecin përreth në drejtim të akrepave të orës (ose në drejtim të kundërt me akrepat e orës) dhe lexojnë çfarë kanë shkruar në ato pjesë.</p> <p><u>Hapi 3:</u> Nxënësit i diskutojnë idetë e tyre dhe i shkruajnë rezultatet më relevante në mes, (tri deri në pesë aspekte)</p> <p><u>Hapi 4:</u> Një nxënës ja prezanton rezultatet tërë grupit ose një çiftit tjetër. Nxënësit e tjerë i ndihmojnë nëse ka nevojë.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<ul style="list-style-type: none"> • për t'i diskutuar idetë • për t'i dokumentuar informatat e hulumtuara ose për t'i analizuar dokumentet • për ta rishikuar një temë • ... 	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Ku/ Kur mund ta shfrytëzojë atë? (javën tjetër /muajin tjetër; me cilin grup / me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>


METODAT BASHKËPUNUESE PËR RRRITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 9	Stacioni i autobusit	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Një metodë me anë të së cilës nxënësit mund të punojnë me shpejtësinë që dëshirojnë, i krahasojnë rezultatet e tyre dhe pastaj vazhdojnë me detyrën tjetër.</p> <p><u>Hapi 1:</u> Nxënësit merren individualisht me detyrën e dhënë.</p> <p><u>Hapi 2:</u> Kur ta përfundojnë, shkojnë në stacionin e autobusit dhe i krahasojnë rezultatet e tyre me nxënësin tjetër, i cili e ka kryer detyrën. Në stacionin e autobusit ata po ashtu e gjejnë një fletë me zgjidhjen.</p> <p><u>Hapi 3:</u> Pasi që ta kenë përfunduar, t'i kenë korrigjuar gabimet dhe ta kenë pyetur mësimdhënësin nëse nuk e dinë pse e kanë pasur gabim, ata vazhdojnë me detyrën e radhës.</p> <p><u>Vërejtje:</u> Është me rëndësi që partneri në stacionin e autobusit të jetë gati! Nxënësit nuk duhet të presin që shoku ta kryejë detyrën.</p> <p>Metodë e shkëlqyeshme në grupet heterogjene.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kur nxënësit kanë nevojë t'i krahasojnë rezultatet në procesin e nxënies - Nëse duhet trajnim për ndonjë aftësi ose nëse përsëritet përmbajtja - ... 	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Ku / Kur mund ta provojë këtë? (javën tjetër / muajin tjetër? me cilin grup / me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>

METODAT BASHKËPUNUESE PËR RITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 10	Synimi - Rrethi	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Një metodë që përdoret për informacion kthyes</p> <p>Ju e ndani rrethin në aq pjesë sa doni. Këshillohet të mos jenë më shumë se 8. Duhet të ketë një aspekt për secilën pjesë.</p> <p>Nxënësit duhet të bëjnë një X në pjesën, e cila mendojnë që është më e afërme – sa më afër mesit X, aq më i mirë vlerësimi.</p> <p>Nëse doni një informacion kthyes më specifik, mund ta kombinoni rrethin me tabelat e më poshtme.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<p>- Nëse doni informacion kthyes, p.sh. në fillim ose në fund të një njësie ose afati kohor.</p> <p><u>ideja</u>: Nëse e bëni një master-kopje (digjitale ose fizike) ju mund ti lusni nxënësit që ta plotësojnë në mënyrë anonime. Pastaj mund t'ia tregoni rrethin grupit. (Mund të caktoni edhe ngjyra të ndryshme për vajza dhe djemtë – Shpesh mendimi i tyre është i ndryshëm).</p> <p><u>alternativa</u>: Të nxënësit të plotësojnë fillimisht formën në mënyrë individuale e pastaj një nxënës e i përdor fletat për të bërë një master-kopje për diskutim më vonë.</p>	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Ku / Kur mund ta provojë këtë? (javën tjetër /muajin tjetër? me cilin grup / me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>


METODAT BASHKËPUNUESE PËR RITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 11	Fanari	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Në dhomë gjenden “fanarë” të ndryshëm. Ata qëndrojnë në një vend deri sa “barkat” vijnë tek fanari për të këmbyer mendime lidhur me pyetjet ose detyrat e dhëna.</p> <p>Pas sinjalit, apo pas një kohe, barkat lëvizin tek një fanar tjetër, jo krejt bashkë por në mënyrë individuale kështu që formohen grupe të reja.</p> <p>Në fanar ju jepet një pyetje tjetër për t’ju përgjigjur ose një detyrë për t’u marrë me të.</p> <p><u>Vërejtje:</u> Mund të jetë ide e mirë që roli i fanari t’i caktohet një nxënësi, i cili ose është relativisht i turpshëm, nuk përzihet me të tjerët lehtë, ose ka aftësi më të vogla.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Për të diskutuar aspekte të ndryshme me nxënësit e ndryshëm • Për të marrë informata kthyesë lidhur me disa pyetje • Për të diskutuar ide • Nëse doni të ushtroni të folurit dhe të dëgjuarit aktiv 	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Kur / ku mundem me e përdorë atë? (javën e ardhshme / muajin e ardhshëm? me cilin grup/ me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>


METODAT BASHKËPUNUESE PËR RRIJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 12	Këndi i djathtë	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Nxënësve ju jepet një fletë e letrës me strukturën e caktuar.</p> <p><u>Ata duhet t'i plotësojnë katrorët individualisht.</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ata fillojnë me shigjetën dhe e shkruajnë temën e caktuar. 2. Pastaj i mbledhin të gjitha aspektet të cilat mund t'i gjejnë lidhur me temën. 3. Ata vendosin për një aspekt në të cilin dëshirojnë të përqendrohen. 4. Ata arrijnë përfundimin vetë / për jetën e tyre të përditshme. <p><u>Alternativat:</u></p> <p>Një grup i diskuton aspektet (hapi 2) dhe ata i shpërndajnë ato në grup. Pastaj i ndajnë rezultatet e tyre, së pari në grup, pastaj në klasë.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kur nxënësit bëjnë kërkime • Kur të marrin një qasje individuale tematike • Kur nga ata kërkohet të punojnë duke bashkëpunuar 	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Ku mund ta përdori atë? (javën e ardhshme /muajin e ardhshëm) me cilin grup / me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>

METODAT BASHKËPUNUESE PËR RITJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

<p>Metoda 13</p>	<p>Telegrami prej 10 fjalëve</p>	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Secili nxënës i shkruan saktësisht 10 fjalë në një kartë.</p> <p>Nuk është e domosdoshme të shkruhen fjali të plota por lejohet edhe një gjë e tillë.</p> <p>Kartat pastaj përzihen dhe shpërndahen ashtu që secili e ka nga një kartë por jo të vetën.</p> <p>Pastaj secili e lexon kartën e vetë me zë pa komentuar lidhur me të.</p> <p><u>Vërejtje:</u> Nxënësit do të thonë që kanë nevojë për më shumë fjalë – prandaj insistoni ta japin numrin e saktë.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>		
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Për të marrë informata kthyesë • Për t'u siguruar që nxënësit e bëjnë një karakterizim të shkurtër • Për t'i trajnuar ata të përqendrohen në gjërat esenciale 	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Ku / kur mund ta përdorë atë? (javën e ardhshme / muajin e ardhshëm? me cilin grup / me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>

METODAT BASHKËPUNUESE PËR RRIJTJEN E PËRFSHIRJES SË NXËNËSVE DHE TË NXËNIT TË QËNDRUESHËM

Metoda 14	Diagrami Venn	
<p>Përshkrimi</p>	<p>Diagrami Venn është mjet për diskutimin në grup dhe krijimin e krahasimit ndërmjet dy (ose më shumë) objekteve, ngjarjeve, teksteve ose njerëzve. Mund ta përdorni si hap të parë për ta krijuar një skicë nëse doni të krahasoni ose ballafaqoni diçka.</p> <p>Thjesht vizatohet dy (ose më shumë) rrethë të mëdhenj dhe emërtojeni secilin rreth, mendoni për secilin objekt, tipar apo person të cilin jeni duke e krahasuar.</p> <p>Brenda fushës së gërshetuar shkruani çfarë kanë të përbashkët.</p>	
<p>Paraqitja vizuale</p>	 <p style="text-align: center;">analiza / interpretimi</p>	
<p>Sugjerim kur të përdoret</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Për t'i paraqitur në mënyrë vizuale idetë kryesore të dy teksteve dhe për të parë në çfarë mënyrash janë të ndryshme ose identike • Për t'i diskutuar idetë dhe për të parë çfarë kanë të përbashkët • ... 	
<p>Idetë e mia / situatat konkrete</p> <p>Kur / ku mundem me e përdorë atë? (javën e ardhshme / muajin e ardhshëm? me cilin grup/ me cilën klasë?)</p>	<p>Situata</p>	<p>Kur? Grupi?</p>



MË QUAJNË...

Çarli Çaplin

Filmat e mi bënë shumë breza të qeshin dhe të mendojnë



Luis L. Carles



Më quajnë... Çarli Çaplin

Çarli Çaplin ishte një nga aktorët më të famshëm të kinematografisë së shekullit të 20-të. Ai ishte i njohur për rolet e tij të komedia dhe për stilin e tij të veçantë të veshjes. Në këtë libër do të gjeni informata interesante rreth jetës dhe karrierës së tij.



TITULLI

Udhëtimi i Çarli Çaplin
Lindja dhe vdekja
Rritja dhe famë
Kariera dhe jetë personale
Mësimet nga jetë

SHKRUAR

Mari Piri
Tereza e Kalkutës
Whit Lennon
Çarli Darwin
Cecili
Ana Evans
Krisofer Kolombi
Gëzime Gëzime
Rajada Kiri



Aktivitetet energjizuese

Siç është përmendur tashmë në fjalën hyrëse, aktivitetet e shkurtra energjizuese kanë rezultuar shumë të dobishme nëse përdoren menjëherë pas pauzave ose kur pjesëmarrësit janë të lodhur për ndonjë arsye.

Neve na kanë pëlqyer shumë, e po ashtu edhe pjesëmarrësve.

Në fillim, kur pjesëmarrësit nuk e njohin njëri-tjetrin, shpesh është e dobishme të bëhet thyerja e akullit. Më vonë - pas pushimeve të kafesë ose drekës - kur të gjithë ndihen pak të lodhur – aktivitetet energjizuese ndihmuan për të rritur nivelin e energjisë së të gjithëve dhe për të krijuar një atmosferë të relaksuar. Kishte shumë të qeshura gjatë gjithë kohës dhe i linte të gjithë të buzëqeshur.

Kur përdorni aktivitetet energjizuese, është e rëndësishme që ju si trajner të jeni pjesë e aktivitetit. Ndoshta e ekzagjeroni pak me veprimet tuaja për t'i bërë pjesëmarrësit të qeshin.

Në këtë punim përshkruhen tri aktivitetet tona më të preferuara, por ka shumë aktivitete që mund të gjenden në faqe të ndryshme të internetit. Disa lidhje tek faqet në gjuhën angleze ose gjermane janë paraqitur në fund të kësaj pjese. Por me siguri do të gjeni disa webfaqe në gjuhën shqipe gjithashtu.



„Rrethi i rrahjes së shuplakave“ (koha 5-10 minuta)

Një prej aktiviteteve tona më të preferuara aktivizuese. Pas kësaj të gjithë janë të zgjuar dhe duke qeshur.

I gjithë grupi qëndron në një rreth, me fytyrë brenda rrethit. Pastaj instruktori fillon t'i bie shuplakave në anën e majtë: :

→ 1 Rrahja e shuplaka do të thotë: 3 persona (A, B, C) fillojnë por pastaj gradualisht të gjithë të tjerët përfshihen.

Ndërsa A dhe C janë duke qëndruar në këmbë, personi në mes (B) duhet të përkulet. Tani dy persona të tjerë që janë duke qëndruar në këmbë (A + C) rrahin shuplaka mbi kokën e tij/saj (B). Pastaj personi (B) ngritët në këmbë (C) dhe përkulet dhe rrah shuplaka mbi kokën e B-së me D-në. Pastaj C dhe E rrahin shuplaka mbi kokën e D-së e kështu me radhë.

- Siguroni që rrethi të përfundojë para se të fillon tjetri. Tani të gjithë e dinë se si funksionon ky aktivitet.

→ Rrethi i dytë: Trajneri fillon me një të rrahur të shuplakave, dhe pasi që tri apo katër grupe ta kenë bërë këtë, fillohet me rrethin e dytë në drejtimin e njëjtë. U thoni, rrethi i dytë duhet ta zë rrethin e parë (që asnjëherë apo rrallë ndodhë).

→ Rrethi i tretë (vetëm nëse keni kohë të mjaftueshme apo si një alternativ):

Rrethi i parë fillon në të djathtë dhe rrethi i dytë në të majtë. (Kuptohet se do të ketë shumë konfuzion dhe të qeshura, po të dy rrethet takohen në mes.

Pica (maksimumi 10 minuta):

Të gjithë qëndrojnë ndarazi para karriges së vet dhe e shikojnë trajnerin.

Tani trajneri u thotë ta paramendojnë trupin e tyre si të ishte një picë:

Fjalët të cilat i thotë trajneri Lëvizjet të gjithë (përfshirë edhe trajnerin)

1. ngjisheni brumin: bëni “lëvizjet e ngjeshjes së brumit” me duart tuaja në pjesët e ndryshme të trupit për të aktivizuar secilin muskul.
2. vendosni mbi të sosin e domates: goditni me lehtësi çdo pjesë të trupit tuaj me duar
3. vendosni ullinjtë mbi të: bëni goditje të vogla intensive me gishta
4. vendosni djathin mbi picë: gishtat lehtësisht prekin trupin tuaj nga koka deri te gishtat e këmbëve

Kuptohet që edhe shumë përbërës të tjerë mund t'i vendosen picës. Pra mund të shtoni çfarëdo aktiviteti në mënyrë spontane. Do ta ndjeni kur është e mjaftueshme.

5. vazhdoni në mënyrë kreative

Thesi i miellit (maksimumi 10 minuta):

Të gjithë janë duke qëndruar në këmbë pranë karriges së vet me pak hapësirë përreth tyre dhe e shikojnë trajnerin.

Trajneri u thotë se e kanë vizituar depon ushqimore. Fatkeqësisht kur kanë kaluar pranë një rafti ka rënë shumë miell mbi kokat dhe trupin e të gjithëve – dhe tani ata duhet ta largojnë atë.

(U thoni që të gjithë duken të mbuluar me miell, të papastër dhe të bardh).

Ta largojmë miellin tani: (në këtë mënyrë):

Words the instructor says:

1. Kërceni që ta largoni pjesën më të madhe të miellit
2. Dridhuni që ta largoni pluhurin e imët.
3. Me duart tuaja: gërryeni miellin nga i gjithë trupi.
(siguroni që të përkulen deri te këmbët...)
4. Ka ende pjesë të miellit në shpatulla: ato duhet të largohen me grushta

Movements

- Kërceni
- Shkundeni vetën
- Gërryeni trupin
- I goditni disa pjesë

(kjo ndihmon nëse njerëzit kanë krahët e tendosura)

5. Keni ende miell në flokë: me butësi goditni dhe masazhoni kokën dhe fytyrën tuaj me gishta, si dhe muskujt e qafës.

Me lehtësi e goditni dhe masazhoni kokën tuaj

Burime për më shumë aktivitete energjizuese:

Anglisht:

www.bookwidgets.com/blog/2016/10/15-fun-classroom-energizers-for-students

<https://confluence.dimagi.com/display/commcarepublic/Icebreaker%2C+Energizer+and+Recap+Activities>

Gjermanisht:

<https://bobblume.de/2014/05/06/methoden-und-energizer-sammlung/>

<https://www.sandrasideenkiste.de/methodensammlung-1/aktivierungsspiele/>

<https://teambuilding-spiele.de/energizer-spiele/>

6. Vegëza/ referenca për materialin e përdorur

- Bauer, Joachim, Lob der Schule, Hoffmann und Campe 2007
- Bauer, Joachim, Selbststeuerung - Die Wiederentdeckung des freien Willens, Blessing 2015
- Brüning/Saum, Erfolgreich unterrichten durch Visualisieren, NDS 2019
- Brüning/Saum, Erfolgreich unterrichten durch Kooperatives Lernen Bd. 2, NDS 2015
- Brüning/Saum, Erfolgreich unterrichten durch Kooperatives Lernen, NDS 2006
- Buzuk, Christian, Zutrauen im Spannungsfeld von Führen und Begleiten – Was man aus Schülerprojekten für das Lehrerhandeln lernen kann, Zeitschrift Pädagogik 4/17
- Görlich/Isermann/Noch, Elemente der Diagnose im Schulalltag, Zeitschrift Pädagogik 2/17
- Green/Green, Kooperatives Lernen, 2005
- Gührs/Nowak, Das konstruktive Gespräch, Limmer 2014
- Hattie, John, Visible learning, Routledge 2008
- Kubesch/Platz, Schüler mental stärken, Zeitschrift Pädagogik 9/18, S. 28 – 31
- Leisen, Josef, Kompetenzorientierung in Lehramtsausbildung und Physikunterricht, Physikdidaktik Plus Lucis 2/2016
- Leisen, Josef, Das Lehr-Lern-Modell, mit Genehmigung entnommen PPT, Vortrag 2015
- Spitzer, Manfred, Wie lernen Kinder?, abgerufen am 19.02.2019, 90 Min.
<https://www.youtube.com/watch?v=vujELzwcdpQ>
- Mattes, Wolfgang, Methoden für den Unterricht. Kompakte Übersichten für Lehrende und Lernende, Schöningh 2011
- Meyer, Hilbert, Unterrichtsentwicklung, Cornelsen 2016
- Meyer, Hilbert, Unterrichtsmethoden Bd. I, Theorie, Cornelsen 2016
- Meyer, Hilbert, Was ist guter Unterricht?, Cornelsen 2016, 15. Auflage
- Plath, Maike, „Spielend“ unterrichten, Status im Schulalltag, Beltz 2015
- Reich, Kersten, Konstruktivistische Didaktik, Beltz 2012
- Reich, Kersten, Systemisch-konstruktivistische Pädagogik, Beltz 2010
- Rolff, Hans-Günter (hrsg.). Handbuch Unterrichtsentwicklung, Beltz 2015
- Rosa/Endres, Resonanzpädagogik, Beltz 2016
- Roth, Gerhardt, Bildung braucht Persönlichkeit. Wie Lernen gelingt, Klett-Cotta 2011
- Seidel, Tina, Klassenführung, Zeitschrift Pädagogische Psychologie 2015
- Stern, Elsbeth, Von der Synapse in die (Hoch-) Schule?, abgerufen am 19.02.2019, 59 Min.
<https://www.youtube.com/watch?v=8HzvUmOGFm0>

- Wellenreuther, Martin, Lehren und Lernen – aber wie?, Schneider 2014
- Zierer, Klaus / Hattie, John, Visible learning auf den Punkt gebracht, Schneider 2018
- Zierer, Klaus Lernen sichtbar machen für Lehrpersonen, Schneider 2014
- Zu Anforderungsbereichen, abgerufen am 10.10.2019, www.e-teachers.de/Anforderungsbereiche.pdf,

Dokumente nga Kosova:

Plani Strategjik për Arsim i Kosovës 2017 - 2021

Raporti i rezultateve të PISA-së 2015

Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor në Kosovë, 2012

